



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 504 Akti

Nr. 711 Vendimi  
Tiranë, më 1.11.2023

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Pamela Qirko** Kryesuese  
**Roland Ilia** Relator  
**Brunilda Bekteshi** Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 30.10.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Blerina Muço**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Blerina Muço, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Blerina Muço, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar<sup>1</sup>, aktualisht Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në muajin qershor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Blerina Muço do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Brunilda Bekteshi. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia, ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionere Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Blerina Muço, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve e rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.
4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 26.9.2023, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Blerina Muço; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
7. Subjekti i rivlerësimit, pas njoftimit mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit më 9.10.2023.
8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë znj. Blerina Muço në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>1</sup> Referuar hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10/2023, datë 2.2.2023, “Për informacionin e klasifikuar”, më 9.3.2023, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, i ndryshuar, bazuar në nenin 63 të këtij ligji emërtimi i DSIK-së ka ndryshuar në Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK).

## II. SEANCA DËGJIMORE

9. Subjekti i rivlerësimit Blerina Muço u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 13.10.2023.

10. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 30.10.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

11. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Blerina Muço kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Znj. Blerina Muço ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

14. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

14.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

14.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

14.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

15. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>2</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

---

<sup>2</sup>“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit

kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**16.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti dhe bashkëshorti pranë ILDKPKI-së;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituara nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**17.** Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë dhe, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin Blerina Muço:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**18.** Znj. Blerina Muço është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë; para fillimit të detyrës 2003; periodike/vjetore 2004 – 2017; deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

**18.1** Për kryerjen e kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Blerina Muço, ILDKPKI-ja ka krahasuar deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar, jobankar etj., të dorëzuar nga vetë subjekti.

### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**19.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;

---

*të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.*

- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

**20.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Blerina Muço, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2003 – 2017, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

**Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, shtojca \*\*\*, dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, në zbatim të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti ka deklaruar:**

**1. Apartament banimi me sip. 138 m<sup>2</sup>**, në bashkëpronësi me bashkëshortin, me nr. pasurie \*\*\*, i ndodhur në Rrugën e \*\*\*, Tiranë, deklaruar i blerë më 24.6.2000, kundrejt çmimit 5,000,000 lekë, me financim 100% nga kredia e lëvruar nga Banka e Kursimeve/Raiffeisen Bank, në shumën 5,000,000 lekë, me interes vjetor 3%, me afat shlyerje 25 vjet, me këst mujor 23,710 lekë.

Apartamenti është hipotekuar në favor të Bankës së Kursimeve/Raiffeisen Bank, për efekt të sigurimit të huas.

### **Hetimi i Komisionit**

**1.1** Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003 subjekti ka deklaruar: “*Apartament 3+1, pallati i \*\*\*, pranë \*\*\*. Vlera: 5,000,000 lekë. Zotërimi: 50%. Kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 24.6.2000. Si burim është deklaruar kredia e marrë nga Banka e Kursimeve*”.

**1.2** Rezultoi se më anë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 24.6.2000, bashkëshorti i subjektit, z. M.M , ka blerë nga shoqëria “\*\*\*”, përfaqësuar nga z. G. D, pasurinë apartament me sip. 151 m<sup>2</sup>, në Tiranë, në vlerën 5,000,000 lekë. Kjo vlerë sipas kontratës do të paguhej në arkën e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., nëpërmjet kredisë që do të merrej në Bankën e Kursimeve brenda datës 24.6.2000. Dorëzimi i sendit, sipas kontratës, do të bëhej më 15.9.2000.

**1.3** Për këtë pasuri apartament me sip. 138 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rrugën e \*\*\*, Tiranë, është lëshuar certifikatë pronësie nr. \*\*\*, datë 20.12.2011 dhe kartelë pasurie në emër të shtetasit M.M .

**1.4** Për blerjen e kësaj pasurie rezultoi një kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 8.9.2000, me huamarrës M.M dhe huadhënës Banka e Kursimeve, në shumën 5,000,000 lekë, me interes 3%, afati 20 vjet. Për të mundësuar shlyerjen e detyrimit (për efekt sigurimin e kredisë 5,000,000 lekë) është lidhur një kontratë hipotekimi nr. \*\*\*, datë 8.9.2000, me hipotekues M dhe Blerina Muço dhe përfitues Banka e Kursimeve Tirana 3.

**1.5** ZVRPP Tiranë, me shkresën datë 19.2.2018<sup>3</sup>, ka dërguar praktikën lidhur me këtë pasuri. Sipas praktikës rezulton se bashkëshorti i subjektit ka të regjistruar në pronësinë e tij pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, lloji apartament me sip. 138 m<sup>2</sup>, përfituar me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 24.6.2000, blerës M.M, i apartamentit me sip. 151 m<sup>2</sup>, ndodhur pranë \*\*\*, Tiranë, blerë në vlerën 5,000,000 lekë.

**1.6** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2018, Raiffeisen Bank konfirmon se Banka e Kursimeve ka disbursuar në llogarinë e z. M.M kredinë në shumën 5 milionë lekë. Pas disbursimit të kredisë, z. M.M ka kryer kalimin e saj në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me qëllim likuidimin e çmimit sipas kontratës me këtë shoqëri, sipas urdhrit të xhirimit nr. \*\*\*, datë 12.10.2000.

**1.7** Sipas kontratës së hipotekimit datë 8.9.2000 duket se pasuria apartament është regjistruar në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 1.9.2000, në emër të subjektit dhe bashkëshortit. Pra, kjo pasuri ka kaluar në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit para lëvrimin të kredisë bankare dhe likuidimit të palës shitëse. Kalimi i shumës prej 5,000,000 lekësh nga subjekti te pala shitëse është bërë më 12.10.2000<sup>4</sup>.

**1.8** Subjekti është pyetur lidhur me këtë pasuri, e cila ka deklaruar se: “...procedurat e përfitimit të kredisë kanë përfunduar në datën 8.9.2000, konfirmuar me Kontratën e Huas së kësaj date. Sikurse kam deklaruar më parë, mbi kërkesën tonë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2018, Raiffeisen Bank nuk na ka mundësuar datën e saktë në të cilën është lëvruar kredia në shumën 5,000,000 lekë në llogarinë e bashkëshortit, por ka sqaruar se, mbas disbursimit të kredisë, z. M. M (M) ka kryer kalimin e saj në favor të shoqërisë “\*\*\*\*”, me qëllim likuidimin e çmimit sipas kontratës së shitjes të nënshkruar me këtë shoqëri. Banka na ka vënë në dispozicion urdhërshirimin me nr. serie \*\*\*, datë 12.10.2000, lëshuar nga bashkëshorti, me të cilin është kryer veprimi i mësipërm, pikërisht në këtë datë është realizuar pagimi tërësisht i çmimit të blerjes së apartamentit, me burim të vetëm financimin nga ish-Banka e Kursimeve; në marrëveshje me palën shitëse, me qëllim realizimin e procedurave të përfitimit të kredisë, në kushtet kur nuk kemi pasur asnjë pasuri tjetër për të siguruar kredinë, është rënë dakord që regjistrimi i apartamentit në regjistrat hipotekorë në emër të bashkëshortit, të kryhej para likuidimit të çmimit të blerjes. Nga të dhënat e kontratës së hipotekimit datë 8.9.2000, rezulton që ky veprim të jetë kryer në nr. \*\*\* të regjistrat hipotekor datë 1.9.2000. Për konfirmimin e kësaj të dhëne, i jemi drejtuar ASHK-së Tiranë. Sqaroj se para fitimit të kësaj pasurie, unë dhe bashkëshorti nuk kemi pasur asnjë pasuri tjetër të paluajtshme të regjistruar në emrin tonë”.

### **Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit**

**1.9** Komisioni hetoi lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie në raport me çmimet e përcaktuara për ndërtimet në qytetin e Tiranës. Në vitin 2000 mungojnë të dhënat e tregut në qytetin e Tiranës dhe lidhur me çmimin e referencës Komisioni iu referua Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 31.5.2001, sipas të cilit rezultoi se vlera e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës është në vlerën 56,306 lekë për m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e ndërtimit të apartamentit të blerë nga subjekti i rivlerësimit është në total 151 m<sup>2</sup> (duke përfshirë edhe sipërfaqe të përbashkëta) dhe kostoja llogaritet në vlerën (151 x 56,306) 8,502,206 lekë. Subjekti duket se e ka blerë këtë pasuri në vlerën 5,000,000 lekë, pra më pak se vlera e tregut të lirë.

**1.10** Nisur nga fakti se vlera e blerjes së kësaj pasurie duket se është nën çmimin e tregut të lirë, subjektit të rivlerësimit iu kërkua nëse ka pasur ndonjë proces gjyqësor me palë shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. apo me ortakun e saj A. D. Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka deklaruar se ka pasur 3 çështje gjyqësore me palë ortakun dhe shoqërinë “\*\*\*\*”, konkretisht në vitet 2011, 2013 dhe 2019.

<sup>3</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2018, të ZVRPP-së Tiranë në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>4</sup> Shihni dokumentin urdhërshirimi i jashtëm i Bankës së Kursimeve lëshuar më 12.10.2000.

**1.11** Komisioni konstatoi se subjekti duhej të kërkonte të hiqte dorë nga çështjet gjyqësore me këtë shoqëri, me të cilën kishte lidhur kontratë shitblerjeje apartamenti nën çmimin e tregut, për të shmangur kështu konfliktin e interesit në dukje.

### **Lidhur me kredinë e përfituar nga Banka e Kursimeve**

**1.12** Për blerjen e kësaj pasurie rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti kanë përfituar një kredi nga ish-Banka e Kursimeve. Kjo kredi duket se është përfituar në bazë të VKM-së nr. 192, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve të administratës së lartë shtetërore”. Lidhur me përfitimin e kredisë financiare nga ish-Banka e Kursimeve/Raiffeisen Bank, Komisioni i kërkoj subjektit të vërë në dispozicion kopje të dokumentacionit përfitues të kredisë. Në përgjigje të pyetësorit<sup>5</sup>, subjekti vuri në dispozicion dokumentacionin e dërguar nga Raiffeisen Bank lidhur me përfitimin e kredisë në emër të bashkëshortit për shkak të funksionit.

**1.13** Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2023, të Raiffeisen Bank, rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka lidhur një kontratë huaje për blerje banese me huadhënës Dega e Bankës së Kursimeve Tirana 3 (kontrata nr. \*\*\*, datë 8.9.2000). Huaja është në shumën 5,000,000 lekë, me interes 3% në vit me afat 25 vjet. Në pikën 15 të kësaj kontrate huaje është përcaktuar se: *“Kjo kontratë huaje bazohet në VKM-në nr. 102, datë 5.3.1999, e cila përbën të drejtën për të aplikuar”*.

**1.14** Nga praktika e Raiffeisen Bank konstatohet se me anë të kërkesës personale bashkëshorti i subjektit në datën 10.7.2000 i është drejtuar Bankës së Kursimeve për t’u kredituar në shumën 5,000,000 lekë, bazuar në VKM-në nr. 102, datë 5.3.1999. Në këtë kërkesë bashkëshorti i subjektit deklaroi se nuk zotëron banesë aktuale të përfituar me privatizim apo me çdo mënyrë tjetër ligjore.

**1.15** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.7.2000, ZVRPP-ja Tirana 1 ka lëshuar vërtetim negativ ku, nga të dhënat e regjistrimit hipotekor, nuk figuron e regjistruar ndonjë pronë me barrë hipotekore në ngarkim të shtetasit M.M. Gjithashtu, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, me shkresën datë 5.7.2000 konfirmon se shtetasi M.M është në pozicionin e ministrit të Ekonomisë Publike. ZVRPP Skrapar, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.7.2000, vërteton se shtetasi M. M dhe pjesëtarët e tjerë të familjes deri më 5.7.2000 nuk figurojnë të kenë regjistruar në pronësi të tyre pasuri të paluajtshme në regjistrat e ZVRPP-së Skrapar.

**1.16** Referuar VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, përfitimi për kreditimin në vlerën 5,000,000 lekë bëhej për funksionarët e lartë shtetërorë dhe në rastet kur subjekti nuk kishte në pronësi pasuri të paluajtshme. Nga të dhënat e administruara duket se këto 2 kritere janë plotësuar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj në kohën e përfitimit të kredisë.

**1.17** Në përfundim të hetimit, Komisioni konstatoi se:

- Ka mospërputhje lidhur me pagesën e detyrimit të palës shitëse në raport me datën e nënshkrimit të kontratës së shitjes së pasurisë apartament.
- Subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë regjistruar pasurinë apartament në emër të tyre si pronar përpara se të aplikonin për kredi, si dhe përpara lëvrimit dhe likuidimit të shumës 5,000,000 lekë, palës shitëse.
- Subjekti ka vendosur hipotekimin e kësaj pasurie për efekt të sigurimit të huas para likuidimit të shumës palës shitëse.
- Subjekti dhe bashkëshorti kanë përfituar pasurinë apartament nën vlerën e tregut të lirë.
- Subjekti nuk ka bërë kërkesë për heqje dorë dhe ka shqyrtuar çështje gjyqësore me palën shitëse të apartamentit shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., duke mos shmangur kështu konfliktin e

<sup>5</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2023.

interesit në dukje. Subjekti të shpjegojë dhe dokumentojë vendimmarrjet e saj me shoqërinë ndërtimore.

**1.18** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**1.19** Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar<sup>6</sup> se: “Apartamenti me sipërfaqe 151 m<sup>2</sup> është blerë në vitin 2000, kundrejt vlerës 5,000,000 lekë, financuar 100% nëpërmjet një kredie të Bankës së Kursimeve. Në konkluzionet e hetimit të Komisionit nuk janë marrë parasysh kërkesat e VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”. Me dokumentacionin e vënë në dispozicion provohet se kronologjia e veprimeve ndjek rigorozisht kërkesat e VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, çka do të thotë se në aspektin formal juridik nuk ka asnjë shmangie nga kërkesat ligjore.

Pagesa e detyrimit për vlerën e kontratës është realizuar vetëm në përfundim të procedurave të kreditimit. Sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 102/1999, nuk mund të realizohet kreditimi, pa u realizuar më parë procedura: kontratë shitblerjeje regjistrim i pronës, kontratë huaje, kontratë hipotekimi. Vetëm pas përfundimit të kësaj procedure mund të kryhet disbursimi i kredisë dhe pagesa e çmimit. Kjo procedurë ka zgjatur nga data 24.6.2000 deri në datën 12.10.2000.

Regjistrimi i pasurisë ka qenë kusht i përcaktuar nga VKM-ja nr. 102/1999, në mënyrë që të realizohet procesi i kreditimit nga banka.

Hipotekimi është bërë në datën 8.9.2000, ndërsa pagesa e çmimit në datën 12.10.2000, kushtëzuar nga kërkesa e VKM-së nr. 102/99, që përcakton: “Ekzekutimi i kredisë të bëhet pasi përfituesi i kredisë të vendosë për Bankën e Kursimeve me barrë hipotekore banesën e blerë apo të ndërtuar me kredi”.

Blerja e apartamentit është realizuar nëpërmjet negociatave me palën shitëse dhe çmimi kontraktor është dakordësuar me vullnet të lirë të palëve. Referenca e vitit 2001 është një fakt i pakundërshtueshëm, sikurse është fakt se çmimi i dakordësuar nga palët është çmim real dhe dukshëm në të njëjtin nivel me çmimin e shitjes së aplikuar në vitin 2000, për apartamente të tjera në të njëjtën godinë banimi. Me kërkesën time, subjekti shitës ka vënë në dispozicion 8 kontrata shitblerjeje<sup>7</sup>, që i përkasin të gjitha vitit 2000 dhe të gjitha kanë një çmim shitjeblerjeje për metër katror thuajse të njëjtë me çmimin e blerjes së apartamentit.

Në lidhje me konfliktin e interesit konstatohet se të tri gjykimet janë kryer<sup>8</sup> në një kohë shumë më të vonë se momenti i përfundimit të transaksionit të blerjes së apartamentit. Në asnjë prej këtyre çështjeve nuk ka ekzistuar shkak ligjor që të më vendoste në pozitën e konfliktit të interesit në momentin e gjykimit. Konflikti i interesit në lidhje me çështjet gjyqësore rregullohet nga neni 13, pika 2, e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, i cili ka përcaktuar se: “2. Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas këtij kreu, bëhen vetëm për ato veprime që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një procedimi penal ose hetimi parlamentar”. Vlerësimi i pajtueshmërisë në gjykimin e këtyre çështjeve është bërë duke konsideruar rigorozisht kërkesat e nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, qëndrim që ka gjetur mbështetje edhe në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”.

<sup>6</sup> Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

<sup>7</sup> Subjekti ka sjellë dokumentacion plotësues: kontrata shitblerjeje pasurie të paluajtshme, bashkëlidhur vërtetimit noterial nr. \*\*\* rep., datë 9.9.2023.

<sup>8</sup> Subjekti sqaron se kjo konstatohet nga të dhënat e nxjerra nga sistemi elektronik i gjykatës, të cilat i ka depozituar për vlerësim.



## Vlerësimi i Komisionit

**1.20** Rezultoi se regjistrimi i pasurisë apartament me sip. 151 m<sup>2</sup>, në vitin 2000, është bërë para kryerjes së pagesës në vlerën 5,000,000 lekë, me burim kredinë tek ish-Banka e Kursimeve.

**1.21** Komisioni nuk bie dakord me shpjegimet e subjektit se ishte kusht ligjor që pasuria të regjistrohej në fillim në emër të palës blerëse pranë ZVRPP-së, pastaj të aplikohet për kredi dhe më pas t'i kalohej vlera e përfituar nga kredia palës shitëse.

**1.22** Në momentin e blerjes me kontratë shitblerjeje dhe regjistrimit të kësaj pasurie të paluajtshme të blerë, konsiderohesh pronar i pasurisë në fjalë, për të cilën kanë përfunduar të gjitha veprimet juridike dhe janë shlyer detyrimet financiare për palët. Legjislacioni shqiptar parashikon forma të ndryshme të blerjes së pasurisë së paluajtshme edhe me kusht, të cilat mund të ishin ndjekur nga subjekti i rivlerësimit si magjistrate dhe bashkëshorti i saj.

**1.23** Komisioni dakordësohet me shpjegimet e subjektit se çmimi i blerjes përcaktohet me vullnetin e lirë të palëve, por vlerëson se nëse ky çmim është më i lirë se vlera e tregut aty lindi dyshime për favorizim të çmimit të blerjes së kësaj pasurie dhe duhen hetuar dhe vlerësuar edhe elemente të tjera. Komisioni vlerësoi se subjekti paraqiti si provë edhe kontrata të tjera të ngjashme të përafërta në çmim me apartamentin e blerë nga ana e saj, në të njëjtën godinë dhe periudhë, gjë që lehtësoi pozitën e saj në raport me barrën e provës të lënë për këtë çështje.

**1.24** Çështjet e gjykuara nga subjekti me palë shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. u konstatuan se janë kryer disa vite më vonë se momenti i përfundimit të transaksionit të blerjes së apartamentit. Komisioni, në analizë të fakteve të dala në raport me legjislacionin që rregullon situatën e konfliktit të interesit, e lidhur ngushtë me veprimtarinë gjyqësore/procedurale të saj si gjyqtare, rregulluar nga Kodi i Procedurës Civile, nenet 72 dhe 73 të tij, konstaton se nuk provohet gjendja e konfliktit faktik të interesit, por, pavarësisht këtij konstatimi, Komisioni këtë situatë e çmon në kontekstin e cenimit të integritetit<sup>9</sup>, si pjesë e vlerësimit të aftësive profesionale e, për rrjedhojë, e ka mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**2. Automjet tip “\*\*\*\*”, i deklaruar nga subjekti, blerë në datën 4.11.2004 kundrejt çmimit 700,000 lekë. Burimi i blerjes: financim 100% nga të ardhurat e përbashkëta nga pagat; përjashtuar nga pagesa për zhdoganim, për shkak të funksionit “Deputet” të blerësit. Pjesa takuese: 100% me bashkëshortin.**

## Hetimi i Komisionit

**2.1** Rezultoi se me anë të kontratës së shitblerjes së automjetit nr. \*\*\*, datë 4.11.2004, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit M.M ka blerë automjetin tip “\*\*\*\*”, në vlerën 700,000 lekë.

**2.2** Me shkresën datë 26.1.2017<sup>10</sup> të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave konstatohet se automjeti me nr. shasie \*\*\*, që korrespondon me atë të z. M.M , është zhdoganuar më 24.11.2004. Në këtë shkresë nuk përcaktohet pagimi i detyrimeve doganore. Më pas është lëshuar edhe certifikatë pronësie e automjetit tip “\*\*\*\*”, me targë TR \*\*\* K, në pronësi të shtetasit M.M .

**2.3** DPSHTRR-ja<sup>11</sup> konfirmon se shtetasi M.M ka në pronësinë e tij automjetin me targë AA \*\*\* OK, përfituar me kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 4.11.2004, blerës M.M , i automjetit tip “\*\*\*\*”, në vlerën 700,000 lekë.

<sup>9</sup> Referuar edhe vendimit nr. 3/2020 të Kolegjit.

<sup>10</sup> Shihni përgjigjen e DPSHTRR-së në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>11</sup> Shihni shkresat e DPSHTRR-së me nr. \*\*\*, të datave 11.8.2017 dhe 11.9.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

**2.4** Në deklaratën periodike për vitin 2004, subjekti ka deklaruar: *“Automjet tip “\*\*\*”, prodhuar në vitin 1997, në vlerën 700,000 lekë, blerë në datën 4.11.2004”*. Në këtë deklaratë periodike subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit.

### **Analiza financiare**

**2.5** Komisioni hartoi analizën financiare lidhur me mundësitë e subjektit dhe bashkëshortit për blerjen e kësaj pasurie bazuar në të ardhurat e deklaruara në deklaratën *Vetting* (nga të ardhurat e përbashkëta nga pagat).

**2.6** Nga analiza financiare paraprake rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip *“\*\*\*”*, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës. Në këtë analizë financiare nuk janë përfshirë shpenzimet doganore për këtë automjet.

**2.7** Për këtë, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacion provues lidhur me deklarimin e saj për mospagim të detyrimeve doganore për këtë automjet të blerë në vitin 2004.

**2.8** Në përgjigje të pyetësorit<sup>12</sup>, subjekti deklaroi se në datën 23.6.2023 i është drejtuar me shkresë degës së Doganës Tiranë dhe pritet marrja e informacionit nga ky institucion.

**2.9** Lidhur me pagimin e detyrimeve doganore, Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.9.2023, i kërkoi informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**2.10** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka informuar se: *“Sipas të dhënave të sistemit elektronik ASYCUDA WORLD, shtetasi M.P. M me ID \*\*\*, rezulton se nuk ka kryer procedura doganore importi dhe eksporti. Në lidhje me automjetin me targë TR \*\*\* K, të blerë në vitin 2004 nga ky shtetas, nuk mund të kryejmë verifikime me qëllim evidentimin e deklaratës doganore të zhdoganimit të këtij automjeti, pasi verifikimet në sistem kryhen me numër personal (ID) ose me numrin e shasisë së automjetit. Të dhënat e automjeteve vetëm duke i vënë në dispozicion targën TR \*\*\* K, i disponon DPSHTRR-ja, ku pjesë e dosjes së mjetit ndodhet edhe deklarata doganore e zhdoganimit të automjetit”*.

**2.11** Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur ndonjë çështje gjyqësore me palën shitëse të automjetit A. J.

**2.12** Në rezultatet e hetimit subjektit të rivlerësimit iu kërkua të vërë në dispozicion të Komisionit përgjigjen e degës së Doganës Tiranë lidhur me pagimin ose jo të detyrimeve doganore të automjetit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**2.13** Sipas subjektit, gjetjet e Komisionit lidhur me pronësinë mbi automjetin me targë TR \*\*\* janë të sakta dhe, mbi bazën e detyrës së lënë në konkluzione, nga ana e saj është përsëritur verbalisht kërkesa kundrejt degës së Doganës Tiranë për marrjen e informacionit lidhur me pagimin e detyrimit doganor.

**2.14** Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2023, drejtuar DDT-së, nuk është marrë përgjigje nga ky institucion. Referuar shkresës së DPD-së datë 15.9.2023, konstatohet se: *“...të dhënat e automjeteve vetëm duke i vënë në dispozicion targën TR \*\*\* K, i disponon DPSHTRR-ja, ku pjesë e dosjes së mjetit ndodhet edhe deklarata doganore e zhdoganimit të automjetit”*. Nga DPSHTRR-ja është mundësuar vënia në dispozicion e dokumenteve të dosjes së automjetit, vërtetim zhdoganimi dhe deklaratë doganore, të cilat pasqyrojnë të dhëna lidhur me zhdoganimin.

**2.15** Në përfundim, subjekti deklaroi se nuk e disponon përgjigjen e degës së Doganës Tiranë dhe, në rast se institucioni do të përgjigjet, menjëherë do ta depozitonte atë pranë Komisionit.

<sup>12</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit datë 29.6.2023.

Subjekti ka paraqitur si dokumentacion plotësues: deklaratë doganore datë 24.11.2004 dhe vërtetim zhdoganimi datë 24.11.2004.

### Vlerësimi i Komisionit

**2.16** Në përgjigje të rezultateve të hetimit lidhur me automjetin me targë TR \*\*\* K, subjekti deklaroi se ende nuk ka arritur të përmbysë barrën e provës së lënë nga Komisioni.

**2.17** Subjekti nuk arriti të provojë moskryerjen e detyrimeve doganore për këtë automjet. Gjithashtu, subjekti nuk shpjegoi në bazë të kujt dispozite ligjore në fuqi ka përfituar përjashtimin nga detyrimet doganore dhe nuk sqaroi as procedurën e ndjekur për këtë përfitim.

**2.18** Komisioni konstatoi se neni 17 i ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999, “Për statusin e deputetit”, i ndryshuar, parashikon që deputetit i lejohet që vetëm në një rast gjatë mandatit të tij të mos paguajë detyrimin doganor për mjetet e punës që lidhen me veprimtarinë e tij si deputet. Subjekti nuk provoi të ishte në kushtet e përcaktuara nga kjo dispozitë ligjore, për më tepër konstatohet se ky automjet është disponuar si automjet personal.

**2.19** Dokumentacioni i sjellë si provë nga subjekti (deklarata doganore dhe vërtetim zhdoganimi<sup>13</sup>) nuk përcakton se bashkëshorti i subjektit është përjashtuar nga pagimi i tarifës doganore për shkak të funksionit.

**2.20** Mbi bazën e vërtetimit të zhdoganimit rezulton se zhdoganimi i mjetit është realizuar, çka logjikisht arrihet në konkluzionin se ky automjet është zhdoganuar duke kryer edhe pagesën e tarifës doganore të përcaktuar në këtë dokument, konform dispozitave ligjore.

**2.21** Vlera e detyrimeve doganore e përcaktuar në deklaratën doganore me nr. \*\*\*, datë 24.11.2004, u përfshi në analizën financiare të pasurisë dhe në analizën financiare për vitin 2004, si shpenzim në vlerën totale 323,766 lekë.

### Analiza financiare

**2.22** Komisioni hartoi edhe një herë analizën financiare lidhur me mundësitë e subjektit dhe bashkëshortit për blerjen e kësaj pasurie, bazuar në të ardhurat e deklaruara në deklaratën *Vetting* (nga të ardhurat e përbashkëta nga pagat).

### Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “\*\*\*”, me targë TR \*\*\* K

| Përshkrimi                                                        | Vlera            |
|-------------------------------------------------------------------|------------------|
| Të ardhura subjekti 1.1.2004 – 4.11.2004                          | 696,210          |
| Të ardhura bashkëshorti 1.1.2004 – 4.11.2004                      | 1,287,658        |
| <b>Të ardhura totale 1.1.2004 – 4.11.2004</b>                     | <b>1,983,868</b> |
| Shpenzime jetese 1.1.2004 – 4.11.2004                             | 313,213          |
| Shpenzime arsimimi fëmijët 1.1.2004 – 4.11.2004                   | 120,000          |
| Shpenzime për kreditë tek Raiffeisen Bank 1.1.2004 – 4.11.2004    | 237,103          |
| Shpenzime udhëtimi 1.1.2004 – 4.11.2004                           | 50,696           |
| <b>Shpenzime totale 1.1.2004 – 4.11.2004</b>                      | <b>721,013</b>   |
| Ndryshim likuiditete 31.12.2003 – 4.11.2004                       | 179,582          |
| Blerje automjet tip “***”, TR *** K – 4.11.2004                   | 700,000          |
| Detyrime doganore për automjetin tip “***”, TR *** K – 24.11.2004 | 323,766          |
| <b>Mundësia financiare</b>                                        | <b>59,508</b>    |

**2.23** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “\*\*\*”, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës.

<sup>13</sup> Shihni dokumentacion shkresor të paraqitur nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

### **3. Gjendje *cash* në llogari**

**3.1** Subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në llogari rrjedhëse në lekë, pranë Credins Bank, çelur në datën 30.6.2010, në shumën 3,992 lekë. Pjesa takuese: 100%.

**3.2** Credins Bank, me vërtetimin nr. \*\*\*, datë 25.1.2017, ka konfirmuar se znj. Blerina Muço disponon llogari me gjendje në datën 25.1.2017, në vlerën 3,992 lekë. Gjithashtu, me shkresën datë 15.8.2017<sup>14</sup> ka konfirmuar se znj. Blerina Muço disponon llogari page me gjendje në datën 27.1.2017, në vlerën 8,192 lekë.

**3.3** Gjendja e kësaj llogarie rrjedhëse konstatohet edhe nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2022, e Credins Bank, e administruar në dosjen e Komisionit si llogari page.

**3.4** Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë llogari rrjedhëse në lekë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

### **4. Gjendje *cash* në depozitë**

**4.1** Subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në depozitë me afat, pranë Intesa Sanpaolo Bank, në emër të bashkëshortit, depozituar në datën 25.4.2012, në shumën 27,000 euro.

**4.2** Intesa Sanpaolo Bank<sup>15</sup> konfirmon se shtetasi M.M disponon llogari me gjendje në datën 27.1.2017, në vlerën 27,000 euro. Gjendja e kësaj llogarie konstatohet edhe nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2022, e Intesa Sanpaolo Bank, e administruar në dosjen e Komisionit.

**4.3** Nga *statement*-i bankar i llogarive të bashkëshortit të subjektit tek Intesa Sanpaolo Bank konstatohet se burimi i krijimit të kësaj depozite janë vlerat monetare, që bashkëshortit të subjektit i kanë kaluar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k./“\*\*\*\*” sh.p.k. për periudhën 2008 – 2010. Këto vlera monetare pretendohen nga subjekti si të ardhura nga konsulencë financiare të dhënë nga bashkëshorti i saj, por për të cilat nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse<sup>16</sup>. Si rrjedhim, nuk vërtetohet burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj depozite.

**4.4** Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë likuiditet bankar në vlerën 27,000 euro dhe për këtë i kaloi barrën e provës.

**4.5** Subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, e cila në përgjigje të rezultateve të hetimit deklaroi: *“Analiza e Komisionit lidhur me burimin e krijimit të depozitës në llogarinë e bashkëshortit në euro pranë Intesa Sanpaolo Bank është e saktë, por nuk bie dakord me përfundimin se nuk vërtetohet ligjshmëria e burimit të krijimit, për shkak se nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore mbi shpërblimin që ka shërbyer për krijimin e depozitës”*.

**4.6** Kjo çështje është trajtuar nga Komisioni më poshtë në këtë vendim në kreun “Të ardhurat”.

### **5. Gjendje *cash* në llogari rrjedhëse në lekë**

**5.1** Subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në llogari rrjedhëse në lekë pranë Intesa Sanpaolo Bank, në emër të bashkëshortit, çelur më 3.10.2005, në shumën 230,157 lekë.

**5.2** Gjendja e kësaj llogarie konstatohet edhe nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2022, e Intesa Sanpaolo Bank, e administruar në dosjen e Komisionit.

**5.3** Nga *statement*-i bankar duket se kjo është llogari page e bashkëshortit të subjektit, në të cilën kanë kaluar pagesat kalimtare nga ISSH-ja për vitet 2005 – 2008, si dhe një pagesë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në vitin 2016.

<sup>14</sup> Shihni shkresën e Credins Bank në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>15</sup> Shihni shkresën e Intesa Sanpaolo Bank me nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>16</sup> Shihni kreun “Të ardhurat”.

**5.4** Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë llogari në lekë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

## **6. Gjendje cash në llogari rrjedhëse në euro**

**6.1** Subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në llogari rrjedhëse në euro në emër të bashkëshortit pranë Intesa Sanpaolo Bank, çelur më 3.10.2005, në shumën 1,850 euro.

**6.2** Gjendja e kësaj llogarie konstatohet edhe nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2022, e Intesa Sanpaolo Bank, e administruar në dosjen e Komisionit.

**6.3** Nga *statement*-i bankar duket se në këtë llogari kanë kaluar vlera monetare nga shërbimet e konsulencës që bashkëshorti i subjektit deklaroi se ka ofruar pranë subjekteve të ndryshme<sup>17</sup>. Nga kjo llogari është krijuar një depozitë me vlerë 50,000 euro në vitet 2005 – 2008, e cila është tërhequr nga subjekti në vitin 2008 për t'u mbajtur si gjendje *cash* në shtëpi, si dhe depozita në vlerën 27,000 euro, e cila u trajtua më sipër në pikën 4.

**6.4** Gjendja përfundimtare në këtë llogari ka si burim një kalim në vlerën 1,700 euro nga shoqëria “\*\*\*”, në vitin 2016<sup>18</sup>, si dhe interesat e përfituar nga depozita prej 27,000 euro.

**6.5** Në përfundim të hetimit, Komisioni doli në konkluzionin se subjekti duhet të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 50,000 euro (e tërhequr në vitin 2008 dhe mbajtur *cash*). Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka deklaruar se: *“Konstatimet e Komisionit lidhur me gjendjen e llogarisë janë të sakta, ndërsa sa i takon kërkesës për të provuar burimin e ligjshëm, parashtruar në konkluzionet e Komisionit, duke çmuar se lidhet me gjetjen mbi gjendjen cash në depozitë, edhe argumentet mbi këtë pikë i gjeni gjithashtu në shpjegimet për “Gjetjet mbi të ardhurat”.*

**6.6** Kjo çështje është trajtuar nga Komisioni më poshtë në këtë vendim në kreun “Të ardhurat”.

## **7. Gjendje cash në llogari rrjedhëse në lekë**

**7.1** Subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në llogari rrjedhëse në lekë, pranë Bankës Kombëtare Tregtare, në emër të bashkëshortit, çelur në datën 1.1.2009, në shumën 152,320 lekë.

**7.2** Gjendja e kësaj llogarie konstatohet edhe nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2022, e BKT-së, e administruar në dosjen e Komisionit.

**7.3** Nga *statement*-i bankar duket se burimi i kësaj vlere, gjendje në llogari, është nga pagat e marra nga bashkëshorti i subjektit nga shoqëria “\*\*\*” në vitin 2013.

**7.4** Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë llogari në lekë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

## **8. Gjendje cash në llogari rrjedhëse në euro**

**8.1** Subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në llogari rrjedhëse në euro, pranë Bankës Kombëtare Tregtare, në emër të bashkëshortit, çelur në datën 1.1.2009, në shumën 499 euro.

**8.2** Gjendja e kësaj llogarie konstatohet edhe nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2022, e BKT-së, e administruar në dosjen e Komisionit.

**8.3** Sipas *statement*-it bankar të llogarisë duket se burimi i këtyre likuiditeteve janë nga llogaria bankare e personit fizik të bashkëshortit pranë të njëjtës bankë.

**8.4** Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë llogari në euro të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>17</sup> Shihni kreun “Të ardhurat”.

<sup>18</sup> Të ardhurat nga \*\*\* sh.p.k., trajtuar tek “Të ardhurat nga paga”.

## **9. Gjendje *cash* depozitë në euro**

**9.1** Subjekti ka deklaruar gjendje *cash* depozitë në euro, pranë Bankës Kombëtare Tregtare, në emër të bashkëshortit, çelur në datën 24.5.2011, në shumën 7,031 euro.

**9.2** Gjendja e kësaj llogarie konstatohet edhe nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2022, e BKT-së, e administruar në dosjen e Komisionit.

**9.3** Sipas *statement*-it bankar të llogarisë duket se burimi i këtyre likuiditeteve janë nga llogaria bankare e personit fizik të bashkëshortit pranë të njëjtës bankë.

**9.4** Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë llogari në euro të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

## **10. Gjendje *cash* në llogari rrjedhëse në lekë**

**10.1** Subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në lekë, pranë Raiffeisen Bank, në emër të bashkëshortit, çelur në datën 1.10.2003, në shumën 587,254 lekë.

**10.2** Gjendja e kësaj llogarie konstatohet edhe nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2022, e Raiffeisen Bank, e administruar në dosjen e Komisionit.

**10.3** Sipas *statement*-it bankar të llogarisë duket se kjo është llogari rrjedhëse, në të cilën është paguar kredia e marrë për blerjen e apartamentit.

**10.4** Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë llogari në lekë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

## **11. Gjendje *cash* në llogari rrjedhëse në CAD**

**11.1** Subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në llogari rrjedhëse në dollar kanadez (CAD), pranë Raiffeisen Bank, në emër të bashkëshortit, çelur në datën 4.11.2009, në shumën 183 CAD.

**11.2** Gjendja e kësaj llogarie konstatohet edhe nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2022, e Raiffeisen Bank, e administruar në dosjen e Komisionit.

**11.3** Sipas *statement*-it bankar të llogarisë duket se përmes saj janë kaluar disa nga pagesat për studimet e djalit në Kanada.

**11.4** Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë llogari në CAD të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

## **12. Deklarimi i detyrimeve**

**12.1** Kredi nga Banka e Kursimeve/Raiffeisen Bank për blerje apartamenti banimi, Rruga e \*\*\* (rr. “\*\*\*”, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, kodi postar \*\*\*), Tiranë, në shumën 5,000,000 lekë, me interes vjetor 3%, me afat shlyerje 25 vjet, me këst mujor 23,710 lekë. Ka filluar në vitin 2000 dhe përfundon në vitin 2025. Për efekt të sigurimit të huas, në favor të Bankës së Kursimeve/Raiffeisen Bank është hipotekuar apartament objekt i financimit. Vlera e detyrimit është 2,209,145 lekë.

**12.2** Me vërtetimin nr. \*\*\*, datë 20.1.2017, Raiffeisen Bank konfirmon se z. M.M ka kredi me afat 29.8.2004 – 29.10.2025 dhe në datën 20.1.2017, gjendja e detyrimit ka qenë 2,209,145 lekë.

**12.3** Gjithashtu, Raiffeisen Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2017, konfirmon se z. M.M disponon kredi me gjendje në datën 27.1.2017, në vlerën 2,205,765 lekë.

**12.4** Kjo kredi dhe përdorimi i saj është trajtuar në pikën 1 të këtij relacioni, pasi ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament në Rrugën e \*\*\*, blerë në vitin 2000.

**12.5** Vlerat e shlyerjes së kredisë ndër vite janë përfshirë si shpenzim në analizën financiare në vitet përkatëse.

### **13. Deklarimi i bashkëshortit të subjektit, z. M.M**

**13.1** Bashkëshorti i subjekti ka deklaruar se nuk disponon pasuri veçmas.

### **14. Deklarim i djalit të subjektit, z. L. M**

#### **14.1 Bashkëqiramarrës në një banesë**

- Djali i subjektit ka deklaruar se është bashkëqiramarrës i një banese të ndodhur në adresën: \*\*\* West 27-th Avenue, V B.C.V5Y 2K5, Canada, me vlerë mujore të përgjithshme qiraje 1,800 CAD, me pjesë takuese në vlerën 600 CAD. Pagesa kryhet nga prindërit 33%.
- Për të provuar deklarin lidhur me këtë qira subjekti ka paraqitur marrëveshje qiraje datë 6.8.2016, me qiramarrës S. M, të një apartamenti të ndodhur në adresën \*\*\* West 27-th Avenue, V, Canada, me afat deri më 31.8.2017, me vlerë 1,800 CAD /mujore.
- Shpenzimet e kryera këtë periudhë për qiranë janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2016.

### **ÇËSHTJE TË TJERA**

#### **15. Gjendje *cash* në shtëpi**

**15.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në shtëpi. Komisioni hetoi lidhur me deklarinimet e subjektit ndër vite mbi gjendjen *cash* dhe ndryshimet e saj (shtesa dhe pakësime).

**15.2** Rezultoi se subjekti ka deklaruar gjendje *cash* për herë të parë në DPV-në e vitit 2005 “*Shtesë cash në shumën 300,000 lekë nga të ardhurat*”:

- në DPV-në e vitit 2006 ka deklaruar shtesë *cash* në shumën 500,000 lekë;
- në DPV-në e vitit 2007 ka deklaruar pakësim *cash* -800,000 lekë;
- në DPV-në e vitit 2008 ka deklaruar gjendje *cash* në banesë 47,000 euro;
- në DPV-në e vitit 2009 ka deklaruar pakësim *cash* 11,000 euro (pagesë shkollimi djali) – 15,000 CAD;
- në DPV-në e vitit 2010 ka deklaruar pakësim i gjendjes *cash* në shumën 3,100 euro;
- në DPV-në e vitit 2011 ka deklaruar pakësim *cash* në shumën 14,900 euro (për shpenzime shkollimi të djalit dhe jetesës);
- në DPV-në e vitit 2012 ka deklaruar pakësim *cash* në shumën 15,200 euro, gjendje shuma 2,800 euro;
- në DPV-në e vitit 2013 ka deklaruar shtesë likuiditeti – kursime nga të ardhurat personale të vitit 2013, në vlerën 260 euro, pra sipas kësaj deklarate periodike subjekti dispononte në vitin 2013 gjendje *cash* 2,800 euro + 260 euro;
- në DPV-në e vitit 2014 e në vazhdim nuk ka deklaruar ndryshim të gjendjes *cash*.

**15.3** Në DPV-në e vitit 2008, subjekti deklaroi për herë të parë kursime *cash* në monedhën euro në vlerën 47,000 euro. Në përgjigje të pyetësorit 2, të mbërritur në datën 25.7.2022, subjekti deklaroi: “*Në datën 10.10.2008, nga bashkëshorti është tërhequr nga llogaria në Bankën Amerikane (ISP) shuma e depozitës prej 50,000 euro, për shkak të krizës financiare bankare globale. Duke vlerësuar se mbajtja e kësaj gjendje në Bankë ishte e pasigurt, kjo është mbajtur në banesë dhe është përdorur për nevojat familjare, sipas deklarinimeve në DPV respektive, për disa vite*”.

**15.4** Nga *statement*-i i bankar i llogarisë së bashkëshortit të subjektit tek Intesa Sanpaolo Bank vërtetohet tërheqja e depozitës prej 50,000 euro, në datën 10.10.2008. Burimi i krijimit të kësaj depozite janë vlerat monetare, që bashkëshortit të subjektit i kanë kaluar nga “\*\*\*\*\*/\*\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe nga shoqëria “\*\*\*\*\*” për periudhën 2005 – 2008. Këto vlera monetare pretendohen nga subjekti si të ardhura nga konsulencë financiare të dhënë nga bashkëshorti i saj, por për të cilat nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse. Si rrjedhim, nuk vërtetohet burimi

i ligjshëm i krijimit të kësaj depozite e më pas kursimeve *cash* në monedhën euro, që rrjedhin nga tërheqja e depozitës nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2008<sup>19</sup>.

**15.5** Subjekti është pyetur të deklarojë ndryshimin e gjendjes *cash* në shtëpi nga viti 2004 deri në vitin 2016, si dhe nëse në vitet 2013 dhe 2014 kanë pasur likuiditete *cash* në shtëpi dhe në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, ajo ka deklaruar ndryshimet e gjendjes *cash* sipas deklaratave periodike vjetore. Gjithashtu ka deklaruar se në vitet 2013 – 2016 nuk ka pasur gjendje *cash* në shtëpi.

**15.6** Komisioni konstatoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë dhe ai subjekt deklarues në vitet 2003 – 2005, ku ka deklaruar gjendjen *cash* për këto 3 vite si më poshtë:

- Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar gjendje *cash* 0,8 milion lekë.
- Në DPV-në e vitit 2004 ka deklaruar pakësim *cash* në shumën 500,000 lekë.
- Në DPV-në e vitit 2005 nuk ka deklaruar ndryshim të gjendjes *cash*.

**15.7** Nisur nga fakti se nuk përkojnë deklaratimet e subjektit në DPV-të periodike me deklaratimet e bashkëshortit të saj në DPV-të periodike lidhur me gjendjen *cash*, u ripyet subjekti, e cila në përgjigje të pyetësorit<sup>20</sup> deklaroi: *“Në përgjigje të kësaj pyetjeje sqarohet se në DPV-në e vitit 2004, nga ana ime gabimisht janë deklaruar vetëm të ardhurat e siguruar nga puna ime si gjyqtare. Deklarimi i bashkëshortit në DPV-në e vitit 2004 është më i plotë, duke u deklaruar të ardhurat nga puna të të dy bashkëshortëve, si dhe shtesa në likuiditete në llogarinë e tij pranë Bankës Credins, gjendje në shumën 500,000 lekë.*

*Për vitin 2005, bashkëshorti ka plotësuar dhe dorëzuar pranë ILDKPKI-së formularin e largimit nga detyra datë 27.9.2005, duke mos cilësuar gjendje *cash* në këtë moment. Për rrjedhojë, gjendja *cash* në shumën 300,000 lekë, deklaruar nga ana ime në DPV-në e vitit 2005, pasqyron kursimet e realizuara përgjatë gjithë vitit të deklaratimit. Pasaktësitë si më sipër, janë pasojë e mosnjohjes së procesit të deklaratimit në fazat e tij fillestare”.*

**15.8** Në analizën financiare është pasqyruar gjendja *cash* (shtesa dhe pakësime) në vitet 2003 – 2004, sipas deklaratimeve të bashkëshortit të subjektit, dhe në vitin 2005 është pasqyruar gjendja *cash* në vlerën 300,000 lekë. Gjithashtu, nisur nga fakti se subjekti në DPV-të e viteve 2014 – 2016 nuk ka deklaruar ndryshim të gjendjes *cash*, gjendja progresive e fundvitit 2013 prej 2,800 euro + 260 euro është konsideruar si e pandryshuar në analizën financiare deri në vitin 2016. Kjo ndryshon nga deklarata *Vetting*, ku nuk janë deklaruar gjendje *cash* në shtëpi.

**15.9** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionet si vijon:

- Ka pasaktësi në deklaratim të gjendjes *cash* nga subjekti në DPV-të e viteve 2003 – 2005 në raport me deklaratimet e bashkëshortit të saj në DPV-të e këtyre viteve.
- Subjekti ka bërë deklarime të pasakta në deklaratat periodike vjetore, si dhe nuk ka deklaruar ndryshimet e gjendjes *cash* në DPV-të e viteve 2014 e në vazhdim.
- Ka mospërputhje me deklaratimin e gjendjes *cash* në *Vetting* me gjendjen *cash* në deklaratat periodike vjetore.
- Subjekti nuk ka vërtetuar burimin e krijimit të pasurisë *cash* në monedhën euro, në vitin 2008.

**15.10** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>19</sup> Shihni pikat 16 dhe 17 të rezultateve të hetimit, dërguar subjektit të rivlerësimit.

<sup>20</sup> Shihni përgjigjen e subjektit mbi pyetësorin nr. \*\*\*,



## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**15.11** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se: “As unë dhe as bashkëshorti nuk kemi deklaruar gjendje cash në DPV-në e vitit 2003. Konstatimi i Komisionit se në deklaratën e parafillimit të detyrës në vitin 2003 bashkëshorti ka deklaruar gjendje cash 0,8 milion lekë, është i paqartë dhe nuk rezulton të jetë pjesë e deklaratës së personit që mbart detyrim për deklarim pasurie, e cila është depozituar në datën 18.3.2004, në ILDKPKI.

Për vitin 2004, bashkëshorti ka deklaruar në DPV respektive, gjendje cash në llogarinë e pagës, Credins Bank, Tiranë, shumën 500,000 lekë. Është e paqartë se përse vlerësimi i kësaj shume është përfshirë në kreun mbi gjendjen cash në shtëpi. Ashtu sikurse është i paqartë konstatimi i pikës 15.6 se: “Në DPV-në e vitit 2004 (bashkëshorti) ka deklaruar pakësim cash në shumën 500,000 lekë. Nga dokumentacioni që disponoj, kopje e DPV-së së vitit 2004 e bashkëshortit nuk ka asnjë përshkrim lidhur me pakësimin e gjendjes cash në shtëpi, ndaj është e pamundur të jap shpjegime për një situatë të tillë. Sikurse u shpreha më sipër, nëse konkluzioni vjen nga dokument tjetër që nuk e disponoj, ju lutem të më vihet në dispozicion në mënyrë që të jap qëndrimin e nevojshëm.

Për vitin 2005, konstatimi i Komisionit në pikën 15.6 se: “Në DPV-në e vitit 2005 (bashkëshorti) nuk ka deklaruar ndryshim të gjendjes cash” është i drejtë.

Lidhur me konstatimin se: “Duket se subjekti ka deklarime të pasakta në deklaratat periodike vjetore... detajuar në pikën 15.7 të raportit, sqaroj se, sikurse kam pranuar në përgjigjet e pyetësorit nr. \*\*\*, në DPV-në 2004, gabimisht nuk është deklaruar prej meje shtesa e gjendjes cash në llogarinë e pagës së bashkëshortit, pranë Credins Bank, në shumën 500,000 lekë. Ky gabim nuk reflekton shmangie apo fshehje të pasurisë, por është thjesht një lapsus. Ndërkohë, deklaratimet e tjera janë të sakta, përjashtuar ndryshimet me deklaratimet e bashkëshortit për vitet 2003 – 2005, të evidentuara nga Komisioni në pikën 15,6, të cilat, sikurse kam sqaruar më sipër, nuk rezultojnë të provuara me dokumentacionin që disponojmë.

Sa i takon konstatimit se: “...si dhe nuk ka deklaruar ndryshimet e gjendjes cash në DPV-të e viteve 2014 e në vazhdim” sqaroj se ky konstatim është i drejtë pasi, sikurse kam deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, gjendja cash në banesë në vitin 2012, ka qenë në shumën 2,800 euro. Kjo shumë është shpenzuar në Vitin 2013, por gabimisht nuk është deklaruar si pakësim i gjendjes cash në banesë dhe, pavarësisht këtij gabimi, kjo shumë në mënyrë të drejtë, nuk është deklaruar në DPV në vijim dhe në deklaratën Vetting, sepse nuk ekzistonte. Sa më sipër, deklaratimet për vitet 2014 – 2016 për mungesën e gjendjes cash në banesë janë tërësisht të sakta.

Ndërkohë, lidhur me shumën 260 euro, konstatuar në pikën 15.8 të raportit, sqaroj se në DPV-në e vitit 2013, kjo shumë është deklaruar si shtesë në likuiditete, pa cilësuar se kjo shtesë është rezultat i balancës së llogarisë së bashkëshortit në euro pranë ISP, për vitin 2013, e cila rezulton me shtesë 260 euro. Në këto kushte, nuk kemi të bëjmë me shtesë të likuiditeteve cash në banesë.

Lidhur me konstatimin se: “Duket se ka mospërputhje me deklarimin e gjendjes cash në Vetting me gjendjen cash në deklaratat periodike vjetore”, referencë është pika 15.8, për gjendjen cash në banesë nga viti 2014 deri në vitin 2016. Sikurse sqarova më sipër, deklarimi në Vetting është i saktë dhe mospërputhja është pasojë e deklarimit të pasaktë në DPV-në 2013 lidhur me pakësimin në shumën 2.800 euro të gjendjes cash në banesë për vitin 2013”.

**15.12** Për këto deklarime, subjekti vuri në dispozicion kopje të dokumentacionit që sipas saj janë marrë nga deklaratat e pasurisë për vitet 2003 – 2005 të paraqitura nga bashkëshorti i saj pranë ILDKPKI-së (kopje e DPV-së së vitit 2003 e bashkëshortit; kopje e DPV/viti 2004 e bashkëshortit; kopje e deklaratës së bashkëshortit pas largimit nga funksioni datë 27.9.2005).

**15.13** Deklarimi i bërë nga subjekti mbi rezultatet e hetimit lidhur me gjendjen cash ndryshon nga deklarimi i bërë në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, ku ka deklaruar: “Sqaroj se në DPV-në

*e vitit 2004, nga ana ime gabimisht janë deklaruar vetëm të ardhurat e siguruara nga puna ime si gjyqtare. Deklarimi i bashkëshortit në DPV-në e vitit 2004 është më i plotë, duke u deklaruar të ardhurat nga puna të të dy bashkëshortëve, si dhe shtesa në likuiditete në llogarinë e tij pranë Credins Bank”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**15.14** Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me gjendjen *cash* në shtëpi në deklaratat periodike vjetore në raport edhe me gjendjen *cash* në deklaratën *Vetting*.

**15.15** Subjekti nuk ka deklaruar saktë gjendjen *cash* dhe ndryshimet e saj në vite (shtesa dhe pakësime) në deklaratat periodike vjetore të paraqitura në ILDKPKI.

**15.16** Në përgjigje të rezultateve, subjekti është munduar të paraqesë fakte dhe prova në kundërshtim me formularët e pasurisë dhe dokumentacionin e dorëzuar pranë ILDKPKI-së ndër vite. Konkretisht, subjekti ka deklaruar se në vitin 2003, bashkëshorti i saj nuk ka deklaruar gjendje *cash* në shtëpi dhe për këtë ka paraqitur një kopje të deklaratës së pasurisë të dorëzuar në datën 18.3.2004.

**15.16.1** Kjo kopje e deklaratës e paraqitur nga subjekti (te formulari A5, Likuiditete) nuk përmban shënime lidhur me gjendjen *cash* në shtëpi, e cila ndryshon me deklaratën e paraqitur nga ILDKPKI-ja<sup>21</sup> pranë Komisionit. Sipas deklaratës së paraqitur nga ILDKPKI-ja (deklarata e datës 18.3.2004) rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit te formulari A5, Likuiditete, ka deklaruar gjendje *cash* 0.8 milion lekë me burim – kursime nga të ardhurat. Kopje të kësaj deklarate Komisioni ia ka vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit si pjesë e rezultateve të hetimit.

**15.16.2** Në DPV-në e vitit 2004 (bashkëshorti) ka deklaruar: *“Pakësim cash në shumën 500,000 lekë. Nga dokumentacioni që disponoj, kopje e DPV-së 2004 e bashkëshortit, nuk ka asnjë përshkrim lidhur me pakësimin e gjendjes cash në shtëpi, ndaj është e pamundur të jap shpjegime për një situatë të tillë”.*

**15.16.3** Kjo kopje e deklaratës e paraqitur nga subjekti (te rubrika “Informacion Konfidencial”) nuk përmban shënime lidhur me ndryshimin e gjendjes *cash* në shtëpi, e cila ndryshon me deklaratën e paraqitur nga ILDKPKI-ja<sup>22</sup> pranë Komisionit. Sipas deklaratës së paraqitur nga ILDKPKI-ja (deklarata e datës 24.3.2005) rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit te formulari Informacion Konfidencial ka deklaruar: *“Pakësuar cash në shumën 500,000 lekë”.* Kopje të kësaj deklarate periodike Komisioni ia ka vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit, si pjesë e rezultateve të hetimit.

**15.17** Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti është munduar të shfaqë në mënyrë të pasaktë faktet dhe rrethanat lidhur me deklaramet e bëra sa i përket gjendjes *cash* ndër vite. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar në mënyrë jo të drejtë se deklaratat periodike vjetore të bashkëshortit të saj nuk i janë vënë në dispozicion nga Komisioni.

**15.18** Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se pretendimet e subjektit janë kryer në kundërshtim me ligjin, duke shtrembëruar faktet dhe provat shkresore, si dhe veprimet saj për të shfaqur një situatë tjetër joreale cenojnë figurën si magjistrate. Ky vlerësim i Komisionit do të merret në konsideratë në qëndrimin përfundimtar, bazuar edhe në çështjet e tjera të evidentuara për subjektin e rivlerësimit.

<sup>21</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së, dërguar pranë Komisionit.

<sup>22</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së, dërguar në Komision.

## TË ARDHURAT

### 16. Të ardhurat nga shërbime konsulence me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. ose “\*\*\*\*” sh.p.k.

**16.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga shërbime konsulence të bashkëshortit nga shoqëria tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k./“\*\*\*\*” sh.p.k., Tiranë, për vitet 2005 – 2010. Shuma: 73,000 euro. Këto të ardhura janë deklaruar edhe në deklaratat periodike vjetore, por vlera në total ndryshon nga vlera e deklaruar në *Vetting* prej 73,000 euro.

**16.2** Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur deklaratën nr. \*\*\* prot., datë 7.1.2017, në të cilën shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. (ish “\*\*\*\*” sh.p.k.) deklaroi se z. M.M ka pasur marrëdhënie bashkëpunimi me këtë shoqëri, në bazë të së cilës ai i ka ofruar shoqërisë shërbime konsulence ligjore dhe i janë paguar tarifave përkatëse në bazë të shërbimit të ofruar sipas një tabele. Vlera totale e këtyre tarifave në tabelën bashkëngjitur vërtetimit arrin një vlerë totale prej 73,000 (nuk është përcaktuar njësia monetare e monedhës).

**16.3** Nga informacioni bankar nga Intesa Sanpaolo Bank rezulton se nga shoqëria “\*\*\*\*”/“\*\*\*\*” sh.p.k. kanë kaluar vlera parash në llogari të bashkëshortit të subjektit sipas tabelës së mëposhtme. Rezulton se vlerat e deklaruara nga vetë subjekti ndër vite nuk përkojnë me vlerat e vërtetuara nga transaksionet bankare. Gjithashtu, vlera totale e të ardhurave të deklaruara ndër vite nuk përkon me vlerën e deklaruar në deklaratën *Vetting*.

| Hyrjet me bankë | Deklarimi periodik |          |                                                                             |
|-----------------|--------------------|----------|-----------------------------------------------------------------------------|
|                 | Deklarimi          | Vlera    | Përshkrimi                                                                  |
| 6,000 €         | DPV 2005           | 10,000 € | *** sh.p.k.                                                                 |
| 24,000 €        | DPV 2006           | 24,000 € | *** sh.p.k.                                                                 |
| 22,000 €        | DPV 2007           | 27,000 € | *** sh.p.k. dhe shoqëria “****” s.r.l.                                      |
| 2,000 €         | DPV 2008           | -        | Nuk deklaroi të ardhura nga shoqëria “****” sh.p.k.                         |
| 12,000 €        | DPV 2009           | 12,000 € | Të ardhura të prapambetura nga shoqëria “****” sh.p.k. (ish “****” sh.p.k.) |
| 7,000 €         | DPV 2010           | 7,000 €  | Të ardhura të prapambetura nga shoqëria “****” sh.p.k.                      |

**16.4** Komisioni konstatoi se të ardhurat nga kjo shoqëri, sipas veprimeve bankare, nuk përkojnë me vlerat e deklaruara nga subjekti dhe bashkëshorti i saj në DPV-të përkatëse. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit dhe të provonte që për këto të ardhura të jenë paguar detyrimeve tatimore.

**16.5** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti deklaroi: “Për sa kërkohet sqarohet se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” janë i njëjti subjekt tregtar, me të cilin bashkëshorti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi (kontratë shërbimi) datë 15.8.2005. Referuar pikës 7 të marrëveshjes, shoqëria ka marrë përsipër të gjitha detyrimet financiare ndaj shtetit që rrjedhin nga kjo pagesë, që do të thotë pagimin e tatimit në burim, si i vetmi detyrim ligjor i aplikueshëm në këtë rast. Pas kërkesave tona drejtuar organeve kompetente, nuk na është vënë në dispozicion asnjë informacion në lidhje me përmbushjen apo jo të këtij detyrimi nga shoqëria në fjalë. Bashkëlidhur gjeni një kopje të marrëveshjes. Pagesat janë bërë të gjitha në rrugë bankare dhe vërtetohen plotësisht me dokumentacionin që kemi depozituar, vërtetim nga “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe statement bankare”.

**16.6** Rezultoi se me këtë shoqëri bashkëshorti i subjektit ka lidhur një marrëveshje të thjeshtë pa noter (datë 15.8.2005), e cila nuk provonte lidhjen e kësaj marrëveshjeje në periudhën përkatëse. Në dosjen e ILDKPKI-së nuk disponohet kjo marrëveshje, e cila është paraqitur nga subjekti vetëm në përgjigje të pyetësorit<sup>23</sup>.

**16.7** Në pikën 6 të marrëveshjes së datës 15.8.2005 theksohet se: “Shoqëria “\*\*\*\*” do të shpërblejë z. M.M për angazhimin e tij në favor të shoqërisë mbi bazën e kushteve të kësaj

<sup>23</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. \*\*\* të subjektit datë 7.2.2023.

*marrëveshjeje në një shumë prej jo më pak se 24,000 euro në vit. Shpërblimi vjetor do të përfshijë edhe shtesa rast pas rasti...”. Kjo pikë e marrëveshjes nuk përkon me deklaratimet e subjektit (në deklaratën Vetting dhe në DPV) lidhur me të ardhurat e përfituara ndër vite nga kjo shoqëri. Gjithashtu, në pikën 8 të marrëveshjes theksohet se: “Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 3-vjeçare nga data e nënshkrimit të saj”. Kjo pikë e marrëveshjes nuk përkon me deklaratimet e subjektit (në deklaratën Vetting dhe në DPV) lidhur me vitet që ka përfituar të ardhura nga kjo shoqëri.*

**16.8** Komisioni iu drejtua edhe organeve tatimore<sup>24</sup> lidhur me pagimin e tatimit në burim për të ardhurat e pretenduara nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

**16.9** Në përgjigjen e saj, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2023, DRT-ja Elbasan shprehet: *“Në lidhje me subjektin “\*\*\*\*” me NIPT \*\*\*, e regjistruar në organin tatimor në datën 17.5.2000, aktualisht i çregjistruar në datën 16.12.2010, nga verifikimi në sistemin tatimor C@TS, subjekti rezulton të jetë i regjistruar me përgjegjësi tatimore tatim mbi vlerën e shtuar dhe tatim mbi fitimin dhe ka deklaruar në DRT Elbasan deri në periudhën mars 2001 dhe mbas kësaj periudhe pranë DRT Elbasan nga ana e subjektit nuk ka deklarime dhe pagesa, si dhe konkretisht pagesa për tatimin e mbajtur në burim”.*

**16.10** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2023, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj shprehet: *“Në lidhje me tatimin e lindur për të ardhurat e shtetasit M.M me numër personal \*\*\*, nga marrëdhënia kontraktuale me subjektin në administrim të DTM, \*\*\* me NIPT \*\*\*, për periudhën së cilës i referoheni, përkatësisht vitet 2005 – 2010, detyrimi për përgjegjësinë tatimore “tatim në burim”, paguhej nëpërmjet urdhërpagesave nga jashtë sistemit tatimor, pasi kjo përgjegjësi nuk ishte e formalizuar nëpërmjet një deklarate tatimore. Pagesa nga ana e subjekteve kryhej në total për të gjitha detyrimet e lindura për një periudhë tatimore të caktuar në lidhje me Tatimin në Burim dhe si e tillë, detajimi i çdo pagese të kryer nga ana e subjektit mbetet përgjegjësi e tij.*

*Për sa më lart, në lidhje me kërkesën tuaj, na nevojitet detajim nga ana e subjektit deklarues të çdo pagese të kryer për secilën periudhe tatimore, të cilës i referoheni në shkresën tuaj, për të vijuar më pas në përputhjen e totalit të pagesave të kryer nga tatimpaguesi dhe regjistruar nga administrata tatimore”.*

**16.11** Komisioni iu drejtua përsëri Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.9.2023. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.9.2023, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan ka bërë me dije se: *“Në lidhje me subjektin \*\*\* me NIPT \*\*\*, i regjistruar në organin tatimor me datë 17.5.2000, aktualisht i çregjistruar në datën 16.12.2010 dhe nga verifikimi në sistemin tatimor C@TS subjekti nuk deklaruar apo paguar tatimin e mbajtur në burim për të ardhurat nga marrëdhëniet kontraktuale të shërbimit, ku duhet të theksojmë se sipas të dhënave në sistemin tatimor C@TS subjekti rezulton të jetë regjistruar vetëm për përgjegjësitë tatimore Tatim mbi Vlerën e Shtuar dhe tatim mbi fitimin dhe ka deklaruar në DRT Elbasan deri në periudhën mars 2001 dhe mbas kësaj periudhe pranë DRT Elbasan nga ana e subjektit nuk ka deklarime dhe pagesa, si dhe konkretisht pagesa për tatimin e mbajtur në burim”.*

**16.12** Komisioni iu drejtua shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 1.9.2023, lidhur me konfirmimin e marrëdhënies kontraktuale më bashkëshortin e subjektit dhe pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e pretenduara. Nuk është kthyer përgjigje nga kjo shoqëri.

**16.13** Në përfundim, të ardhurat e pretenduara nga subjekti për shërbime konsulence të bashkëshortit të saj me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k./“\*\*\*\*” sh.p.k. nuk janë përfshirë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare për shkak se nuk është provuar burimi i ligjshëm i tyre dhe pagimi i detyrimeve tatimore, si dhe mungesa e provueshmërisë së marrëveshjes.

<sup>24</sup> Shihni shkresën e Komisionit nr. \*\*\*, datë 6.6.2023.

**16.14** Për gjetjet e konstatuara sa më sipër lidhur me të ardhurat e pretenduara, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e saj për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**16.15** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar<sup>25</sup>: “Komisioni ka konstatuar diferencat në DPV dhe atë Vetting të deklarimit të këtyre të ardhurave. Nga analiza e dokumenteve rezultojnë se konstatimi është i drejtë dhe pasojë e gabimit të llogaritjes së pagesave përgjatë viteve kalendarike.

*Totali i pagesave sipas deklarimeve vjetore është 77,000 euro për gjithë periudhën 2005 – 2010. Diferenca në shumën 4,000 euro, me shumën reale të pagesave në bankë prej 73,000 euro, reflekton gabimin e bërë në deklarimet vjetore të viteve 2005 dhe 2006, sikurse është sqaruar më sipër. Sidoqoftë, në të gjitha rastet, diferencat e krijuara si rezultat i gabimeve, nuk ndikojnë aspak në rezultatin financiar të secilit vit dhe tabelën finale të llogaritjeve.*

*Marrëveshja e depozituar ka të gjitha ekstremitetet e nevojshme për një dokument shkresor me fuqi të plotë provuese. Në dijeni të trupës gjyquese, dua të saktësoj se ish-përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është shpallur i zhdukur dhe i vdekur, nëpërmjet procedurave gjyqësore, prej rreth 10 vitesh, çka do të thotë se replikimi i dokumentit do të ishte i pamundur. Gjithashtu, sa i takon vulës zyrtare të shoqërisë, me ndryshimin e emrit të saj që prej vitit 2008, ajo ka dalë jashtë përdorimit dhe gjithashtu nuk mund të replikohet. Sa i takon anës formale të veprimit juridik që përfaqëson marrëveshja në fjalë, referencë ligjore e saj janë përcaktimet e neneve 913 e vijues të Kodit Civil - kontrata e porosisë. Kjo kontratë nuk bën pjesë në veprimet juridike formale, të cilët kërkojnë detyrimisht formën noteriale për vlefshmërinë e tyre.*

*Lidhur me konstatimet sa i takon diferencës midis kohës së vlefshmërisë së kontratës (afatit të marrëveshjes) dhe kohës së kryerjes së pagesave, sqarohet se, afati i vlefshmërisë së marrëveshjes ka përfunduar në vitin 2008, sikurse është specifikuar nga palët. Pagesat që rezultojnë për vitet 2009 dhe 2010 janë rezultat i përmbushjes së detyrimit që rrjedh nga marrëveshja, por që nuk është paguar në kohën e duhur nga shoqëria.*

*Sikurse provohet me marrëveshjen për shlyerje detyrimesh në të holla, datë 14.5.2009, lidhur midis bashkëshortit dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., shoqëria njeh detyrimin e papaguar në vlerën prej 19,000 euro, detyrim i cili është shlyer i ndarë në dy pjesë: 12,000 euro në vitin 2009 dhe 7,000 euro në vitin 2010. Kopje të marrëveshjes së cituar më sipër, po e paraqes për konsiderim nga trupa gjyquese.*

*Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\* kam parashtruar situatën ligjore dhe praktike të pagesës së detyrimeve fiskale mbi shpërblimin prej 73,000 euro, përfutur nga bashkëshorti prej shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. “\*\*\*” sh.p.k., mbi bazën e marrëveshjes për ofrim konsulence juridike. Në përgjigje kam deklaruar: “Referuar pikës 7 të marrëveshjes, shoqëria ka marrë përsipër të gjitha detyrimet financiare ndaj shtetit që rrjedhin nga kjo pagesë, që do të thotë pagimin e tatimit në burim, si i vetmi detyrim ligjor i aplikueshëm në këtë rast. Pas kërkesave tona drejtuar organeve kompetente, nuk na është vënë në dispozicion asnjë informacion në lidhje me përmbushjen apo jo të këtij detyrimi nga shoqëria në fjalë”.*

*Me shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.9.2023, të cilën po e depozitoj për administrimin e trupës gjyquese, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve në DTM, në përgjigje të kërkesës sime datë 6.9.2023, për marrje informacioni lidhur me përmbushjen e detyrimeve nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. “\*\*\*” sh.p.k., bën me dije se: “Për periudhën të cilës i referoheni, përkatësisht viteve 2005 – 2010, detyrimi për përgjegjësinë tatimore tatim në burim paguhej nëpërmjet urdhërpaguesave nga jashtë sistemit tatimor pasi kjo përgjegjësi nuk ishte e formalizuar nëpërmjet një deklaratë tatimore. Pagesa nga ana e subjekteve kryhej në total për të gjitha*

<sup>25</sup> Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit lidhur me shpjegimet mbi të ardhurat e bashkëshortit.

detyrimet e lindura për një periudhë tatimore të caktuar në lidhje me tatimin në burim. Detajimi i çdo pagese të kryer nga ana e subjektit mbetet përgjegjësi e tij dhe, si e tillë, nuk administrohet nga ana jonë. Për sa më lart, në lidhje me kërkesën tuaj, subjekti i cili pretendohet që ka kryer pagesën e tatimit në burim, duhet të paraqesë detajim të çdo pagese të kryer për secilën periudhë tatimore të cilës i referoheni në shkresën tuaj, për të vijuar më pas me përputhjen e totalit të pagesave të kryera nga tatimpaguesi dhe regjistruar nga administrata tatimore. Ky informacion mund t'i ofrohet në vijim vetëm tatimpaguesit, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, që rregullojnë marrëdhëniet Administratë Tatimore tatimpagues, sipas ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Mbi bazën e kësaj shkrese, në datën 29.9.2023, i jam drejtuar shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k. "\*\*\*\*" sh.p.k. me një kërkesë, kopje të së cilës po e depozitoj përpara jush, për të informuar lidhur me pagesat. Nga ana e shoqërisë nuk është kthyer përgjigje.

Në mungesë të informacionit nga shoqëria dhe në kushtet e pamundësisë së DPT-së për të ofruar të dhëna mbi pagesën e detyrimit tatimor, në datën 6.10.2023, bashkëshorti ka depozituar në GJSHPJP Tiranë, kërkesë padinë me objekt: "Detyrimin e palës së paditur shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k., të paguajë tatimin mbi të ardhurat personale për periudhën 2005 – 2010", sikurse provohet me vërtetimin e datës 9.10.2023 të GJSHPJP Tiranë, Dhoma Civile.

Konkluzioni final i Komisionit se të ardhurat e krijuara nga kjo marrëveshje nuk konsiderohen me burim të ligjshëm dhe nuk përfshihen në analizën financiare, për arsye se jeni në pamundësi për të provuar pagesën e tatimit në burim, është jo në përputhje me standardin e aplikuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, i cili në vendimin nr. 35, datë 29.9.2022...".

## **Vlerësimi i Komisionit**

**16.16** Në përfundim, Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse lidhur me të ardhurat e pretenduara nga bashkëshorti dhe marrëveshjen e lidhur me shoqërinë "\*\*\*\*" sh.p.k. apo "\*\*\*\*".

**16.17** Subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k. apo "\*\*\*\*" dhe pagimin e detyrimeve tatimore nga bashkëshorti si person i lidhur, sipas kriterëve ligjore të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**16.18** Subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion provues lidhur me shërbimet dhe punët e kryera nga bashkëshorti për këtë shoqëri ndër vite.

**16.19** Të ardhurat nga shoqëria në fjalë, të cilat kanë kaluar nëpërmjet sistemit bankar nuk përkojnë me të ardhurat e deklaruara nga subjekti dhe bashkëshorti në deklaratat periodike vjetore të pasurisë të paraqitura pranë ILDKPKI-së. Në pikën 6 të marrëveshjes së datës 15.8.2005 theksohet se: "Shoqëria "\*\*\*\*" do të shpërblejë z. M.M për angazhimin e tij në favor të shoqërisë mbi bazën e kushteve të kësaj marrëveshjeje në një shumë prej jo më pak se 24,000 euro në vit. Shpërblimi vjetor do të përfshijë edhe shtesa rast pas rasti...". Kjo pikë e marrëveshjes nuk përkon me deklaratimet e subjektit (në deklaratën Vetting dhe në DPV) lidhur me të ardhurat e përfituara ndër vite nga kjo shoqëri.

**16.20** Subjekti pretendoi se marrëveshja me shoqërinë "\*\*\*\*" sh.p.k. apo "\*\*\*\*" është lidhur në bazë të nenit 913 e vijues të Kodit Civil - Kontrata e Porosisë. Komisioni nuk konstatoi se marrëveshja në fjalë dispononte shërbime që i përkasin një kontrate porosie, por rezultoi shërbime të mirëfillta juridike. Këtë fakt e pranoi edhe vetë subjekti, e cila në përgjigje të rezultateve të hetimit ka deklaruar: "... mbi shpërblimin prej 73,000 euro, përfituar nga bashkëshorti prej shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k. "\*\*\*\*" sh.p.k., mbi bazën e marrëveshjes për ofrim konsulence juridike". Bazuar në pikën 5 të kësaj marrëveshjeje përcakton se bashkëshorti i subjektit do të kryejë asistencë juridike dhe përfaqësim në gjykatë".

**16.21** Gjithashtu, marrëveshja për shlyerje detyrimesh në të holla datë 14.5.2009, me shoqërinë "\*\*\*\*" ish "\*\*\*\*" është lidhur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me cilësinë e avokatit.

Bazuar në ekstraktin e regjistrit tregtar rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit M.M me NIPT \*\*\* është regjistruar më 3.12.2009, si person fizik për ushtrimin e veprimtarisë si avokat.

**16.22** Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka lidhur marrëveshje me shoqërinë “\*\*\*\*” për ushtrim shërbimesh juridike dhe përfaqësim në Gjykatë pa u regjistruar si person fizik dhe pa pasur licencën përkatëse për ushtrim profesioni.

**16.23** Subjekti gjatë hetimit nuk e pretendoi asnjëherë mosdijeninë e pagesës së tatimit për të ardhurat. Bazuar në deklaratën nr. \*\*\* prot., datë 7.1.2017, në të cilën shoqëria “\*\*\*\* ” sh.p.k. (ish “\*\*\*\*” sh.p.k.) deklaroi se: “Z. M.M ka pasur marrëdhënie bashkëpunimi me këtë shoqëri në bazë të së cilës ai i ka ofruar shoqërisë shërbime konsulence ligjore dhe i janë paguar tarifatat përkatëse në bazë të shërbimit të ofruar sipas një table”, provohet se subjekti ka pasur komunikim me shoqërinë, pasi vetë ajo e ka dokumentuar dhe depozituar së bashku me deklaratën *Vetting*. Nga ana tjetër rezulton fakti se subjekti ka qenë në dijeni të paktën që në vitin 2017 lidhur me detyrimet e lindura nga marrëveshja me shoqërinë “\*\*\*\*” dhe nuk ka bërë asnjë përpjekje në kohë reale për të rregulluar këtë paligjshmëri të krijuar, kjo edhe në raport me standardet e ligjit nr. 84/2016. Pra, ka pasur dijeni dhe mundësi kohore e ligjore për të kryer përpjekjet e saj në funksion të qartësisë të kësaj situate dhe, për rrjedhojë, përmbushjen e detyrimeve ligjore për efekt të këtij procesi.

**16.24** Shpjegimi i bërë nga subjekti se shoqëria “\*\*\*\*” nuk kthen përgjigje nuk është bindës për Komisionin, pasi provohet se subjekti ka pasur komunikim me këtë shoqëri që në vitin 2017 dhe inicimi i procesit gjyqësor vlerësohet nga trupi gjykues si përpjekje e subjektit për shmangien e saj në përmbushje të detyrimeve ligjore. Ky fakt përforcohet edhe më shumë për faktin se inicimi i këtij procesi gjyqësor i bërë nga subjekti ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” nuk është ndjekur dhe për shoqëritë e tjera për të cilat ka pretenduar se nuk ka qenë në dijeni për pagimin e detyrimeve të tjera tatimore (shoqëritë “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*” etj). Kjo situatë merr peshë në raport me sjelljen e subjektit, ku në rrethana të pranuar për rastet e shoqërive “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*” edhe pse provohet që nuk janë paguar detyrimet tatimore për të gjithë shumën e kaluar me bankë (por janë paguar vetëm një pjesë e tyre) subjekti jo vetëm që kërkon t’i konsiderohen si të ardhura të ligjshme të gjitha vlerat totale, për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore, por nuk inicion procese gjyqësore ndaj tyre apo më tepër të paraqesë kallëzime të natyrës penale për kryerje të evazionit tatimor nga këto shoqëri, përfshirë edhe shoqërinë “\*\*\*\*”. Këto veprime apo mosveprime çmohen si sjellje jokorrekte të subjektit dhe jo në përputhjet me parimet e vlerat e një magjistrati, të cilat marrin peshë dhe do të vlerësohen së bashku me rrethanat dhe faktet tërësore të çështjeve nga ana e Komisionit.

**16.25** Parashikimi ligjor sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, evidenton faktin që ndonëse ka qenë i rregulluar në ligj detyrimi (përcaktuar këtu edhe mënyra edhe procedura e vjeljes së detyrimeve tatimore për shërbimin përkatës), bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka zgjedhur të mos t’i nënshtrohet këtij regjimi ligjor për realizimin e veprimtarisë së tij. Kjo në raport me detyrimet tatimore që ka pasur në formën e ushtrimit të profesionit si person fizik, sipas legjislacionit në fuqi, duke preferuar që shërbimin e avokatisë ta ushtrojë duke lidhur kontrata individuale me kërkues të këtij shërbimi. Në këtë këndvështrim, të ardhurat e përfituara nga ky shërbim kanë qenë subjekt i aplikimit të tatimit në burim mbi të ardhurat personale, për të cilat ligji i kohës ndër vite ka variuar në vlerat nga 10% deri në 15% të pagesës së përfituar. Kjo zgjedhje e personit të lidhur për raportin e tij me organet tatimore ka lënë minimalisht në neglizhencë permanente vëmendjen e tij ndaj pagimit të këtyre detyrimeve dhe me qëllim ka krijuar një situatë, e cila ka mundësuar përfitimin e shumave në vlera bruto, duke shmangur nëpërmjet një mekanizimi persistent të vepruari pagimin e detyrimeve tatimore.

**16.26** Lidhur me pretendimin e subjektit se detyrimin për pagimin e tatimit e ka pasur shoqëria “\*\*\*\*”, Komisioni konstaton se subjekti synon të ligjërohen në kuptim të ligjit të gjitha të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti prej këtij shërbimi (të ardhurat që duhej t’i

nënshtroreshin regjimit tatimor në fuqi), ndërsa ky fakt nuk provohet se ka ndodhur sepse bashkëshorti i subjektit ka zgjedhur vetë të mosregjistrohet në organet tatimore për të ushtruar aktivitetin si person fizik (avokat). Pra, mosregjistrimi si person fizik dhe shmangia e detyrimeve tatimore për këtë aktivitet duket se është bërë me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga marrëveshja me shoqërinë “\*\*\*\*”, e cila duket se i ka shërbyer të dyja palëve kontraktuale.

**16.27** Për sa më sipër, Komisioni përforcon bindjen se personi i lidhur ka pasur dijeni të plotë për mungesën e pagimit të detyrimit tatimor dhe është pajtuar me këtë situatë në një periudhë kohe të gjatë dhe të shpeshtë të ushtrimit të aktivitetit. Për shkak të kësaj qasjeje, që duket se ka lejuar personin e lidhur të subjektit të përfitojë shumën të patatuar, Komisioni çmon se ai e ka ditur dhe duhej të dinte se personi që kishte marrë përsipër këtë detyrim nuk e kishte paguar atë. Rezulton se personi i lidhur ka zgjedhur të regjistrohet dhe të veprojë si person fizik vetëm në muajin dhjetor 2009, duke anashkaluar të gjithë periudhën para kësaj kohe për shkak të vullnetit të tij dhe dakordësisë me palën që ka lidhur marrëveshje me qëllim favorizimin e tyre.

**16.28** Në çështjen objekt vlerësimi, Komisioni mban në konsideratë faktin se bashkëshorti i subjektit ishte subjekt deklarues, që prej vitit 2005, e si i tillë ai është sjellë të paktën me neglizhencë të pajustificuar drejt legjitimitetit të të ardhurave të tij, në kuptim të zbatimit të legjislacionit tatimor. Ai ka vijuar të ofrojë shërbime juridike dhe përfaqësimi, ndaj subjektit kërkues, pa u kujdesur dhe siguruar në asnjë rast, qoftë edhe për faktin nëse detyrimet tatimore për pagesat e përfituara prej tij janë kryer ose jo. Të gjitha shkaqet dhe rrethanat e trajtuara më sipër krijojnë bindjen e Komisionit se personi i lidhur ka pasur dijeni të plotë për mungesën e pagimit të detyrimit tatimor dhe është pajtuar me këtë situatë në një periudhë kohe të gjatë dhe të shpeshtë të ushtrimit të këtij aktiviteti. Ky konkluzion i Komisionit është rrjedhojë edhe llojit/detyrave të shërbimit që pretendohet se është kryer nga personi i lidhur i subjektit sikurse është parashikuar në marrëveshjen e vitit 2005 me këtë shoqëri në pikën 1 të saj ku citohet se: *“Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., për realizimin normal të aktivitetit të saj, në momente të caktuara. Ka nevojë për asistencë ligjore dhe kryerjen e veprimeve juridike, për llogari të shoqërisë, nga juristë të kualifikuar në trajtimin e çështjeve, që kanë të bëjnë kryesisht me: marrëdhëniet kontraktore të shoqërisë; zbatimin e legjislacionit të punës; detyrimet financiare ndaj të tretëve; çështjet gjyqësore në të cilat është palë shoqëria; marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe bankat, etj.”*

**16.29** Trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e deklaruara në deklaratën *Vetting* me burim marrëveshjen e bashkëpunimit me shoqërinë “\*\*\*\*” ose shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. (të deklaruara edhe në deklaratimet periodike vjetore), për të cilat subjekti nuk ka arritur të provojë pagimin e detyrimeve tatimore, nuk do të konsiderohen si të ardhura, të cilat plotësojnë kriteret e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk janë përfshirë në analizën financiare.

## **17. Të ardhura nga shërbime konsulence**

**17.1** Subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit si konsulent juridik në shoqërinë “\*\*\*\*” s.r.l., Itali, në vitet 2006 – 2007. Shuma: 5,970 euro.

**17.2** Me këtë shoqëri bashkëshorti i subjektit ka paraqitur një marrëveshje të thjeshtë pa noter (në gjuhën italiane, në datën 3.1.2007). Për Komisionin mbetet e paprovuar lidhja e kësaj marrëveshjeje në periudhën përkatëse.

**17.3** Në pikën 6 të marrëveshjes së datës 3.1.2005 theksohet se *për shkak të angazhimit, z. M.M do të paguhet në shumën jo më pak se 3,000 euro në vit*. Kjo pikë e marrëveshjes nuk përkon me deklaratimet e subjektit (në deklaratën *Vetting* dhe në DPV) lidhur me të ardhurat e përfituara ndër vite nga kjo shoqëri.

**17.4** Gjithashtu, në pikën 9 të marrëveshjes theksohet se: *“Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 1-vjeçare nga data e nënshkrimit të saj”*. Kjo pikë e marrëveshjes nuk përkon



me deklaratimet e subjektit (në deklaratën *Vetting* dhe në DPV) lidhur me vitet që ka përfiturar të ardhura nga kjo shoqëri.

**17.5** Nga informacioni bankar mbërritur nga Intesa Sanpaolo Bank rezulton se nga shoqëria “\*\*\*\*” s.r.l. kanë kaluar vlera parash në llogari të bashkëshortit të subjektit në shumat 2,980 euro në vitin 2006 dhe 2,990 euro në vitin 2007. Në total në bankë bashkëshortit të subjektit i ka kaluar shuma 5,970 euro.

**17.6** Komisioni iu drejtua edhe organeve tatimore<sup>26</sup> lidhur me pagimin e tatimit në burim për të ardhurat e pretenduar nga shoqëria “\*\*\*\*” s.r.l., Itali. Drejtoria e Tatimeve<sup>27</sup> nuk paraqiti informacionin e kërkuar nga Komisioni. Nga një kërkim në regjistrin elektronik tregtar të QKB-së <https://qkb.gov.al> nuk rezultoi ndonjë subjekt tregtar me këtë emër të regjistruar. Këto të ardhura të pretenduara nuk janë përfshirë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare, për shkak se nuk është provuar burimi i ligjshëm i tyre dhe pagimi i detyrimeve tatimore, si dhe mungesa e provueshmërisë së marrëveshjes.

**17.7** Për gjetjen e konstatuar sa më sipër lidhur me të ardhurat e pretenduara, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat e saj për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**17.8** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se: *“Sa i takon të ardhurave të bashkëshortit nga shoqëria “\*\*\*\*” s.r.l. Itali, si konsulent juridik, për periudhën 2006 – 2007, në shumën 5,970 euro, pagesat e kryera janë rezultat i marrëveshjes së lidhur mes palëve, kopje të së cilës e kam depozituar dhe janë kryer tërësisht në rrugë bankare. Lidhur me shlyerjen e detyrimit për pagimin e tatimit në burim, nuk kam informacion dhe nuk mund të provoj këtë pagesë, për të njëjtat arsye që parashtrova për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. Në kohën e nënshkrimit të marrëveshjes, nga pala italiane është marrë angazhimi për hapjen e selisë në Shqipëri, gjë e cila nuk u realizua, duke bërë të pamundur evidentimin e këtij subjekti në vitin 2023 dhe ndjekjen e të njëjtit proces sikurse për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. Gjithsesi, në vlerësimin tim, të ardhurat e siguruara prej këtij subjekti duhet të njihen pasi pagesat janë kryer në rrugë bankare”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**17.9** Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ka arritur të përmbysë barrën e provës për të vërtetuar që janë paguar detyrimet tatimore lidhur me të ardhurat e përfituara nga marrëveshja e personit të lidhur me këtë shoqëri.

**17.10** Qëndrimi i Komisionit lidhur me këto të ardhura janë të njëjta me qëndrimin e mbajtur për të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit me shoqërinë “\*\*\*\*” ose “\*\*\*\*”, më parë në këtë vendim.

**17.11** Por në këtë rast, Komisioni thekson edhe faktin se bazuar në përgjigjen e subjektit mbi rezultatet e hetimit: *“Në kohën e nënshkrimit të marrëveshjes, nga pala italiane është marrë angazhimi për hapjen e selisë në Shqipëri, gjë e cila nuk u realizua, duke bërë të pamundur evidentimin e këtij subjekti në vitin 2023 dhe ndjekjen e të njëjtit proces sikurse për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.”*, që subjekti ka qenë në dijeni për mosregjistrimin e kësaj shoqërie në Republikën e Shqipërisë si shoqëri tregtare, gjë që do të sillte detyrimisht mosveprime të saj për pagim detyrimesh tatimore në buxhetin e shtetit.

**17.12** Trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e deklaruara në deklaratën *Vetting* me burim marrëveshjen e bashkëpunimit me shoqërinë “\*\*\*\*” s.r.l., Itali (të deklaruara edhe në deklaratimet

<sup>26</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2023, të Komisionit.

<sup>27</sup> Shihni përgjigjet e drejtorive të tatimeve në dosjen e Komisionit shkresat: nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2023; nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2023; nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2023; nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2023.

periodike vjetore, për të cilat subjekti nuk ka arritur të provojë pagimin e detyrimeve tatimore), nuk do të konsiderohen si të ardhura, që plotësojnë kriteret e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk janë përfshirë në analizën financiare.

## **18. Të ardhura nga aktiviteti privat si person fizik**

**18.1** Subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit si person fizik në vitet 2010 – 2011 në vlerën e përfiturar 7,700 euro.

**18.2** Këto të ardhura, sipas subjektit, nuk reflektohen në vërtetimin e Zyrës Rajonale Tatimore Tiranë për shkak se në bazë të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar neni 12, pika 6, deklarimi i xhiros vjetore bëhej vetëm nëse kjo xhiro për vitin ushtrimor kalonte vlerën 2 milionë lekë.

**18.3** Komisioni konstatoi se këto të ardhura janë përfiturar me anë të transfertave bankare dhe janë paguar detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit, e konfirmuar kjo nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tatimeve Vendore të Bashkisë Tiranë.

**18.4** Sipas organeve tatimore, personi fizik “M.M” me NIPT \*\*\*, ka shlyer detyrimet vendore deri në datën 11.2.2011 të kalimit me status “Aplikim për çregjistrim”.

**18.5** Vlerat e përfituara në rrugë bankare janë më të vogla se xhiroja 2,000,000 lekë, prandaj vlera totale e tyre është konsideruar si e ardhur e ligjshme për bashkëshortin e subjektit në vitet 2010 – 2011.

**18.6** Komisioni i ka pasqyruar këto të ardhura në analizën financiare sipas viteve dhe shumave të deklaruara nga subjekti dhe të vërtetuara nga *statement*-i bankar i llogarisë së bashkëshortit të saj si person fizik pranë BKT-së.

## **19. Të ardhura nga paga**

**19.1** Subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., \*\*\*, Berat, për periudhën 1.4.2011 – 31.1.2013. Shuma: 2,100,000 lekë.

**19.2** Komisioni iu drejtua ISSH-së për të marrë të dhëna dhe administroi shkresën kthim përgjigjeje të këtij institucioni për të vërtetuar deklaratimet e subjektit mbi të ardhurat e pretenduara.

**19.3** Bazuar në të dhënat e dërguara nga ISSH-ja, Komisioni përfshiu në analizë financiare shumat e konfirmuara nga ky institucion sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2022. Sipas ISSH-së, të ardhurat për vitet 2012 – 2013 rezultuan në vlerën 768,006 lekë, ndërsa për vitin 2011 u morën shumat e konfirmuara nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.7.2017, në shumën 545,039 lekë. Në total, sipas llogaritjes rezultuan të ardhura neto në shumën 1,313,045 lekë.

## **20. Të ardhura nga paga**

**20.1** Subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit si jurist pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., Tiranë, në periudhën shkurt – maj 2013. Shuma: 165,796 lekë.

**20.2** Komisioni iu drejtua ISSH-së për të marrë të dhëna dhe administroi shkresën kthim-përgjigjeje të këtij institucioni për të vërtetuar deklaratimet e subjektit mbi të ardhurat e pretenduara.

**20.3** Bazuar në të dhënat e dërguara nga ISSH-ja, Komisioni përfshiu në analizë financiare shumat e konfirmuara nga ky institucion sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2022. Sipas ISSH-së, të ardhurat për këtë periudhë rezultuan në vlerën 154,196 lekë.

## 21. Të ardhura nga paga

**21.1** Subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit nga universiteti jopublik “L”, Tiranë, administrator, për periudhën maj 2013 – 31.12.2016. Shuma: 77,100 euro.

**21.2** Komisioni iu drejtua ISSH-së për të marrë të dhëna dhe administroi shkresën kthim përgjigjeje të këtij institucioni për të vërtetuar deklaratimet e subjektit mbi të ardhurat e pretenduara.

**21.3** Bazuar në të dhënat e dërguara nga ISSH-ja, Komisioni përfshiu në analizë financiare shumat e konfirmuara nga ky institucion sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2022. Sipas ISSH-së, të ardhurat për këtë periudhë rezultuan në vlerën 10,770,932 lekë (afërsisht 77,000 euro).

## 22. Të ardhura nga shërbime konsulence

**22.1** Subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit si konsulent juridik në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., Tiranë, për periudhën 5.1.2015 – 12.10.2016. Shuma: 14,656 euro.

**22.2** Me këtë shoqëri bashkëshorti i subjektit ka lidhur një kontratë shërbimi të thjeshtë pa noter (datë 5.1.2015). Mbetet e paprovuar lidhja e kësaj marrëveshjeje në periudhën përkatëse. Kjo marrëveshje është paraqitur nga subjekti vetëm në përgjigje të pyetësorit<sup>27</sup>.

**22.3** Nga informacioni bankar nga Intesa Sanpaolo Bank rezulton se nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. kanë kaluar vlera parash në llogari të bashkëshortit të subjektit në shumat 11,178 euro në vitin 2015 dhe 3,478 euro në vitin 2016. Në total, në bankë, bashkëshortit të subjektit i ka kaluar shuma 14,656 euro për këto dy vite.

**22.4** Komisioni iu drejtua edhe organeve tatimore<sup>28</sup> lidhur me pagimin e tatimit në burim për të ardhurat e pretenduara nga kjo shoqëri. Drejtoria e Tatimeve konfirmoi se kjo shoqëri ka paguar tatimin në burim për vitet 2015 – 2017, si pagesë për shërbimet teknike, menaxhimit financiar dhe të sigurimit (formulari i deklaratimit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim). Bashkëlidhur vërtetimit janë kopjet e formularëve të deklaratimit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat për periudhën 2015 – 2017. Pagesat e tatimit në burim të kryera nga shoqëria “\*\*\*\*” në vitet 2015 – 2016, janë si më poshtë:

| Deklarata tatimore | Principali | Tatimi në burim | Vlera neto lekë | Vlera neto euro (kursi/muaji i pagesës) | Paguar tatimi |
|--------------------|------------|-----------------|-----------------|-----------------------------------------|---------------|
| Shkurt 2015        | 294,118    | 44,118          | 250,000         | 1,781 €                                 | Mars 2015     |
| Maj 2015           | 252,118    | 37,818          | 214,300         | 1,522 €                                 | Qershor 2015  |
| Qershor 2015       | 714,118    | 107,118         | 607,000         | 4,553 €                                 | Korrik 2015   |
| Nëntor 2015        | 586,818    | 88,023          | 498,795         | 3,624 €                                 | Dhjetor 2015  |
| Prill 2016         | 566,118    | 84,918          | 481,200         | 3,479 €                                 | Maj 2016      |

**22.5** Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, shoqëria “Zyra e Përmbartimit privat \*\*\*\*” me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.8.2023, ka dërguar ndër të tjera edhe urdhërpagesat e tatimit të mbartur në burim për muajt shkurt, maj, qershor, nëntor 2015 dhe prill 2016.

**22.6** Vlerat e kaluara me transaksione bankare nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në llogari të bashkëshortit të subjektit janë paraqitur më poshtë:

<sup>28</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2023, të Komisionit.

| Muaji        | Vlera e muajit  | Vlera sipas datës | Data e pagesës | Përshkrimi i transaksionit                                                  |
|--------------|-----------------|-------------------|----------------|-----------------------------------------------------------------------------|
| Mars 2015    | 1,700 €         | 1,700 €           | 3.3.2015       | Likuidim shërbime konsulence                                                |
| Maj 2015     | 1,700 €         | 1,700 €           | 6.5.2015       | Pagim shërbime konsulence sipas kontratës                                   |
| Qershor 2015 | 4,250 €         | 1,700 €           | 19.6.2015      | Likuidim shërbim konsulence sipas kontratës muaji maj –qershor 2015         |
|              |                 | 2,550 €           | 24.6.2015      | Shërbim konsulence shtesë sipas kontratës për shpërblim                     |
| Dhjetor 2015 | 3,528 €         | 3,528 €           | 7.12.2015      | Likuidim konsulence ligjore sipas kontratës për muajin korrik dhe shpërblim |
| Prill 2016   | 3,478 €         | 3,478 €           | 14.4.2016      | Pagesë për konsulencë juridike gusht, shtator, tetor, nëntor 2015           |
| <b>TOTAL</b> | <b>14,656 €</b> | <b>14,656 €</b>   |                |                                                                             |

**22.7** Nga krahasimi i informacionit bankar me atë tatimor rezulton se vlerat neto të përfituara sipas pagesës së tatimit janë pothuajse njësoj me ato të përfituara nga bashkëshorti i subjektit përmes bankës.

**22.8** Nisur nga faktet se: subjekti i ka deklaruar në DPV-të përkatëse dhe në deklaratën *Vetting* të ardhurat nga kjo marrëdhënie shërbimi; të ardhurat e pretenduara nga subjekti janë përfituar përmes bankës; janë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat nga shërbimi të bashkëshortit të subjektit nga shoqëria përfituese e shërbimit – Komisioni i mori në konsideratë të ardhurat e pretenduara nga kjo shoqëri dhe i përfshiu ato në analizën financiare, për faktin se vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit.

### **23. Të ardhura nga paga**

**23.1** Subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit si administrator në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., Tiranë, për periudhën korrik 2016 – janar 2017. Shuma: 2,200,000 lekë.

**23.2** Komisioni iu drejtua ISSH-së për të marrë të dhëna dhe administroi shkresën kthim përgjigje të këtij institucioni për të vërtetuar deklaratimet e subjektit mbi të ardhurat e pretenduara.

**23.3** Bazuar në të dhënat e dërguara nga ISSH-ja, Komisioni përfshiu në analizë financiare shumat e konfirmuara nga ky institucion sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2022. Sipas ISSH-së, të ardhurat për vitin 2016 rezultuan në vlerën 1,286,493 lekë.

### **24. Të ardhura nga paga**

**24.1** Subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit si administrator në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., Tiranë, për periudhën korrik 2016 – janar 2017. Shuma: 450,000 lekë.

**24.2** Komisioni iu drejtua ISSH-së për të marrë të dhëna dhe administroi shkresën kthim përgjigje të këtij institucioni për të vërtetuar deklaratimet e subjektit mbi të ardhurat e pretenduara.

**24.3** Bazuar në të dhënat e dërguara nga ISSH-ja, Komisioni përfshiu në analizë financiare shumat e konfirmuara nga ky institucion sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2022. Sipas ISSH-së, të ardhurat për vitin 2016 rezultuan në vlerën 419,835 lekë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat**

**24.4** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar: *“Lidhur me të ardhurat nga paga, nga arsyetimi i Komisionit rezulton se për çdo pagesë nga punësimi përfshihen në analizën financiare vetëm të dhënat e dërguara nga ISSH-ja. I njëjti standard është aplikuar lidhur me të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti për periudhën 1.4.2011 – shkurt 2013, si i punësuar me kohë të plotë pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Vlerësimi i Komisionit kryhet mbi bazën e këtij standardi, por do t’i lutesha trupës gjyquese të konsiderojë faktin se në këtë rast pagesat janë bërë tërësisht nëpërmjet Raiffeisen Bank, me përshkrimin “Pagim page”, gjë e cila verifikohet lehtësisht në statement-et përkatëse – për shifrën totale prej 2,100,000 lekësh.*

*Bashkëshorti ka qenë në padijeni të plotë të faktit se pagesa e detyrimeve nga punëdhënësi është bërë mbi një pagë tavan taksimi, duke lënë jashtë një pjesë të pagës. Në këto kushte do të kërkoja të rivlerësohet qëndrimi lidhur mbi këto të ardhura dhe të përfshihen të plota në analizën financiare, si të ardhura të ligjshme të përfituara nga një marrëdhënie punësimi.*

*Sikurse edhe më sipër, nga arsyetimi i Komisionit rezulton se përfshihen në analizën financiare vetëm të dhënat e dërguara nga ISSH-ja lidhur me të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti për periudhën korrik 2016 – janar 2017, si i punësuar me kohë të plotë pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.*

*Nga analiza e të ardhurave nga marrëdhënia e punës me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas ISSH-së rezulton se ka gabime në përllogaritje, të cilat konfirmohen me të dhënat e gjeneruara nga sistemi e-albania, që po i depozitohet për vlerësimin tuaj. Duke konsideruar këto pasaktësi, është bërë një përllogaritje e re e këtyre të ardhurave sipas tabelës me shpjegime. Sikurse vihet re nga përllogaritja, ka një diferencë në shumën 142,508 lekë me tabelën e ISSH-së në raport. Shuma 142,508 lekë është e ardhur me burim të ligjshëm dhe duhet t’i shtohet shumës së të ardhurave të njohura në raport prej 1,286,493 lekësh, duke u përfshirë në llogaritjet e analizës financiare totali prej 1,429,000 lekësh”.*

*Ndërkohë, për pjesën tjetër të të ardhurave në shumën 771,000 lekë, të cilat nuk rezultojnë në tabelën e ISSH-së, kërkoj nga trupa gjyquese të rivlerësojë burimin e tyre dhe t’i bëjë pjesë të analizës financiare, sepse në fakt janë pagesa të cilat janë bërë në rrugë bankare dhe të vlerësuara si dieta, për angazhime brenda qytetit të Tiranës. Me to nuk janë mbuluar shpenzime udhëtimit, qëndrimi, ushqim jashtë vendit të banimit. Në një vlerësim të tillë, totali i përfutur është i njëjtë me të deklaruarin në shumën 2,200,000 lekë”.*

## **Vlerësimi i Komisionit**

**24.5** Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga bashkëshorti i subjektit tek shoqëria “\*\*\*\*” në korrik të vitit 2016, sipas verifikimit të dokumentacionit nga ISSH-ja, Komisioni shtoi në analizën financiare të ardhurat neto të këtij muaji si të ardhura të ligjshme.

**24.6** Lidhur me kërkesën e subjektit për të përfshirë në analizën financiare si të ardhura të ligjshme edhe diferencën e kaluar me bankë në krahasim me vlerat e vërtetuara nga ISSH-ja, Komisioni vlerëson se këto të ardhura nuk janë të ardhura të deklaruara pranë organeve tatimore dhe për to nuk janë paguar detyrimet tatimore dhe kontributet përkatëse. Si të tilla, nuk mund të përfshihen si të ardhura të ligjshme në analizën financiare.

**24.7** Gjithashtu, fakti që subjekti i konsideron si vlera monetare të përfituara nga bashkëshorti me bankë, të vlerësuara si dieta për angazhime brenda Tiranës, Komisioni vlerëson se në analizën financiare përfshirja e këtyre të ardhura nuk do kishte ndikim, sepse ato do të duhej të përfshiheshin edhe si shpenzim, meqenëse dietat jepen për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara.

**24.8** Komisioni në këtë vlerësim mban në konsideratë edhe faktin se subjekti nuk duket se ka ndërmarrë veprime kundër këtyre punëdhënësve, në rrethanat e pranuar për rastet e shoqërive “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*”, edhe pse provohet që nuk janë paguar detyrimet tatimore për të gjithë shumën e kaluar me bankë (por janë paguar vetëm një pjesë e tyre).

## **25. Shpenzimet e djalit të subjekti të rivlerësimit në Kanada**

**25.1** Në deklaratën *Vetting*, djali i subjektit ka deklaruar shpenzime si bashkëqiramarrës në një banesë të ndodhur në adresën: \*\*\* West 27-th A , V B.C.V5Y \*\*\*, Canada, me vlerë mujore të përgjithshme qiraje 1,800 CAD, me pjesë takuese 600 CAD. Pagesa është deklaruar se paguhet nga prindërit.

**25.2** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se djali L.M është larguar nga banesa familjare në gusht të vitit 2010, për të ndjekur studimet në V, Kanada. Gjatë kohës së qëndrimit në këtë qytet, ai ka banuar në disa ambiente të ndryshme, të paraqitura

kronologjikisht si në vijim: “Për periudhën gusht 2010 – qershor 2013, djali ka banuar së bashku me familjen e motrës së bashkëshortit në një apartament të ndodhur në adresën \*\*\*-\*\*\* W.P.S, V, BC, V6E \*\*\*, Canada. Ky apartament është poseduar nga motra e bashkëshortit dhe familja e saj mbi bazën e një kontrate qiraje, të lidhur në datën 5.7.2010.

Për gjithë periudhën e qëndrimit të djalit në këtë banesë, nga ana jonë nuk është paguar qira. Pagesa e qirasë së objektit është realizuar prej qiramarrësve nga të ardhurat e tyre, sikurse vërtetohet me deklaratën noteriale të datës 5.9.2020, lëshuar nga motra e bashkëshortit, znj. B.M, si dhe nga dokumentacioni zyrtar mbi të ardhurat e familjes së saj për vitet 2010 – 2013.

Për periudhën shtator 2013 – qershor 2014, djali ka banuar në rezidencë universitare pranë universitetit “\*\*\*”, V, Kanada, ku ka ndjekur studimet. Për këtë periudhë është paguar tarifa vjetore për strehim dhe ushqim, gjë e cila provohet me dokumentacionin e nxjerrë nga llogaria personale e studentit pranë universitetit.

Për periudhën korrik 2014 – nëntor 2014, djali është rikthyer për banim të përkohshëm, deri në zgjidhjen definitive të strehimit pas largimit nga rezidenca studentore, në apartamentin e poseduar nga motra e bashkëshortit, në adresën \*\*\* – \*\*\* W.P.S, V, BC, V6E \*\*\*, Canada.

Nga muaji nëntor 2014 deri në 1 shtator 2016, djali është strehuar në një dhomë pranë \*\*\* B.H (strukturë akomoduese me dy yje), e ndodhur në adresën \*\*\* E H St, B, BC V5C \*\*\*. Për gjithë kohën e qëndrimit të tij në këtë ambient është dakordësuar një tarifë e pandryshuar, e cila i është paguar hotelit për çdo muaj, nëpërmjet transfertave bankare.

Nga 1 muaji shtator 2016 deri në 1 shtator 2018, djali ka banuar si bashkëqiramarrës me dy studentë të tjerë në një banesë të ndodhur në: \*\*\* West 27th A, V B.C., V5Y \*\*\*, Canada, sikurse provohet nga kopja e kontratës së qirasë datë 6.8.2016, që do të gjeni bashkëlidhur. Vlera përkuese e qirasë së djalit, në shumën 600 \$CAD në muaj, gjatë gjithë periudhës i është paguar në cash qiramarrësve të tjerë, të cilët kryenin pagesat kundrejt qiradhënësit”.

**25.3** Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar edhe lidhur me shpenzimet e shkollimit të djalit në Shqipëri, të cilat janë përfshirë në analizën financiare sipas viteve respektive.

**25.4** Kurse lidhur me shkollimin jashtë vendit, subjekti ka deklaruar: “Nga viti 2010 deri në vitin 2013, djali ka studiuar në shkollën R.S.S, Canada. Për këtë periudhë shkollimi është paguar vetëm tarifa e studimit, pasi shpenzimet e jetesës – akomodimi dhe ushqimi i tij janë mbuluar nga motra e bashkëshortit dhe familja e saj. Tarifa e studimit ka qenë 15,000 \$CAD për vit shkollor. Këto pagesa janë kryer nëpërmjet transfertës bankare. Burimi i financimit i të gjitha shpenzimeve të shkollimit për këtë periudhë kanë qenë të ardhurat familjare nga puna në vite. Përgjatë viteve 2013 – 2017, djali ka kryer studimet universitare në universitetin “B.K – UBC”, Canada. Për vitin kalendarik 2013 është paguar në total shuma 16,659 \$CAD. Për vitin kalendarik 2014 është paguar në total shuma 24,358 \$CAD. Në këtë vit kalendarik, një shumë prej 3,000 \$CAD, pjesë e tarifës për akomodim dhe ushqim, është financuar nga motra e bashkëshortit. Për vitin kalendarik 2015 është paguar në total shuma 30,005 \$CAD. Për vitin kalendarik 2016 është paguar në total shuma 30,633 \$CAD”.

**25.5** Lidhur me shpenzimet e jetesës së arsimimit të djalit në Kanada, si dhe për mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur (B.M), është ripyetur subjekti, e cila ka kthyer përgjigje me anë të pyetësorit nr. \*\*\*<sup>29</sup>. Përgjigjet e pyetësorit nr. \*\*\* të subjektit, lidhur me shpenzimet e jetesës për disa nga vitet e studimit, nuk përputhen plotësisht me deklaratimet e bëra nga subjekti në pyetësorin standard.

**25.6** Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit<sup>30</sup> të vinte në dispozicion *statement*-in bankar lidhur me llogarinë bankare të djalit L. M pranë R.B.C, e cila, në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*,

<sup>29</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit dërguar nga subjekti më 7.2.2023.

<sup>30</sup> Shihni pyetësorin nr. \*\*\*, dërguar subjektit të rivlerësimit.

paraqiti kopje të *statement*-it bankar për periudhën 2016 – 2023, plotësuar me dokumentacionin e paraqitur në përgjigje të pyetësorit të datës 29.6.2023. Por, pavarësisht këtyre komunikimeve, përsëri mungonte informacioni i plotë i këtyre llogarive. Dhe, për këtë arsye, subjektit iu kërkua të paraqiste dokumentacion të plotë të llogarive bankare të djalit L.M në Kanada, që nga momenti i krijimit të tyre e në vazhdim.

**25.7** Komisioni administroi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve, si dhe *statement*-in bankar lidhur me shumën e kaluar në llogarinë bankare të djalit të subjektit dhe veprimet e kryera lidhur me tarifat zyrtare. Gjithashtu u mbledhën të dhëna lidhur edhe me të ardhurat e motrës së bashkëshortit të subjektit si person tjetër i lidhur, në raport me kontributin e saj për dhurim të shumës 3,000 CAD dhe shpenzimet e kryera për akomodimin e djalit të subjektit.

**25.8** Është analizuar mundësia e motrës së bashkëshortit të subjektit znj. B.M, për përballimin e shpenzimeve të jetesës për vete, bashkëshortin e saj dhe djalit të subjektit, për periudhën e deklaruar, si dhe për pagesën e një pjese të shpenzimeve të studimit në vlerën 3,000 CAD në vitin 2014 nga ajo vetë në deklaratën noteriale të sipërpërmendur. Për të bërë këtë llogaritje janë marrë parasysh:

- deklarata noteriale datë 5.9.2020, e znj. B.M;
- kopje të *Residential Tenancy Agreement*, e datave 25.8.2008 dhe 5.7.2010, të cilat vërtetojnë marrëdhëniet e qirasë që motra e bashkëshortit të subjektit dhe bashkëshorti i saj, z. Sh. K, kishin për vitet përkatëse në Kanada;
- kopje të *Canadian Tax Returns* për shtetasit B.M dhe Sh.K, për vitet 2009 – 2015, të cilat vërtetojnë të ardhurat neto të tyre në shtetin e Kanadasë në këto vite;
- kopje të *Goods and Services Tax (GST) reit/BC Low Income Climate Action Tax Credit and BC HST Credit Notice për Sh. K* për vitet 2009 – 2012, të cilat vërtetojnë të ardhura shtesë të përfituara nga shteti i Kanadasë në këto vite;
- *Payment Details nga The University of B.C*, me anë të të cilave vërtetohet pagesa e shumave 2,928.95 CAD dhe 100 CAD nga znj. B.M në qershor të vitit 2014;
- të dhëna statistikore nga faqet zyrtare të statistikave të Kanadasë për përcaktimin e shpenzimeve të jetesës në V, B.C<sup>31</sup>.

**25.9** Bazuar në të gjithë informacionin e dokumentuar është bërë llogaritja e mundësive financiare të kumatës së subjektit dhe bashkëshortit të saj, si më poshtë:

#### **Analiza e mundësisë financiare të kumatës së subjektit, znj. B. M**

| <b>Përshkrimi</b>                                   | <b>Vlera</b>       |
|-----------------------------------------------------|--------------------|
| Të ardhura B. M dhe Sh. K 2010 – 2014               | 347,785 CAD        |
| Shpenzime jetese 3 persona (pa strehim) 2010 – 2014 | 113,803 CAD        |
| Shpenzime qiraje                                    | 95,815 CAD         |
| Dhurim për shkollim djalit të subjektit 2014        | 3,000 CAD          |
| <b>Mundësia financiare</b>                          | <b>135,167 CAD</b> |

**25.10** Nga analiza financiare rezultoi se kunata e subjektit, znj. B.M, dhe bashkëshorti i saj kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për mbulimin shpenzimeve të tyre të jetesës dhe djalit të subjektit në periudhat gusht 2010 – qershor 2013 dhe korrik – nëntor 2014<sup>32</sup>, si dhe për dhurimin e bërë prej tyre në vitin 2014.

**25.11** Në përfundim, u hartua analiza financiare lidhur me shpenzimet e shkollimit, strehimit dhe jetesës së djalit të subjektit në Kanada, për llogaritjen e të cilave janë marrë parasysh:

<sup>31</sup><https://www150.statcan.gc.ca/t1/tbl1/en/cv.action?pid=1110023001;https://www150.statcan.gc.ca/n1/pub/75f0002m/201102/tbl/tbl04-eng.htm>

<sup>32</sup> Shpenzimet e jetesës së djalit të subjektit janë llogaritur vetëm për periudhat e deklaruar të bashkëjetesës me hallën e tij.

- vërtetimet e sjella nga *The U.B.C (Student Service Centre)* në Kanada, të cilat vërtetojnë kostot (*tuition history*) e studimeve të djalit për vitet 2013 – 2016 tek ky universitet;
- transaksionet bankare të transfertave të bëra nga bashkëshorti i subjektit për pagesën e studimeve në Kanada nga llogaritë e tij tek Raiffeisen Bank, Credins Bank dhe Intesa Sanpaolo Bank në vitet 2009 – 2016;
- *UBC Student Housing and Community Services (Online Service Centre)*, që vërtetojnë pagesat për strehim dhe ushqim për periudhën qershor 2013 – maj 2014;
- *statement* pjesore të L.M tek *R.B.C*, ku evidentohet pagesë mujore 700 CAD për qira tek *I.H.*, për periudhën 31.10.2014 – 1.8.2016;
- deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore;
- deklarin e bërë nga motra e bashkëshortit B.m në deklaratën noteriale të datës 5.9.2020, ku ajo deklaroi jetesën e nipit të saj L.M në banesën ku ajo jetonte bashkë me bashkëshortin e saj. Sipas kësaj deklarate, L.M ka banuar në banesën e hallës së tij për periudhën gusht 2010 – qershor 2013, duke përjashtuar pushimet shkollore kur ai është kthyer në Shqipëri. Gjithashtu, sipas kësaj deklarate, ai ka banuar në banesë me hallën e tij edhe për periudhën korrik 2014 – nëntor 2014. Gjatë kësaj periudhe, sipas deklaratës, motra e bashkëshortit të subjektit ka mbuluar shpenzimet e jetesës së nipit të saj dhe në vitin 2014 ka paguar 3,000 CAD për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të studimit të tij pranë *U.B.C, BC, Canada*;
- *Payment Details nga The U.B.C*, me anë të të cilave vërtetohet pagesa e shumave 2,928.95 CAD dhe 100 CAD nga znj. B.M në qershor të vitit 2014;
- të dhëna statistikore nga faqet zyrtare të statistikave të Kanadasë për përcaktimin e shpenzimeve të jetesës në *V, B.C*<sup>33</sup>.

**25.12** Bazuar në të gjithë informacionin e dokumentuar, është bërë llogaritja e shpenzimeve të studimit, strehimit dhe jetesës së djalit të subjektit L.M , si më poshtë:

#### **Shpenzime shkollimi dhe jetese L.M , në Kanada**

| Viti/përshkrimi | Total (CAD) | Total (lekë) |
|-----------------|-------------|--------------|
| 2009            | 15 088      | 1 344 376    |
| 2010            | 0           | 0            |
| 2011            | 15 080      | 1 548 925    |
| 2012            | 15 079      | 1 623 653    |
| 2013            | 18 458      | 1 776 233    |
| 2014            | 31 355      | 3 090 527    |
| 2015            | 53 079      | 4 908 420    |
| 2016            | 52 160      | 5 013 048    |

**25.13** Shpenzimet e llogaritura më sipër janë bërë pjesë e analizës financiare në vitet përkatëse.

**25.14** Lidhur me mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortit për mbulimin e këtyre shpenzimeve, shihni rezultatet financiare të viteve 2010 – 2016, në rubrikën “Analiza financiare” më poshtë në këtë vendim.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit<sup>34</sup>**

**25.15** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar: “*Sa i takon gjetjeve në këtë pjesë, bie dakord me konkluzionet e raportit, me përjashtim të analizës së shpenzimeve të jetesës së djalit në Kanada për vitet 2015 dhe 2016, mbi të cilat kam bërë një rivlerësim për saktësimin e tyre.*”

<sup>33</sup><https://www150.statcan.gc.ca/t1/tbl1/en/cv.action?pid=1110023001;https://www150.statcan.gc.ca/n1/pub/75f0002m/201102/tbl/tbl04-eng.htm>

<sup>34</sup> Shihni përgjigjen e subjektit mbi rezultatet e hetimit për këtë çështje.



Sa i takon kërkesës për paraqitjen e dokumentacionit të plotë të llogarive bankare të djalit në Kanada që nga momenti i krijimit të tyre, sikurse kam vepruar në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, po depozitoj edhe një herë për vlerësimin tuaj komunikimin elektronik të djalit L.M , me përfaqësues të bankës RBC. Nga banka deklarohet se: "...nuk jemi në gjendje të ofrojmë deklarata bankare që shkojnë përtej një periudhe më të gjatë se 7 vite para nga dita e sotme...". Ndërkohë, në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, kam depozituar pranë KPK-së statementeve të llogarive bankare të djalit pranë bankës RBC, për gjithë periudhën e aksesueshme deri në atë moment".

**25.16** Pas përgjigjeve të subjektit ndaj rezultateve të hetimit, Komisioni bëri edhe një herë llogaritjen e shpenzimeve të studimit, strehimit dhe jetesës së djalit të subjektit L.M , si më poshtë:

#### **Shpenzime shkollimi dhe jetese L.M , në Kanada**

| Viti/përshkrimi | Shpenzime shkollimi | Shpenzime qiraje | Shpenzime jetese | Total (CAD) | Total ( lekë) |
|-----------------|---------------------|------------------|------------------|-------------|---------------|
| 2009            | CAD 15,088          |                  |                  | 15,088      | 1,344,376     |
| 2010            | 0                   |                  |                  | 0           | 0             |
| 2011            | CAD 15,080          |                  |                  | 15,080      | 1,548,925     |
| 2012            | CAD 15,079          |                  |                  | 15,079      | 1,623,653     |
| 2013            | CAD 12,564          | CAD 5,895        |                  | 18,458      | 1,776,233     |
| 2014            | CAD 24,513          | CAD 4,429        | CAD 1,979        | 30,920      | 3,047,659     |
| 2015            | CAD 29,973          | CAD 8,400        | CAD 12,115       | 50,488      | 4,668,774     |
| 2016            | CAD 30,663          | CAD 8,300        | CAD 10,851       | 49,814      | 4,787,556     |

**25.17** Këto shpenzime janë përfshirë në analizën financiare përfundimtare të subjektit në vitet përkatëse.

#### **Vlerësim i Komisionit**

**25.18** Komisioni vlerëson se subjekti është përpjekur të fshehtë dokumentacion lidhur me veprimet bankare të kryera nga djali i saj pranë bankës në Kanada "R.B.C", duke e vendosur në këtë mënyrë Komisionin në pamundësi për të hetuar lidhur me këtë likuiditet.

**25.19** Komisioni nuk e konsideron të vërtetë faktin se subjekti është në pamundësi për të vënë në dispozicion të dhënat bankare për veprimet e kryera nga djali i saj si person i lidhur para viteve 2016, pasi ajo nuk provoi përmbushjen e kërkesave ligjore të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016.

**25.20** Në përgjigje të pyetësorit standard të dërguar nga Komisioni, subjekti ka paraqitur si provë për të vërtetuar pagesat e qirasë së djalit pjesë të *statement*-it bankar të R.B.C, që datojnë nga data 17.11.2014 deri në gusht të vitit 2016. Pra, subjekti ka paraqitur vetëm disa pjesë të *statement*-it bankar (faqe të ndryshme të shkëputura<sup>35</sup>), që lidhen vetëm me kryerjen e pagesës së qirasë, por nuk ka vënë në dispozicion *statement*-in e plotë lidhur me veprimet e kryera në këtë llogari bankare nga ana e djalit të saj. Komisioni krijon bindjen se subjekti ka pasur në dispozicion kopje të plotë të *statement*-it lidhur me llogarinë bankare të djalit të saj pranë R.B.C, por nuk ia ka vënë të plotë në dispozicion Komisionit, që do të mundësonte kryerjen e një analize të plotë financiare lidhur me shpenzimet e kryera në këtë llogari bankare.

**25.21** Për sa më sipër, trupi gjykues do ta vlerësojë këtë qëndrim të subjektit në raport me vlerësimin tërësor të kriterit pasuror dhe çështjes në tërësi.

<sup>35</sup> Për më tepër shihni kopje të *statement*-it bankar të paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit standard.

## 26. Automjete në përdorim

**26.1** Komisioni, bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, konstatoi se bashkëshorti i subjektit ka përdorur për udhëtime jashtë vendit automjetin me targë AA \*\*\* KM. Lidhur me këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime, e cila, në përgjigje të pyetësorit të datës 29.6.2023, deklaroi: *“Mjeti me targë AA \*\*\* KN ka qenë në pronësi të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. Mjeti përdorej prej bashkëshortit në cilësinë e administratorit të shoqërisë për periudhën 2006 – 2022. Përdorimi i mjetit ka qenë për arsye familjare”*.

**26.2** Bazuar në certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor me targë AA \*\*\* KN (e njehsuar me origjinalin nga noterja<sup>36</sup>), pronar i saj rezultoi shoqëria “\*\*\*”.

**26.3** Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se ka përdorur automjetin me targë AA \*\*\* HA, në pronësi të babait të saj G.G.

**26.4** Për përdorimin e këtij automjeti rezultoi një kontratë huapërdorjeje me nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 24.10.2014. Bazuar në certifikatën e pronësisë së këtij mjeti rrugor, lëshuar më 15.7.2013, pronar i saj rezultoi shtetasi G.H.G, i datëlindjes 7.2.1951.

**26.5** Sipas subjektit, ky automjet është përdorur disa herë, kur ka qenë e domosdoshme, si dhe për udhëtime jashtë vendit.

**26.6** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti dhe bashkëshorti i saj duhej të deklaronin në deklaratën *Vetting* pasuritë në përdorim, automjete (detyrim i përcaktuar në pikën 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016).

**26.7** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e saj për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

**26.8** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar: *“Komisioni me të drejtë ka konstatuar se automjetet me targa AA \*\*\* KM dhe AA \*\*\* HA janë përdorur prej meje dhe bashkëshortit për periudhën 2014 – 2016, gjë e cila na obligonte për deklarinin e këtij fakti në deklaratën *Vetting*. Sikurse kam sqaruar në pyetësorin nr. \*\*\*, deklarimi i përdorimit të mjetit me targë AA \*\*\* HA nuk është bërë në deklaratën *Vetting*, për shkak të interpretimit nga ana ime të formularit përkatës, në pjesën që i takon deklarinimit: “Të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite... ose në përdorim...”. Në rastin konkret, referuar edhe informacionit ndihmues të deklaratës *Vetting*, ku sqarohet se: “...Deklarimi përfshin... përfshirë interesat privatë që i ka në pronësi ose në përdorim...”, kam vlerësuar se nuk konsiderohej si pasuri në përdorim automjeti në fjalë, i cili është përdorur prej meje jo në mënyrë të vazhdueshme, por vetëm në disa raste, për nevoja familjare. Gjithashtu është konsideruar fakti se kontrata e huapërdorjes datë 24.10.2014, pra rreth 1.5 vjet pas blerjes – është bërë me qëllim dokumentacioni, për kalimin e kufirit në udhëtimin e datës 25.10.2014, me destinacion Prishtinë, Kosovë, udhëtim të cilin e kam kryer me familjarët dhe jo për përfitim të drejtave të përdorimit në vazhdimësi. Sikurse është sqaruar në përgjigje të pyetjeve të mëparshme, kjo marrëdhënie nuk është konsideruar si posedim/përdorim i vazhdueshëm, në kuptimin juridik formal, por si autorizim për përdorim për rastin konkret të udhëtimit. Deklarimi i përdorimit të mjetit është bërë në përgjigje të pyetjeve të datës 18.9.2020, pasi në mënyrë të shprehur aty është kërkuar: “...nëse është përdorur ndonjëherë pasuri e regjistruar në emër të dikujt tjetër...”. Sa i takon automjetit me targë AA \*\*\* KM, mosdeklarimi nuk është bërë për të njëjtat arsye, por për këtë rast ju sqaroj se, duke u përdorur si mjet pune nga bashkëshorti, nuk është konsideruar në kushtet e kontratës së huapërdorjes dhe, për pasojë, si send në përdorim, për të cilin ekziston detyrimi për deklarim”*.

<sup>36</sup> Shihni vërtetimin njësim me origjinalin nr. \*\*\* rep., datë 22.6.2023.

## Vlerësim i Komisionit

**26.9** Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me ndonjë pasuri të fshehur të subjektit, por i qëndron gjetjes se subjekti ka pasur detyrimin ligjor sipas ligjit nr. 84/2016 të deklaronte në deklaratën *Vetting* këto 2 pasuri automjete, si pasuri në përdorim. Kjo çështje nuk vlerësohet nga Komisioni si shkak i veçuar për penalizimin e saj, por është mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të procesit rivlerësues për këtë subjekt.

### 27. Hua nga shtetasit M dhe N. M

**27.1** Komisioni konstatoi disa veprime bankare të bëra në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në monedhën CAD tek Raiffeisen Bank.

**27.2** Për këto veprime bankare u pyet subjekti, e cila, në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, deklaroi: *“Për shkak se pagesa e tarifës së shkollimit të djalit për semestrin e dytë të vitit 2014, por edhe në vijim për vitet 2015, 2016, duhej të realizohej brenda datës 10 janar, nga ana e bashkëshortit është bërë derdhja e këtyre fondeve nga jashtë në llogarinë CAD në RBA, për t’u transferuar pranë U.B.C, sikurse rezulton nga statement bankar. Janë derdhur 12,000 CAD dhe transferuar 11,866.56 CAD. Burimi i krijimit të kësaj shume është ndihma nga familjarët, sikurse provohet me deklaratën noteriale bashkëlidhur, lëshuar nga motra e bashkëshortit, znj.M.M dhe bashkëshorti i saj, z. N.M . Kthimi i shumës është bërë brenda vitit, me tërheqjet nga llogaritë personale të bashkëshortit nga të ardhurat prej punës, sikurse sqarohet edhe më sipër në përgjigjen e pyetjes 9. Në fund të vitit 2014 nuk kemi pasur asnjë detyrim kundrejt personave të tretë, gjë e cila reflektohet edhe në DPV-të përkatëse. I njëjti mekanizëm i sqaruar më sipër është përdorur edhe për derdhjen e datës 5.1.2015, në shumën 5,500 CAD, si dhe për derdhjen e datës 5.1.2016, në shumën 10,000 CAD. Burimi i fondeve ka qenë ndihma e familjarëve. Në fund të vitit 2015 dhe 2016 nuk kemi pasur asnjë detyrim kundrejt personave të tretë, gjë e cila reflektohet edhe në DPV-të përkatëse. Në çdo rast është përdorur ky burim, për shkak të mungesës së sigurisë për krijimin e fondeve të nevojshme për shkollim gjatë secilit vit nga të ardhurat nga paga. Në përfundim të vitit, të ardhurat e krijuara kanë garantuar mbulimin e ndihmës së familjarëve”.*

**27.3** Komisioni konstatoi se marrja dhe kthimi i shumave është bërë nga subjekti dhe bashkëshorti i saj brenda vitit kalendarik dhe subjekti nuk ka pasur detyrimin për deklarim të tyre në DPV-të e viteve 2014 – 2016 (lidhur me mundësitë e kthimit të shumave huadhënësve, referojuni analizës financiare për vitet 2014 – 2016, në pikën 28 më poshtë).

**27.4** Bazuar në të ardhurat e provuara me dokumentacion në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*<sup>37</sup>, është bërë analiza financiare e mundësisë së znj. M.M dhe bashkëshortit të saj N.M , për huadhëniet afatshkurtra në vitet 2014, 2015 dhe 2016, si më poshtë:

#### Analiza e mundësisë së huadhënies nga shtetasit M dhe N.M

| Përshkrimi                                 | Vlera            |
|--------------------------------------------|------------------|
| Të ardhura nga huadhënësit 2010            | 6,641,346        |
| Shpenzime jetese për 2 persona 2010 – 2013 | 1,107,624        |
| Hua 12.000 CAD, janar 2014                 | 1,182,783        |
| <b>Mundësi për hua, janar 2014</b>         | <b>4,350,939</b> |
| Shpenzime jetese 2 persona 2014            | 439,996          |
| Hua 5,500 CAD, janar 2015                  | 508,606          |
| <b>Mundësi për hua, janar 2015</b>         | <b>3,402,337</b> |
| Shpenzime jetese 2 persona 2015            | 448,552          |

<sup>37</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.2.2023, të shtetasve M dhe N. M; listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (biznesi i vogël) të shoqërisë, personit fizik “\*\*\*\*\*” për vitin 2010; formularët e deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga punësimi dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të shoqërisë personit fizik “\*\*\*\*\*” për vitin 2010.

|                                   |                  |
|-----------------------------------|------------------|
| Hua 10,000 CAD, janar 2016        | 961,095          |
| <b>Mundësi për hua janar 2016</b> | <b>1,992,690</b> |

**27.5** Nga analiza financiare rezultoi se shtetasit M dhe N.M kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe për huadhëniet afatshkurtra (brenda vitit) të dhëna subjektit dhe bashkëshortit të saj si ndihmesë për pagesën e studimeve të djalit në Kanada.

## **28. Analiza financiare**

**28.1** Komisioni, bazuar në të dhënat e administruara gjatë hetimit dhe dosjen e paraqitur nga ILDKPKI-ja për vlerësimin e pasurisë së subjektit Blerina Muço, hartoi analizën financiare sipas tabelës më poshtë.

**28.2** Në këtë analizë janë përfshirë të gjitha të ardhurat e ligjshme të deklaruara dhe provuar gjatë hetimit, ndryshimi i likuiditeteve, krijimi i pasurive dhe shpenzimet e kryera nga subjekti dhe personat e lidhur.

**28.3** Analiza financiare është e ndarë në dy pjesë: pjesa e parë përfshin periudhën 1993 – 2003, e cila është bërë në bllok për subjektin për shkak, se ai ka deklaruar për herë të parë në vitin 2003 pranë ILDKPKI-së; pjesa tjetër e analizës bëhet për periudhën 2004 – 2016, në të cilën subjekti është deklarues pranë ILDKPKI-së, prandaj edhe analiza financiare është bërë vit pas viti për këtë hark kohor.

**28.4** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti kishin një pamundësi financiare totale prej -10,959,155 lekësh, për periudhën 1993 – 2016.

**28.5** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e saj për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni lidhur me analizën financiare, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**28.6** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar: *“Pasi u njoha me rezultatet e analizës financiare, vlerësoj Komisionin për hetimin e plotë dhe të drejtë, por dua të theksoj se nuk bie dakord me përfundimet e raportit, sa i takon vlerësimin të të ardhurave dhe nivelit të shpenzimeve në disa vite. Nga ky vlerësim janë nxjerrë rezultatet financiare, të cilat kanë shërbyer për të përcaktuar rezultatin final, të shprehur si pamundësi financiare totale në shumën 10,959,155 lekë. Duke konsideruar të pakontestueshme gjetjet deri në vitin 2004, në vijim po parashatroj pretendimet e mia vetëm sa i takon atyre viteve ku rezultati financiar është me balancë negative:*

*- Për vitin 2005, rezultati financiar sipas Komisionit rezulton me balancë negative, në shumën -710,398 lekë, rezultat i cili vjen si pasojë e faktit se në analizë janë lënë jashtë vlerësimin, duke u konsideruar si të ardhura me burim jo të ligjshëm të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti në shumën 6,000 euro, si pagesë prej shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., për konsulencë juridike. Në kreun mbi të ardhurat të këtij dokumenti kam parashtruar arsyet shteruese se përse këto të ardhura nuk mund të konsiderohen me burim të paligjshëm e, për pasojë, duhet të përfshihen në analizën financiare si të ardhura të ligjshme. Duke besuar se trupa gjyquese do të pranojë kërkesën për njohjen e këtyre të ardhurave, jo vetëm për vitin 2005, por për shifrën totale (73,000 euro), si të ardhura të ligjshme, atëherë, pa u zgjatur në vlerësimin e elementeve të tjera të analizës për vitin 2005, rezultati financiar vetëm me këtë korrigjim ndryshon pozitivisht.*

*- Për vitet 2006 – 2009 rezulton e njëjta problematikë sikurse dhe për vitin 2005, parashtruar më sipër.*

*- Sikurse kam shpjeguar në pyetësorin nr. \*\*\*, duhet të konsiderohet gjithashtu edhe fakti se asnjë nga udhëtimet e regjistruara në emër të bashkëshortit, nxjerrë nga tabela TIMS për datat 21 shkurt, 3 mars, 19 maj dhe 16 qershor, nuk kanë lidhje me të. Në tabelë rezulton se udhëtuesi*

disponon pasaportën me nr. \*\*\*, ndërkohë që bashkëshorti në këtë kohë dispononte pasaportën me nr. \*\*. Kjo gjë konfirmohet jo vetëm nga të dhënat e së njëjtës tabelë në udhëtimet e kryera realisht prej tij, por edhe prej të dhënave të nxjerra nga pasaporta, kopje të së cilës po depozitoj për vlerësimin tuaj.

- Për vitin 2012, rezultati financiar sipas Komisionit rezulton me balancë negative, në shumën -226,833 lekë, diferencë e cila vjen si pasojë e mospërfshirjes së të ardhurave të plota të bashkëshortit nga puna pranë shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.

- Për vitin 2014, rezultati financiar sipas Komisionit rezulton me balancë negative, në shumën -100,540 lekë, rezultat i cili vjen si pasojë e problematikës në përlllogaritje të shpenzimeve të udhëtimit. Gjithashtu, sipas tabelës së analizës financiare, si pagesë për qiranë e djalit në këtë vit është vendosur shuma 4,429 CAD. Kjo shifër është rezultati kumulativ i pagesës së kryer nga motra e bashkëshortit, në vlerën 3,028 CAD), për akomodimin e djalit në rezidencë, e deklaruar në DPV-në 2014 si dhuratë dhe pagesës së qirasë për muajt nëntor dhe dhjetor 2014, në vlerën 1,400 CAD.

- Gjithashtu, dua të sqaroj se për këtë vit, shpenzimet e jetesës së djalit për 2 muaj (nëntor, dhjetor), të llogaritura në raport në shumën 2,414 CAD, përjashtuar qiranë, janë të ekzagjeruara dhe jashtë çdo standardi.

- Për vitin 2015 – 2016, rezultati financiar sipas Komisionit rezulton me balancë negative, në shumën -315,962 lekë, rezultat i cili vjen si pasojë e problematikës në përlllogaritje të shpenzimeve”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**28.7** Lidhur me kundërshtimin nga subjekti të rezultatit financiar të viteve 2005 – 2010, nga mospërfshirja e të ardhurave nga kontratat e shërbimit nga subjektet “\*\*\*\*”/“\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” s.r.l., Komisioni vlerëson se këto të ardhura nuk duhen bërë pjesë e të ardhurave të ligjshme në analizën financiare. Këto të ardhura janë trajtuar më sipër në këtë vendim.

**28.8** Lidhur me pretendimin e subjektit se të ardhurat nga paga tek “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k. duhej të ishin sipas vlerave të kaluara me bankë, Komisioni vlerësoi se këto të ardhura do të përfshihen në analizën financiare sipas vërtetimeve të ardhura nga ISSH-ja (kjo është trajtuar më sipër në këtë vendim).

**28.9** Lidhur me pretendimin e subjektit për zbritjen e shpenzimeve të udhëtimit për disa nga udhëtimet, që sipas saj nuk janë kryer nga bashkëshorti, Komisioni bëri verifikime në sistemin TIMS. Nga informacioni i verifikuar rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka numër tjetër pasaporte nga ai i paraqitur për të në përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në raportin e hyrje-daljeve nga Shqipëria. Si rrjedhim, në analizën financiare janë zbritur kostot e udhëtimit në datat ku nuk figuron që bashkëshorti i subjektit ka lëvizur jashtë Shqipërisë.

**28.10** Lidhur me udhëtimin në vitin 2014, në të cilin subjekti pretendon se janë vendosur shpenzime në vlerën 4,000 euro dhe jo 450,000 lekë, Komisioni vlerëson se shpenzimi prej 4,000 euro është paraqitur si kosto udhëtimi nga vetë subjekti në një tabelë që ishte pjesë e përgjigjes së pyetësorit standard. Prandaj kjo kosto është bërë pjesë e analizës financiare të këtij viti.

**28.11** Për vitin 2015, subjekti kishte kundërshtuar shpenzimet e udhëtimit për një nga udhëtimet, të cilin, në përgjigje të rezultateve, provon se i ka ndarë me motrën. Komisioni e reflektoi këtë gjë në analizën financiare, duke i zbritur shpenzimet për pjesën takuese në këtë udhëtim.

**28.12** Lidhur me pretendimin e subjektit për zbritjen e shpenzimeve të studimit të djalit në Kanada për vitin 2014, në shumën 3,000 CAD, për shkak se kjo vlerë është paguar nga halla e

tij, Komisioni vlerëson se këto shpenzime duhet të jenë pjesë e analizës financiare meqë kjo shumë është përfshirë edhe si e ardhur në këtë vit.

**28.13** Lidhur me pretendimin e subjektit për zbritjen e kostos së transportit nga shpenzimet e jetesës së djalit në Kanada, për shkak të pajisjes me U-PASS, Komisioni verifikoi dokumentacionin e sjellë nga subjekti gjatë hetimit. Nga ky dokumentacion rezulton se djali i subjektit ishte pajisur me U-PASS, e cila ishte një kartë që u jep studentëve të *B.C.U* lehtësi në transportin publik brenda qytetit, si dhe lehtësi të tjera. Referuar këtij informacioni, Komisioni vlerësoi se nga shpenzimet e jetesës së djalit të subjektit gjatë periudhës së studimeve në këtë universitet do të zbritet zëri i shpenzimeve të transportit.

**28.14** Lidhur me kundërshtimin nga subjekti në vitin 2015 për llogaritjen e shpenzimeve të qirasë për djalin në shumën 300 CAD, me pretendimin se nuk duhej përfshirë kjo vlerë, pasi qiraja mujore për këtë periudhë ishte 600 CAD/muaj, Komisioni analizoi të dhënat e kontratës së qirasë, në të cilën ai përfshihet në këtë periudhë. Në analizën financiare për qiranë e këtij viti është përfshirë qiraja mujore prej 600 CAD/muaj, por edhe vlera 300 CAD, e cila përbën garancinë e qirasë që është parapaguar këtë vit. Kjo shumë është cituar në kontratën e qirasë në një vlerë totale prej 900 CAD dhe pjesa takuese e djalit të subjektit është 300 CAD, meqenëse bashkëjetonin 3 persona.

**28.15** Lidhur me pretendimin e subjektit se shpenzimet e jetesës së djalit në Kanada janë tepër të larta dhe jashtë çdo standardi, Komisioni vë në dukje se në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\* vetë subjekti pranon që shpenzimet e qirasë dhe jetesës së djalit për muajt nëntor – dhjetor 2014 kanë qenë në vlerën 6,142 CAD. Po t'i zbrisim kësaj vlere 1,400 CAD për qiranë, mbeten 4,742 CAD për shpenzimet e jetesës, pra 2,371 CAD/muaj. Ndërkohë, pas rregullimeve në analizën financiare, shpenzimet e jetesës për këto dy muaj për djalin llogariten në vlerën 1,979 CAD, për vitin 2014.

| SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: BLERINA G. MUÇO                                   |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   |                  |                   |                   |                  |                                    |                  |                  |                   |  |
|----------------------------------------------------------------------------|------------------|------------------|------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|------------------|-------------------|-------------------|------------------|------------------------------------|------------------|------------------|-------------------|--|
| PERSHKRIMI                                                                 | 1993 - 2003      | 2004             | 2005             | 2006              | 2007              | 2008              | 2009              | 2010             | 2011              | 2012              | 2013             | 2014                               | 2015             | 2016             | TOTAL             |  |
| <b>PASURI</b>                                                              | <b>5,800,000</b> | <b>711,005</b>   | <b>1,585,312</b> | <b>3,477,933</b>  | <b>3,422,843</b>  | <b>-1,512,547</b> | <b>569,071</b>    | <b>1,401,231</b> | <b>-1,423,636</b> | <b>-1,050,045</b> | <b>125,357</b>   | <b>-45,308</b>                     | <b>-483,876</b>  | <b>-524,663</b>  | <b>5,700,000</b>  |  |
| Apartament Rr. ****, Tirane - 2000 - 5,000,000 leke - 50%                  | 5,000,000        |                  |                  |                   |                   |                   |                   |                  |                   |                   |                  |                                    |                  |                  | 5,000,000         |  |
| Automjet Daimler Benz **** - 2004 - 700,000 leke                           |                  | 700,000          |                  |                   |                   |                   |                   |                  |                   |                   |                  |                                    |                  |                  | 700,000           |  |
| <b>Ndryshim ne likuiditet</b>                                              | <b>800,000</b>   | <b>11,005</b>    | <b>1,585,312</b> | <b>3,477,933</b>  | <b>3,422,843</b>  | <b>-1,512,547</b> | <b>569,071</b>    | <b>1,401,231</b> | <b>-1,423,636</b> | <b>-1,050,045</b> | <b>125,357</b>   | <b>-45,308</b>                     | <b>-483,876</b>  | <b>-524,663</b>  |                   |  |
| <b>DETYRIME</b>                                                            | <b>5,000,000</b> | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>          | <b>0</b>          | <b>0</b>          | <b>43,528</b>     | <b>8,911</b>     | <b>-52,439</b>    | <b>41,012</b>     | <b>-8,218</b>    | <b>-10,407</b>                     | <b>-13,248</b>   | <b>-9,139</b>    | <b>2,205,765</b>  |  |
| Kredi 5,000,000 leke Raiffeisen Bank - M. Muço - 2000                      | 5,000,000        |                  |                  |                   |                   |                   |                   |                  |                   |                   |                  |                                    |                  |                  | 2,205,765         |  |
| Kredi 68,100 leke Raiffeisen Bank - Blerina Muço - 2009                    |                  |                  |                  |                   |                   |                   | 43,528            | -43,528          |                   |                   |                  |                                    |                  |                  | 0                 |  |
| Kredi 81,000 leke Raiffeisen Bank - Blerina Muço - 2010                    |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   | 52,439           | -52,439           |                   |                  |                                    |                  |                  | 0                 |  |
| Kredi 43,912 leke Raiffeisen Bank - Blerina Muço - 2012                    |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   |                  |                   | 41,012            | -8,218           | -10,407                            | -13,248          | -9,139           | 0                 |  |
| <b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>                                     | <b>800,000</b>   | <b>711,005</b>   | <b>1,585,312</b> | <b>3,477,933</b>  | <b>3,422,843</b>  | <b>-1,512,547</b> | <b>525,543</b>    | <b>1,392,321</b> | <b>-1,371,197</b> | <b>-1,091,057</b> | <b>133,575</b>   | <b>-34,900</b>                     | <b>-470,627</b>  | <b>-515,524</b>  | <b>3,494,235</b>  |  |
| <b>TE ARDHURA dokumentuar</b>                                              | <b>9,645,979</b> | <b>2,153,648</b> | <b>2,054,021</b> | <b>1,678,222</b>  | <b>1,726,828</b>  | <b>1,848,399</b>  | <b>1,507,792</b>  | <b>1,905,289</b> | <b>1,846,972</b>  | <b>1,754,195</b>  | <b>3,719,271</b> | <b>4,858,046</b>                   | <b>6,112,047</b> | <b>5,331,150</b> | <b>46,141,858</b> |  |
| Te ardhura nga puna e subjektit Blerina Muço                               | 3,345,124        | 760,361          | 788,684          | 819,742           | 847,408           | 867,542           | 1,004,242         | 1,025,789        | 1,073,876         | 1,046,190         | 1,083,079        | 1,266,762                          | 1,281,927        | 1,247,111        | 16,457,837        |  |
| Te ardhura nga puna dhe aktiviteti privat i b/shortit te subjektit M. Muço | 6,300,855        | 1,393,287        | 1,265,337        | 858,480           | 879,420           | 980,857           | 0                 | 879,500          | 773,096           | 708,005           | 2,636,192        | 3,292,735                          | 4,830,120        | 4,084,039        | 28,881,922        |  |
| Te ardhura nga dhurimi kunata e subjektit per djaln ne Kanada              |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   |                  |                   |                   |                  | 298,549                            |                  |                  | 298,549           |  |
| Te ardhura nga diference kursi 2008 - 2009 per 36,000 € kursime cash       |                  |                  |                  |                   |                   |                   | 503,550           |                  |                   |                   |                  |                                    |                  |                  | 503,550           |  |
| <b>SHPENZIME</b>                                                           | <b>5,363,561</b> | <b>1,286,234</b> | <b>1,179,107</b> | <b>1,201,500</b>  | <b>1,297,236</b>  | <b>3,180,363</b>  | <b>2,438,144</b>  | <b>1,213,283</b> | <b>2,901,665</b>  | <b>3,072,135</b>  | <b>3,463,856</b> | <b>4,950,619</b>                   | <b>6,508,126</b> | <b>6,342,626</b> | <b>39,034,895</b> |  |
| Shpenzime jetese                                                           | 2,462,569        | 375,856          | 438,228          | 438,228           | 546,480           | 546,480           | 546,480           | 489,555          | 432,630           | 418,679           | 458,328          | 696,660                            | 672,828          | 724,867          | 9,247,868         |  |
| Shpenzime qiraje                                                           | 550,000          |                  |                  |                   |                   |                   |                   |                  |                   |                   |                  |                                    |                  |                  | 550,000           |  |
| Shpenzim per zhdoganimin e automjetit Benz - 2004                          |                  | 323,766          |                  |                   |                   |                   |                   |                  |                   |                   |                  |                                    |                  |                  | 323,766           |  |
| Shpenzime arsimimi femijet ne Shqiperi                                     | 450,000          | 150,000          | 212,500          | 275,000           | 387,500           | 307,000           | 117,000           | 91,500           | 64,000            | 66,000            | 68,500           | 71,000                             | 73,500           | 137,500          | 2,471,000         |  |
| Shpenzime shkollimi dhe jetese djali ne Kanada                             |                  |                  |                  |                   |                   |                   | 1,344,376         | 0                | 1,548,925         | 1,623,653         | 1,776,233        | 3,047,659                          | 4,668,774        | 4,787,556        | 18,797,175        |  |
| Shpenzime mobilimi pajisje elektronike                                     | 1,000,000        |                  |                  |                   |                   |                   | 65,100            | 78,000           |                   | 49,900            |                  |                                    |                  |                  | 1,193,000         |  |
| Shpenzime per principal dhe interesa kredi RFZ - 5,000,000 leke - 2000     | 900,993          | 284,524          | 284,524          | 284,524           | 284,524           | 284,524           | 284,524           | 284,524          | 284,524           | 284,524           | 284,524          | 284,524                            | 284,524          | 284,524          | 4,599,805         |  |
| Shpenzime komisione dhe interesa kredi RFZ - 68,100 leke - 2009- subjekti  |                  |                  |                  |                   |                   |                   | 6,468             | 4,626            |                   |                   |                  |                                    |                  |                  | 11,094            |  |
| Shpenzime komisione dhe interesa kredi RFZ - 81,000 leke - 2010- subjekti  |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   | 8,280            | 5,662             |                   |                  |                                    |                  |                  | 13,942            |  |
| Shpenzime komisione dhe interesa kredi RFZ - 43,912 leke - 2012- subjekti  |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   |                  |                   | 4,305             | 9,072.34         | 6,882.99                           | 4,042.07         | 746              | 25,048            |  |
| Shpenzim per dhurim babait te b/shortit - 2008                             |                  |                  |                  |                   |                   | 1,673,551         |                   |                  |                   |                   |                  |                                    |                  |                  | 1,673,551         |  |
| Shpenzime mjekesore - 2008                                                 |                  |                  |                  |                   |                   | 307,217           |                   |                  |                   |                   |                  |                                    |                  |                  | 307,217           |  |
| Shpenzime per blerje me karte                                              |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   |                  |                   |                   |                  |                                    | 479,450          | 50,316           | 529,766           |  |
| Shpenzime udhetimi                                                         |                  | 152,088          | 243,855          | 203,748           | 78,732            | 61,591            | 74,196            | 256,799          | 565,924           | 625,075           | 867,199          | 843,893                            | 325,008          | 357,117          | 4,655,224         |  |
| <b>Analiza dokumentuar</b>                                                 | <b>3,482,418</b> | <b>156,409</b>   | <b>-710,398</b>  | <b>-3,001,211</b> | <b>-2,993,251</b> | <b>180,583</b>    | <b>-1,455,896</b> | <b>-700,314</b>  | <b>316,504</b>    | <b>-226,883</b>   | <b>121,839</b>   | <b>-57,673</b>                     | <b>74,548</b>    | <b>-495,953</b>  | <b>-8,791,697</b> |  |
|                                                                            |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   |                  |                   |                   |                  | <b>Pamundesi financiare totale</b> |                  |                  | <b>-9,641,579</b> |  |
| Gjendje CASH ne EURO                                                       |                  |                  |                  |                   |                   | € 47,000          | € 36,000          | € 32,900         | € 18,000          | € 2,800           | € 3,060          | € 3,060                            | € 3,060          | € 3,060          |                   |  |
| Gjendje CASH ne LEKE                                                       | 800,000 Lekë     | 300,000 Lekë     | 300,000 Lekë     | 800,000 Lekë      | 0                 |                   |                   |                  |                   |                   |                  |                                    |                  |                  |                   |  |

**28.16** Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëshorti i saj rezultuan me një pamundësi financiare totale prej 9,641,579 lekësh për shtimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, shtimin e likuiditeteve, si dhe mbulimin e shpenzimeve për periudhën e rivlerësimit.

## **29. Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare**

**29.1** Analiza financiare është e ndarë në dy pjesë: pjesa e parë përfshin periudhën 1993 – 2003, e cila është bërë në bllok për subjektin, për shkak se ajo ka deklaruar për herë të parë në vitin 2003 pranë ILDKPKI-së; pjesa tjetër e analizës bëhet për periudhën 2004 – 2016, në të cilën subjekti është deklarues pranë ILDKPKI-së, prandaj edhe analiza financiare është bërë vit pas viti për këtë hark kohor.

**29.2** Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

- **Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe bashkëshortes**, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga BKT, Raiffeisen Bank, Credins Bank, Intesa Sanpaolo Bank, *R.B.C*, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.
- **Gjendjet e llogarive bankare të djalit të subjektit L.M** tek *R.B.C* nuk janë vënë në dispozicion në mënyrë të plotë nga subjekti. Subjekti nuk vuri në dispozicion *statement* të këtyre llogarive, në mënyrë që të analizohet mundësia e tij për krijimin e këtyre likuiditeteve nga momenti i krijimit deri në datën e deklaratës *Vetting*.
- **Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:**
  - i) të ardhurat nga pagat e subjektit në: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat (1993 – 1996 dhe 1997 – 1999), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (1999 – 2016), si eksperte në Shkollën e Magjistraturës (2008);
  - ii) të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit në: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Skrapar (1993 – 1994), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kuçovë (1994 – 1996 dhe 1998), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh (1996 – 1998), MPCSG (1998), Kryeministri (1998 – 2000), ish-Ministrinë Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (2000 – 2002), Kuvendin e Shqipërisë (2002 – 2005), shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. (2011 – 2013), “\*\*\*” (2013), Universitetin L (2013 – 2016), “\*\*\*” sh.p.k. (2016) dhe “\*\*\*” sh.p.k. (2016), “\*\*\*” sh.p.k. (2015 – 2016);
  - iii) të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga pagesa kalimtare nga ISSH-ja (2005 – 2008), sipas vlerave të vërtetuara nga *statement*-i bankar i llogarisë së tij tek Intesa Sanpaolo Bank;
  - iv) të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti privat si person fizik me NIPT \*\*\* (2010 – 2011), sipas vlerave të kaluara me bankë në llogarinë e personit fizik tek BKT-ja;
  - v) të ardhurat nga dhurimi i motrës së subjektit B.M në Kanada për ndihmë në shpenzimet e arsimimit të djalit L.M (2014), sipas deklaratës së saj noteriale dhe vërtetimit bankar;
  - vi) të ardhurat nga efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit nga viti 2008 në vitin 2009, për pjesën e kursimeve gjendje *cash* në monedhën euro. Kursi i këmbimit të monedhës euro ndryshon nga 123.18 (2008) në 137.17 (2009). Kjo rrit artificialisht vlerën e kursimeve *cash* të deklaruara nga subjekti në monedhën euro që në vitin 2008. Për shkak të këtij vlerësimi të monedhës së euros rriten artificialisht likuiditetet e subjektit, duke e rënduar rezultatin financiar për këtë vit, ndërkohë që subjekti faktikisht nuk ka shtuar likuiditetet e tij. Për të eliminuar këtë mbivlerësim të likuiditeteve ekzistuese në valutën e huaj, në vitin 2009, në analizën financiare do të konsiderohet e ardhur diferenca në lekë e këtyre kursimeve (gjendja *cash* 36,000 euro \* diferencën e kurseve të viteve 2008 – 2009).

Nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat e pretenduara nga bashkëshorti i subjektit për shërbimet e ofruara për konsulencë juridike tek subjektet “\*\*\*”/“\*\*\*” dhe



“\*\*\*” s.r.l., për shkak se nuk u vërtetua pagesa e tatimit të mbajtur në burim për këto të ardhura.

- **Shpenzimet, ku përfshihen:**

- i) shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT); për djalin L.M shpenzimet e jetesës në Shqipëri, pas fillimit të studimeve në Kanada, janë llogaritur vetëm për ato muaj që ai ka qëndruar në Shqipëri<sup>38</sup>;
- ii) shpenzimet për shkollimin e fëmijëve në Shqipëri, sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit dhe dokumenteve provuese të institucioneve arsimore;
- iii) shpenzimet e qirasë të deklaruara nga vetë subjekti në përgjigjet e pyetësorit (1994 – 2000);
- iv) shpenzimet e shkollimit dhe jetesës së djalit në Kanada sipas provave dokumentare të sjella nga vetë subjekti (2009 – 2016);
- v) shpenzimet për mobilim (deri në vitin 2001 – 2002) dhe blerjet e pajisjeve elektronike (2009, 2010, 2012) të deklaruara nga vetë subjekti në përgjigje të pyetësorit, si dhe të vërtetuara nga dokumente bankare, për të cilat janë marrë kredi konsumatore;
- vi) shpenzimet për shlyerjen e kredisë së marrë për blerjen e apartamentit pranë Raiffeisen Bank (2000 – 2016), si dhe për shlyerjen e kredive konsumatore të marra po tek kjo bankë (2009, 2010 dhe 2012);
- vii) shpenzimet për dhurim babait bashkëshortit (2008), sipas *statement*-it bankar dhe deklarimit të vetë subjektit në përgjigje të pyetësorit;
- viii) shpenzimet mjekësore (2008) të deklaruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit;
- ix) shpenzimet e udhëtimit, për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshorti kanë deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm;
- x) shpenzimet për blerje me kartë nga *statement*-et bankare të llogarive të subjektit dhe bashkëshortit tek Intesa Sanpaolo Bank;
- xi) shpenzimet për zhdoganimin e automjetit tip “\*\*\*”, viti 2004, sipas deklaratës doganore të importit të automjetit.

- **Vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme**, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive<sup>39</sup>.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), në përmbushje të ushtrimit të funksioneve, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe neneve 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar (klasifikuar “Sekret”) nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, ku rezulton se:

- Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016.

---

<sup>38</sup> Sipas të dhënave të sistemit TIMS.

<sup>39</sup> Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme në dosjen e ILDKPKI-së.

- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.
- Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.
- Konstatohet se subjekti i rivlerësimit Blerina Muço është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.
- Për pastërtinë e figurës, nuk ka pasur të dhëna e dyshime bazuar në raportin e AKSIK-së.
- Në datën 19.7.2022 është paraqitur raporti i deklasifikuar plotësisht i AKSIK-së (nr. \*\*\* vendimi, datë 12.7.2022), ku konstatohet se për subjektin Blerina Muço nuk disponohen të dhëna mbi përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme dhe konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit.

## **2. Bazuar në faktet e sipërpërmendura:**

- Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kontakte të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Subjektit i rivlerësimit e ka dorëzuar në kohë deklaratën e kontrollit të figurës sipas ligjit.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të pasaktë dhe nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

**3.** Sa më sipër, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Blerina Muço, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**1.** Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit Blerina Muço është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**1.1** Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

## **2. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

**Dokumenti 1** – Vendimi nr. \*\*\*, datë 20.5.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditës Dega e Shoqërisë së Huaj “\*\*\*\*”, e paditur shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. etj., me objekt “Detyrimi i të paditurit të njohë paditësin pronar të apartamentit me sipërfaqe totale 163.43 m<sup>2</sup>, që ndodhet në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, fshirjen e regjistrimit të pasurisë nga regjistri hipotekor në emër të të paditurve A dhe regjistrimin në emër të paditësit shoqërisë “\*\*\*\*”, marrjen e masës së sigurimit të padisë”.

Çështja është gjykuar në seancë gjyqësore, me trup gjykues të përbërë vetëm nga subjekti i rivlerësimit. Në përfundim është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë. Ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.7.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 20.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në vendim nuk pasqyrohet data e regjistrimit të çështjes për gjykim, por është pasqyruar vetëm numri i aktit \*\*\*. Vendimi është dhënë në datën 20.5.2014. Në këto kushte, nuk mund të arrihet në përfundim për afatin e gjykimit të çështjes.

**Dokumenti 2** – Vendimi nr. \*\*\*, datë 25.5.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditës shoqëria “A.K. e R.” sh.p.k., Gj.F, i paditur Gj. Gj., me objekt “Detyrimi i të paditurit të na shpërblejë dëmin jo pasuror, shkaktuar si rezultat i publikimeve të pavërteta/mashtruese në shumën 25.000 euro për shoqërinë dhe në shumën 25.000 euro për Gj.F, detyrimin të publikojë përgënjeshttrimin për deklaratat e tij kundër paditësve”.

Çështja është gjykuar në seancë gjyqësore, me trup gjykues të përbërë vetëm nga subjekti i rivlerësimit. Në përfundim është vendosur pranimi i pjeshëm i kërkesë padisë. Nga aktet nuk evidentohet që ndaj këtij vendimi të jetë paraqitur ankim. Në vendim nuk pasqyrohet data e regjistrimit të çështjes për gjykim, por është pasqyruar vetëm numri i aktit \*\*\*. Vendimi është dhënë në datën 20.5.2015. Në këto kushte, nuk mund të arrihet në përfundim për afatin e gjykimit të çështjes.

**Dokumenti 3** – Vendimi nr. \*\*\*, datë 23.3.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditës Ll. Ç, e paditur shoqëria “S.G.S. A.A” sh.p.k., Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, me objekt “Detyrimi i të paditurit të lirojë e dorëzojë sipërfaqen prej 1.500 m<sup>2</sup>, pronë e paditësit”.

Çështja është gjykuar në seancë gjyqësore, me trup gjykues të përbërë vetëm nga subjekti i rivlerësimit. Në përfundim është vendosur rrëzimi i kërkesë padisë. Nga aktet nuk evidentohet që ndaj këtij vendimi të jetë paraqitur ankim.

Në vendim nuk pasqyrohet data e regjistrimit të çështjes për gjykim, por është pasqyruar vetëm numri i aktit \*\*\*. Vendimi është dhënë në datën 23.3.2016. Në këto kushte, nuk mund të arrihet në përfundim për afatin e gjykimit të çështjes.

**3.** Për këto konstatime, lidhur me 3 çështjet gjyqësore, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti, për të tria dokumentet e paraqitura - vendime, ka sqaruar: *“Komisioni ka arritur me të drejtë në përfundimin e mësipërm mbi mungesën e datës së regjistrimit të këtyre çështjeve në vendimet që ka paraqitur. Lidhur me këtë fakt, ju bëj me dije se në praktikën e punës së gjykatës gjatë periudhës që janë shqyrtuar këto çështje gjyqësore nuk pasqyrohet në vendim data e regjistrimit të çështjes. Nga viti 2015 e në vijim, kjo praktikë është ndryshuar dhe, tashmë, edhe kjo e dhënë përfshihet në vendimin përfundimtar.*

*Për efekt të llogaritjes së kohëzgjatjes së gjykimit, kjo e dhënë për periudhën përpara vitit 2015 mund të nxirret nga sistemi elektronik i gjykatës, si dhe nga shënimi që bëhet në kapakun e dosjes, në rubrikën që titullohet “Data e Regjistrimit”. Në rastin konkret, çështjet e zgjedhura janë gjykuar në afatet si në vijim:*

- Çështja e cilësuar si dokumenti 1 është regjistruar në gjykatë në datën 16.4.2013 dhe është përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.5.2014, duke zgjatur gjykimi 13 muaj e 4 ditë.
- Çështja e cilësuar si dokumenti 2 është regjistruar në gjykatë në datën 11.6.2014 dhe është përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.5.2015, duke zgjatur gjykimi 12 muaj e 17 ditë.
- Çështja e cilësuar si dokumenti 3 është regjistruar në gjykatë në datën 27.1.2014 dhe është përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.3.2016, duke zgjatur gjykimi për rreth 16 muaj.

*Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit për këto vendime, rezulton se të tre gjykimet janë zhvilluar tej afatit 6-mujor të përcaktuar në pikën 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Edhe pse në dijeni të këtij fakti kam përzgjedhur këto vendime, duke vlerësuar si kompleksitetin e tyre, ashtu edhe cilësinë e vendimmarrjes, e cila është konfirmuar nga Gjykata e Apelit. Sfida për*

*dhënien e vendimeve të drejta dhe ligjore, në të tria rastet ka kërkuar kryerjen e një hetimi gjyqësor sa më të plotë, në referim dhe zbatim të detyrimeve procedurale për gjykatën dhe në respektim të drejtave procedurale të palëve pjesëmarrëse në proces, duke u përpjekur që në asnjë rast afati kohor i zhvillimit të procesit të mos ndikojë dhe të mos cenojë cilësinë e vendimmarrjes.*

*Për seancat e zhvilluara dhe për shkaqet e shtyrjeve në çdo rast. Në të tria këto gjykime, asnjë prej seancave nuk është shtyrë për mungesën e gjyqtarit. Lidhur me afatet e gjykimit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 5, datë 12.12.2013, kanë mbajtur qëndrim për faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e një gjykimi, faktorë të cilët janë vërejtur edhe në çështjet në fjalë. Konkretisht, në vendim Kolegjet shprehen:*

*“...Respektimi i afatit të arsyeshëm ligjor varet nga shumë faktorë të procesit të gjykimit, të cilët janë të lidhur dhe ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e këtij procesi, siç mund të jenë: sjellja e palëve në proces; kompleksiteti i çështjes; përkushtimi dhe aftësia e gjykatës dhe administratës gjyqësore për përfundimin në kohë të procesit dhe ushtrimin e detyrës në përputhje me ligjin etj... Procesi gjyqësor në vetvete mund të ndahet në dy segmente kohore: 1) atë/ato segmente kohore që kanë të bëjnë me veprimet procedurale që duhet të ndërmerren palët në proces; 2) atë/ato segmente kohore që kanë të bëjnë me veprimtarinë e gjyqtarit, duke zbritur nga e gjithë kohëzgjatja reale e procesit gjyqësor afatin kohor që i atribuohet gjyqtarit dhe aparatit gjyqësor për mbylljen përfundimtare të procesit. Jo e gjithë periudha kohore që i atribuohet gjyqtarit brenda një procesi gjyqësor (si pjesë e punës së tij), në kuptimin e përmendur më sipër, mund të konsiderohet automatikisht si tej afatit të arsyeshëm. Në fakt, çdo proces gjyqësor, edhe ai që kryhet dhe përfundon shpejt, ka kohëzgjatjen e tij normale, që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejt si me kryerjen e disa fazave procedurale, ashtu edhe me gjykimet e çështjeve në disa nivele gjykatash (sipas rastit). Në mënyrë që afatet kohore të konsiderohen të paarsyeshme, nuk mjafton vetëm të merret për bazë e gjithë kohëzgjatja reale e procesit, por duhen verifikuar rast pas rasti veprimet konkrete që janë ndërmarrë në kuadër të këtij procesi dhe nëse këto veprime justifikojnë apo jo vonesën dhe neglizhencën e gjyqtarit”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

➤ Lidhur me çështjen gjyqësore, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.5.2015

Data e regjistrimit të kësaj çështjeje është 11.6.2014 dhe ajo ka zgjatur tej afatit të arsyeshëm 6-mujor të përcaktuar në pikën 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rezulton se seanca e parë është caktuar në datën 2.7.2014 dhe është shtyrë me kërkesë të paditësit. Gjykata e ka shtyrë seancën e radhës në datën 17.9.2014. Më pas, seanca e radhës është caktuar më 20.10.2014. Në vijim, caktimi i seancave të radhës nga njëra seancë te tjetra kalojnë afatin 2-javor, por në disa raste edhe mbi 1 muaj, dhe kjo është bërë shkak për zgjatjen e gjykimit tej afatit të arsyeshëm.

➤ Lidhur me çështjen gjyqësore, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.3.2016

Data e regjistrimit të kësaj çështjeje është 27.11.2014 dhe ajo ka zgjatur tej afatit të arsyeshëm 6-mujor të përcaktuar në pikën 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Seanca përgatitore është caktuar në datën 16.12.2014. Seanca më pas është caktuar në datën 27.1.2015, e cila është shtyrë bazuar në kërkesën e palëve për njohje me prova, në datën 24.2.2015. Caktimi i seancave (shtyrjet nga njëra seancë në tjetrën) ka qenë mbi 2 javë dhe disa raste edhe mbi 1 muaj, pa ndonjë shkak të arsyeshëm. Edhe në këtë rast caktimi i afateve nga njëra seancë në tjetrën, në disa raste edhe mbi 1 muaj, është bërë shkak për zgjatjen e gjykimit tej afatit të arsyeshëm.

➤ Lidhur me çështjen gjyqësore, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.5.2014

Data e regjistrimit të kësaj çështjeje është 16.4.2013 dhe ajo ka zgjatur tej afatit të arsyeshëm 6-mujor të përcaktuar në pikën 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Seanca përgatitore është caktuar në datën 15.5.2013 dhe më pas kalimi në seancë gjyqësore është caktuar më 24.6.2013. Përsëri caktimi i afateve nga njëra seancë në tjetrën edhe mbi 2 muaj (nga data 23.7.2013 – 11.10.2013) është bërë shkak për zgjatjen e gjykimit tej afatit të arsyeshëm.

#### **4. Përshkrimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short**

**Dosja 1** – Çështja civile nr. \*\*\* regj. themeltar, datë regjistrimi 3.11.2015, që i përket paditësit S.P., të paditur F.A., A.A. dhe K.A., me objekt “Detyrimi për kthimin e shumës 500,000 euro dhe detyrimin për pagimin e shpenzimeve gjyqësore”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.1.2016.

Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 3.11.2015 dhe sipas siglimit të Kryetarit të Gjykatës mbi kërkesëpadi i është caktuar gjyqtarës Blerina Muça në datën 4.11.2015.

Nga aktet e njoftimit të datës 9.11.2016 (5 ditë nga shorti) rezulton se seanca përgatitore është caktuar për në datën 27.11.2015, ora 13:15.

Nga aktet nuk rezulton që ndaj vendimit të jetë paraqitur ankim.

Gjyqtarja ka marrë masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Janë caktuar 4 seanca gjyqësore (1 përgatitore dhe 3 gjyqësore), të cilat kanë qenë produktive. Distanca kohore midis seancave ka qenë e arsyeshme, nga 5-18 ditë. Seancat gjyqësore nuk evidentohet nëse janë zhvilluar në sallë gjykimi apo zyrë dhe nuk janë regjistruar me audio, me përjashtim të seancës 3, e cila është zhvilluar në sallë gjykimi dhe mbajtur me regjistrim audio. Orari i fillimit të seancave gjyqësore është respektuar. Seanca për shpalljen e arsytuar të vendimit është shtyrë brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile.

Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk konstatohen të meta. Në dosje janë përfshirë rregullisht kërkesëpadi, vendimi i kalimit të çështjes për gjykim, aktet e njoftimit, procesverbali i seancave, akti i përfaqësimit, konkluzionet përfundimtare dhe vendimi gjyqësor. Aktet e prodhuara nga gjykata janë të rregullta nga ana formale. Procesverbali gjyqësor përmbush kriteret e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i nënshkruar rregullisht. Vendimet e ndërmjetme janë të arsytuara dhe përgjithësisht tregojnë shkakun ligjor. Dosja është e inventarizuar rregullisht dhe renditja e akteve nuk vështirëson përdorimin e saj.

Procesverbali gjyqësor tregon se komunikimi i subjektit të rivlerësimit, për sa i përket përbërjes së gjykatës, kërkesave paraprake dhe dhënies së fjalës palëve ndërgjyqëse ka qenë i qartë. Në dosje nuk ka të dhëna për komunikimet apo kërkimet e akteve apo provave me shkresa drejtuar institucioneve të treta. Gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosjeje është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e saj. Nuk ka të dhëna për kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës nga gjykimi i çështjes.

Vendimi përmban elementet e përcaktuara nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit si gjyqtarë e vetme. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

**Dosja 2** – Çështja civile nr. \*\*\* regj. themeltar, datë regjistrimi 7.3.2014, që i përket paditësit A.M., i paditur “\*\*\*\*” sh.a., me objekt padie “Dëmshpërblim nga marrëdhëniet e punës”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.6.2014.

Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 7.3.2014 dhe sipas siglimit të Kryetarit të Gjykatës mbi kërkesëpadi i është caktuar gjyqtarës Blerina Muça në datën 10.3.2014. Nga aktet e njoftimit të datës 13.3.2014 (3 ditë nga shorti) rezulton se seanca përgatitore është caktuar për në datën 26.3.2014, ora 14:00.

Kundër këtij vendimi është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.2.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 3.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Palët kanë ushtruar rekurs dhe sipas printimit të datës 1.10.2021 nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë çështja është ende në pritje për t'u gjykuar.

Gjyqtarja ka marrë masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Janë caktuar 7 seanca gjyqësore (1 përgatitore dhe 6 gjyqësore), nga të cilat 6 kanë qenë produktive. Pengesë në 1 seancë joproduktive ka qenë kërkesa për shtyrje e përfaqësueses së palës së paditur, pasi për shkaqe të arsyeshme të qenies njëkohësisht në disa gjyqe nuk mund të paraqitej në seancë. Distanca kohore midis seancave ka qenë e arsyeshme, nga 1-25 ditë. Vetëm 1 seancë gjyqësore është zhvilluar në sallë gjykimi e me regjistrim audio, ndërsa seancat e tjera gjyqësore nuk evidentohet nëse janë zhvilluar në sallë gjykimi apo zyrë dhe nuk janë regjistruar me audio. Orari i fillimit të seancave gjyqësore është respektuar. Seanca për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim është shtyrë brenda afatit 5-ditor parashikuar nga neni 302 i Kodit të Procedurës Civile, gjithashtu edhe seanca për shpalljen e arsyetuar të vendimit është shtyrë brenda afatit 5-ditor parashikuar nga neni 308/2 i këtij Kodi.

Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk konstatohen të meta. Në dosje janë përfshirë rregullisht kërkesëpadi dhe aktet provuese të saj, vendimi i kalimit të çështjes për gjykim, aktet e njoftimit, procesverbali i seancave, aktet e përfaqësimit, konkluzionet paraprake e ato përfundimtare dhe vendimi gjyqësor. Aktet e prodhuara nga gjykata janë të rregullta nga ana formale. Procesverbali gjyqësor përmbush kriteret e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i nënshkruar rregullisht. Vendimet e ndërmjetme janë të arsyetuara dhe përgjithësisht tregojnë shkaku ligjor. Nuk ka të dhëna për inventarizimin e dosjes, pasi aktet janë sjellë nga Gjykata e Lartë.

Procesverbali gjyqësor tregon se komunikimi i subjektit të rivlerësimit, për sa i përket përbërjes së gjykatës, kërkesave paraprake dhe dhënies së fjalës palëve ndërgjyqëse, ka qenë i qartë. Në dosje nuk ka të dhëna për komunikimet, kërkimet e akteve apo provave me shkresa drejtuar institucioneve të treta. Gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosjeje është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e saj. Nuk ka të dhëna për kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës nga gjykimin i çështjes.

Vendimi përmban elementet e përcaktuara nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit si gjyqtarë e vetme. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Në dispozitivin e vendimit gjykata është shprehur për pranimin e pjesëshëm të padisë dhe detyrimin e palës së paditur, rrëzimin e pjesës tjetër të objektit të padisë si të pabazuar në ligj për shpenzimet gjyqësore palëve në raport me pjesët e pranuar dhe të rrëzuara të padisë, si dhe tregohet e drejta e ankimit ndaj vendimit edhe për palët në mungesë.

**Dosja 3** – Çështja civile nr. \*\*\* regj. themeltar, datë regjistrimi 19.12.2014, që i përket paditëses E. T., i paditur \*\*\*-\*\*\*, me objekt padie “Dëmshpërblim nga marrëdhëniet e punës”, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.4.2015.

Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 19.12.2014 dhe sipas siglimit të Kryetarit të Gjykatës mbi kërkesëpadi i është caktuar gjyqtarës Blerina Muça në datën 22.12.2014. Nga aktet e njoftimit të datës 24.12.2014 (2 ditë nga shorti) rezulton se seanca përgatitore është caktuar për në datën 27.1.2015, ora 13:00.

Kundër vendimit është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.2.2016, ka vendosur moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për shqyrtimin e çështjes civile dhe dërgimin për gjykim në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Gjykata e Apelit Administrativ, me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.7.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\*, datë 30.4.2015; kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Rrethit Gjyqësor Tiranë, me arsyetimin se: *“Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka qenë kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e çështjes, pasi ligji ngarkon për këtë një gjykatë të veçantë gjykatën administrative”*.

Bazuar në vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ duket se subjekti ka gjykuar një çështje gjyqësore që nuk e kishte në kompetencën lëndore të saj.

Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit Blerina Muça në datën 15.5.2015, 15 ditë nga shpallja dhe jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjyqtarja ka marrë masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Janë caktuar 7 seanca gjyqësore (3 përgatitore dhe 4 gjyqësore), nga të cilat 5 kanë qenë produktive. Pengesë në 2 seanca joproductive ka qenë kërkesa për shtyrje e palës së paditur (1 seancë) dhe mospjesëmarrja e gjyqtarës për arsye shëndetësore (1 seancë). Distanca kohore midis seancave ka qenë e arsyeshme, nga 3-26 ditë. Seancat gjyqësore nuk evidentohet nëse janë zhvilluar në sallë gjykimi apo zyrë dhe nuk janë regjistruar me audio. Orari i fillimit të seancave gjyqësore është respektuar. Seanca për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim është shtyrë brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 302 i Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu edhe seanca për shpalljen e arsyetuar të vendimit është shtyrë brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile.

Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk konstatohen të meta. Në dosje janë përfshirë rregullisht kërkesëpadi dhe aktet provuese të saj, vendimi i kalimit të çështjes për gjykim, aktet e njoftimit, procesverbali i seancave, aktet e përfaqësimit, konkluzionet përfundimtare dhe vendimi gjyqësor. Aktet e prodhuara nga gjykata janë të rregullta nga ana formale. Procesverbali gjyqësor përmbush kriteret e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i nënshkruar rregullisht. Vendimet e ndërmjetme janë të arsyetuara dhe përgjithësisht tregojnë shkakun ligjor. Dosja është e inventarizuar rregullisht dhe renditja e akteve nuk vështirëson përdorimin e saj.

Vendimi përmban elementet e përcaktuara nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit si gjyqtarë e vetme. Në dispozitivin e vendimit gjykata është shprehur për pranimin e padisë dhe detyrimet e palës së paditur, rrëzimin e pjesës tjetër të objektit të padisë si të pabazuar në ligj për shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur, si dhe tregohet e drejta e ankimit ndaj vendimit edhe për palët në mungesë.

Për konstatimet e bëra për këtë çështje, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka sqaruar: *“Komisioni ka konstatuar me të drejtë se kundër vendimit është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.2.2016, ka vendosur moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin për gjykim në Gjykatën e Apelit Administrativ.*

Gjykata e Apelit Administrativ, me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.7.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\*, datë 30.4.2015 dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me arsyetimin se: “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka qenë kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e çështjes, pasi ligji ngarkon për këtë një gjykatë të veçantë, gjykatën administrative”. Mbi këtë bazë, konkludohet se: “...bazuar në vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ, duket se subjekti ka gjykuar një çështje gjyqësore që nuk e kishte në kompetencën lëndore të saj...”. Nga të dhënat e sistemit elektronik të gjykatës rezulton që kjo çështje është regjistruar në datën 19.12.2014, kohë në të cilën ka qenë në fuqi ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Neni 7 i këtij ligji përcaktonte në kompetencën lëndore të gjykatave administrative, ndër të tjera, edhe: “ç) Mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike”.

Në interpretim të kësaj dispozite dhe vendimit nr. 3, datë 6.12.2013, të KBGJL-së, në çështjen konkrete është vlerësuar se gjykata civile ka qenë kompetente nga pikëpamja lëndore, sepse marrëdhënia e punës në shqyrtim rregullohej nga Kodi i Punës; pala punëdhënëse nuk ishte organ i administratës publike, për shkak të natyrës së veprimtarisë së saj dhe varësisë nga Banka Islamike për Zhvillim.

Kërkesëpadia ka pasur për objekt zgjidhjen e pasojave të ardhura nga ndërprerja e menjëhershme dhe pa shkak të justifikuar të marrëdhënieve të punës prej punëdhënësit. Marrëdhënia e punës sipas përcaktimit në kontratën e punës rregullohej në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Në këtë logjikë, në asnjë rast nga palët dhe nga ana ime nuk është vlerësuar se konflikti përbënte mosmarrëveshje administrative, sikurse konkludon Gjykata e Apelit në vendimin e saj. Sigurisht, është në diskrecionin e gjykatave me të larta të vendosin për kompetencën lëndore apo themelin e çështjes, por nga ana ime, edhe për shkak se ndarja e kompetencës lëndore ishte ende e paqartë, çështja është gjykuar si konflikt i lindur nga marrëdhëniet e punës që rregulloheshin nga Kodi i Punës midis palëve të cilat nuk janë organe të administratës publike.

Lidhur me konstatimin se: “...Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari në datën 15.5.2015, pas 15 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile”, vlerësoj se kjo vonesë ka ardhur si pasojë, jo vetëm e ngarkesës në punë (për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 kam gjykuar gjithsej 1524 çështje gjyqësore, nga të cilat 1247 çështje civile, 662 të përgjithshme, 2 tregtare dhe 583 kërkesa civile, si dhe 257 çështje penale, nga të cilat 4 penale themeli, 3 kërkesa penale, 250 masa sigurimi), por edhe për shkak se data e dorëzimit të dosjes në Kryesekretari përfshin edhe periudhën administrative të zbardhjes së vendimit dhe përgatitjes së dosjes nga sekretarja gjyqësore, pas dorëzimit të vendimit të arsyetuar nga gjyqtari”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Rezultoi se në vendimin e subjektit për çështjen nr. \*\*\*, datë 30.4.2015, subjekti nuk i është referuar dhe nuk ka përmendur vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 6.12.2013, lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave të zakonshme civile për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kësaj natyre. Pra, subjekti ka ndjekur një çështje administrative pa përcaktuar kompetencën lëndore në referencë edhe të vendimit të Gjykatës së Lartë, e cila kishte dalë para vendimit të subjektit.



Seancat për këtë çështje janë zhvilluar ne intervalet 17.1.2015 – 18.2.2015, 9.3.2015 – 26.3.2015, 22.4.2015 – 27.4.2015. Në disa raste caktimi i seancave nga njëra te tjetra ka qenë më shumë se 15 ditë, gjë e cila ka sjellë edhe zgjatje të afatit të arsyeshëm të shqyrtimit të kësaj çështjeje.

**Dosja 4** – Çështja civile nr. \*\*\* regj. themeltar, datë regjistrimi 5.10.2012, që i përket paditës A.K., i paditur Sh.Sh etj., të përfaqësuar në gjykim nga Sh. Sh., me objekt padie “Kthimi i shumës prej 1 milion lekësh dhe penaltitetin prej 200,000 lekësh për shkak të mospërmbushjes së akt marrëveshjes datë 29.1.2010”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.11.2013.

Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 5.10.2012 dhe sipas siglimit të Kryetarit të Gjykatës mbi kërkesëpadi i është caktuar gjyqtarës Blerina Muça në datën 8.10.2012. Nga aktet e njoftimit të datës 10.10.2012 (2 ditë nga shorti) rezulton se seanca përgatitore është caktuar për në datën 12.11.2012, ora 14:00.

Mbi ankim, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.11.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 11.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Palët kanë ushtruar rekurs dhe sipas printimit të datës 4.10.2021 nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë çështja është ende në pritje për t’u gjykuar.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 1 vit e 3 ditë, në intervalin kohor 8.10.2012 – 11.11.2013. Kohëzgjatja e gjykimit është jashtë afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Gjyqtarja në përgjithësi ka marrë masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Janë caktuar 11 seanca gjyqësore (3 përgatitore dhe 8 gjyqësore), nga të cilat 9 kanë qenë produktive. Pengesë në 2 seanca joproductive ka qenë nevoja për kryerjen e pagesës për aktin e ekspertimit nga pala paditëse (1 seancë) dhe kërkesa e palëve për shtyrje për t’u njohur me aktin e ekspertimit (1 seancë). Distanca kohore midis seancave, për 6 prej tyre ka qenë e arsyeshme, nga 6-28 ditë, ndërsa për 5 seanca distanca kohore ka qenë nga 1 muaj e 4 ditë - 2 muaj e 17 ditë, çka ka çuar në gjykimin e çështjes jashtë afatit 6-mujor. Seancat gjyqësore nuk evidentohet nëse janë zhvilluar në sallë gjykimi, apo zyrë dhe nuk janë regjistruar me audio. Orari i fillimit të seancave gjyqësore është respektuar, me përjashtim të 3 seancave filluar me vonesë nga 10’ - 25’, të cilat kanë qenë për shkaqe objektive, qenie në gjykim tjetër apo zgjatja e gjykimit të mëparshëm dhe janë evidentuar shkaqet në procesverbalin gjyqësor. Seanca për paraqitjen për shpalljen e arsytuar të vendimit është shtyrë brenda afatit 5-ditor, të parashikuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile.

Në dosje janë përfshirë rregullisht kërkesëpadi dhe aktet provuese të saj, vendimi i kalimit të çështjes për gjykim, aktet e njoftimit, procesverbali i seancave, aktet e përfaqësimit, konkluzionet paraprake e ato përfundimtare dhe vendimi gjyqësor. Aktet e prodhuara nga gjykata janë të rregullta nga ana formale. Procesverbali gjyqësor përmbush kriteret e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i nënshkruar rregullisht. Vendimet e ndërmjetme janë të arsytuara dhe përgjithësisht tregojnë shkakun ligjor. Nuk ka të dhëna për inventarizimin e dosjes, pasi aktet janë sjellë nga Gjykata e Lartë.

Vendimi përmban elementet e përcaktuara nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit si gjyqtare e vetme. Në dispozitivin e vendimit gjykata është shprehur për pranimin e padisë dhe detyrimin e palës së paditur për kthimin e shumës dhe penaltitetit për shpenzimet gjyqësore e avokatore në ngarkim të të paditurve, si dhe tregohet e drejta e ankimit ndaj vendimit edhe për palët në mungesë.

Në përfundim të hetimit, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime për kohëzgjatjen e gjykimit dhe respektimin e afatit ligjor.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka sqaruar: “Çështja civile me nr. regj. them. \*\*\*, datë regjistrimi 5.10.2012, ka përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.11.2013, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.11.2014. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.2.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, e dhënë kjo e nxjerrë nga sistemi elektronik i gjykatës, të cilën po e depozitoj përpara jush. Konstatimi i Komisionit në raport se kohëzgjatja e gjykimit është jashtë afatit standard, është i drejtë, por dua të sqaroj se për këtë çështje kam nxjerrë të dhënat e sistemit për çdo seancë dhe në asnjë prej tyre nuk rezulton që shkak për shtyrjen të jetë bërë mungesa e paarsyeshme e gjyqtarit apo neglizhenca në punë. Të gjitha shtyrjet kanë qenë të arsyetuara dhe në respektim të përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile me kërkesë të palëve apo me qëllim sigurimin e provës me ekspert, me dëshmitarë etj., duke siguruar në këtë mënyrë kryerjen e një hetimi të plotë dhe zgjidhjen e drejtë dhe ligjore të çështjes, konfirmuar edhe nëpërmjet vendimmarrjes së shkallëve të tjera të gjykimit”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Për këtë çështje janë zhvilluar gjithsej 11 seanca gjyqësore dhe nëse nuk do të ishte neglizhuar caktimi i afërt i seancave nga njëra-tjetra kjo çështje do të kishte zgjatur brenda afatit prej 6 muajsh. Për 6 seanca gjyqësore, distanca kohore ka qenë 6 deri në 28 ditë dhe për 5 seanca gjyqësore distanca kohore ka qenë nga 1 muaj e 4 ditë - 2 muaj e 17 ditë. Caktimi i afatit nga njëra seancë në tjetrën pa shkaqe të arsyeshme është bërë shkak për zgjatjen e gjykimit tej afatit të arsyeshëm.

**Dosja 5** – Çështja penale (masë sigurimi) nr. \*\*\*, datë 14.9.2016, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Caktim mase sigurimi arrest në burg ndaj të dyshuarit K. Gj. për veprën penale Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal”, e përfunduar me vendimin nr. s’ka, datë 15.9.2016.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 14.9.2016 dhe i është caktuar subjektit të rivlerësimit Blerina Muça, e cila, në po të njëjtën datë, ka nisur shkresën drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Tiranë për shoqërimin e shtetasit në seancën gjyqësore të datës 15.9.2016, ora 11:30.

Nga aktet nuk rezulton që vendimi të jetë ankimuar.

Seanca gjyqësore nuk evidentohet nëse është zhvilluar në sallë gjykimi apo zyrë dhe nuk është mbajtur me sistem audio. Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga ana e gjyqtarës. Është caktuar 1 seancë të nesërmen e paraqitjes së kërkesës nga prokurori, duke e vënë çështjen në lëvizje pa vonesë. Kjo seancë ka qenë produktive.

Në dosje nuk ka vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndërsa akte të njoftimit për datën e seancës gjenden në dosje. Veprimet e kryera në seancën gjyqësore të mësipërme janë dokumentuar në procesverbalin përkatës, i cili është i rregullt nga pikëpamja formale, mbajtur sipas parashikimeve të nenit 345 të Kodit të Procedurës Penale, pasqyron orën e fillimit dhe përfundimit të seancës gjyqësore dhe është i firmosur rregullisht. Dosja është sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale penale, duke u bërë lehtësisht e shfrytëzueshme për palët.

Në procesverbalin gjyqësor në format letër konstatohet se komunikimi ka qenë korrekt, duke marrë parasysh kërkesat procedurale. Vihet re mbështetja e çdo veprimi procedural të kryer me bazën ligjore përkatëse sipas ligjit procedural penal. Gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosjeje është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e saj. Nuk ka të dhëna nëse ka pasur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit.

Vendimi gjyqësor është akt i hartuar nga subjekti i rivlerësimit Blerina Muça. Është vendim për caktimin e masës së sigurimit, me të cilin është vendosur masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale. Vendimi rezulton se është i strukturuar sipas elementeve të parashikuara në nenet 244 dhe 245 të Kodit të Procedurës Penale: pjesa hyrëse, përshkuese-arsyetuese dhe dispozitivi i gjykatës. Në përfundim, gjykata konkludon për pranimin e kërkesës së prokurorisë. Pjesa dispozitivi i gjykatës është i qartë dhe është rrjedhojë e analizës së kryer nga gjykata në pjesën përshkuese-arsyetuese. Është pranuar kërkesa dhe është caktuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”. Urdhërohet personi nën hetim të mos largohet nga banesa dhe të mos komunikojë me persona të tjerë, veç atyre që bashkëjetojnë me të, si dhe tregohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të kësaj të drejte.

## **5. Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së**

**5.1** Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtarja Blerina Muça është diplomuar në degën Drejtësi, me titull “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës, në datën 28.9.1993. Me vendim nr. \*\*\*, datë 28.12.1993, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Me vendim nr. \*\*\*, datë 6.3.1999, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me pëlqimin e saj është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrrojë detyrën.

**5.2** Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016” për gjyqtaren Blerina Muça janë paraqitur 13 ankesa (5 në vitin 2014, 6 në vitin 2015, 2 në vitin 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së. 8 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak, me arsyetimin se 4 prej tyre (2 të vitit 2014, 1 e vitit 2015 dhe 1 e vitit 2016) zgjidhen përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta, 3 prej tyre (1 e vitit 2014, 2 të vitit 2015) janë ankesa të përsëritura më parë, si dhe 1 ankesë e vitit 2015 arkivuar duke sugjeruar bashkimin me një ankesë tjetër, e cila i është dërguar për trajtim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. 5 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë:

- 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për zvarritje gjykimi, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional;
- 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për mosrespektim formal ligji, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje;
- 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për zvarritje gjykimi dhe shkelje etike, mbajtur në vijim verifikimi deri në përfundim të gjykimit në gjykatat më të larta, i është dërguar për trajtim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për shkelje etike dhe zvarritje gjykimi, mbajtur në vijim verifikimi deri në përfundim të gjykimit në gjykatat më të larta, i është dërguar për trajtim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- 1 ankesë e vitit 2016, sugjeruar verifikimi për mosrespektim formal ligji, i është dërguar për trajtim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

## **C/1. Përdorimi i mbiemrit**

**6.** Gjatë hetimit është konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, në periudha të ndryshme dhe në dokumente shkresore dhe zyrtare kanë përdorur mbiemra të ndryshëm nga mbiemri i regjistruar në gjendjen civile. Nga regjistri i gjendjes civile që nga periudha e martesës së subjektit rezulton se mbiemri zyrtar i saj dhe i bashkëshortit është Muço. Ndërkohë janë përdorur edhe mbiemra të ndryshëm në dokumentacione dhe shkresa zyrtare dhe private si Muça, Muçi dhe Muçaj. Në të gjitha vendimet gjyqësore dhe aktet gjyqësore, subjekti i rivlerësimit ka përdorur mbiemrin Muça.

**6.1** Për këtë çështje është pyetur subjekti i rivlerësimit, e cila ka deklaruar: *“Situata e krijuar me përdorimin e disa mbiemrave që ju citoni është absurde, por edhe rezultat i situatave faktike reale dhe jo pasojë e ndryshimeve formale. Në aktet e gjendjes civile nuk ka asnjë veprim për ndryshimin e mbiemrit, pra, formalisht, mbiemri sipas gjendjes civile i bashkëshortit është Muço, sikurse provohet me letërnjoftimin e datës 7.7.1989, kopje të të cilit gjeni bashkëlidhur. Çdo dokument me origjinë zyrtare si pasaporta, kartë identiteti, certifikata etj. kanë këtë mbiemër. Situata e mësipërme reflekton pakujdesi nga ana ime dhe e bashkëshortit, por edhe parregullsitë që kanë ekzistuar në regjistrat e gjendjes civile”.*

**6.2** Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të njëjtin mbiemër të regjistruar në gjendje civile që nga momenti i martesës është mbiemri Muço.

**6.3** Komisioni konstatoi se subjekti ka përdorur mbiemra të ndryshëm në vendime gjyqësore dhe praktika zyrtare, veprime këto që duket se cenojnë etikën e gjyqtarës për shkak të sjelljes jo në përputhje me rolin dhe figurën e një magjistrati. Në të gjitha vendimet gjyqësore subjekti ka përdorur mbiemrin Muça, të ndryshëm nga mbiemri zyrtar Muço.

**6.4** Për sa më sipër, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**6.5** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka sqaruar: *“Pavarësisht situatës aspak komode lidhur me këtë konstatim të drejtë, duhet të përsëris qëndrimin e mbajtur më parë, që është si në vijim: Situata e krijuar me përdorimin e disa mbiemrave që ju citoni është absurde, por edhe rezultat i situatave faktike reale dhe jo pasojë e ndryshimeve formale. Në aktet e gjendjes civile nuk ka asnjë veprim për ndryshimin e mbiemrit, pra formalisht, mbiemri sipas gjendjes civile i bashkëshortit është Muço, sikurse provohet me letërnjoftimin e datës 7.7.1989, kopje të të cilit gjeni bashkëlidhur. Çdo dokument me origjinë zyrtare si pasaporta, kartë identiteti, certifikata etj. kanë këtë mbiemër. Ndërkohë, që nga lindja, prej familjarëve është përdorur mbiemri Muçaj, i cili në fakt është mbiemri zyrtar i të gjithë familjarëve të tjerë të bashkëshortit, përfshirë xhaxhallarë, etj. Kjo situatë nënkupton pasaktësi në regjistrime në gjendjen civile, ku vetëm njëri prej vëllezërve, babai i bashkëshortit dhe trugu i tij familjar, janë me mbiemër Muço. Bashkëlidhur gjeni kopje të diplomës së universitetit, ku mbiemri rezulton Muçaj, si vazhdimësi e dokumentacionit shkollor, edhe pse letërnjoftimi është me mbiemrin Muço. Mbiemri Muçi është përdorur nga bashkëshorti në jetën publike, si rezultat i njohjes publikisht me këtë mbiemër, por nuk ka asnjë ndryshim formal dhe me këtë mbiemër nuk ka asnjë pasuri apo interes të regjistruar. Nga ana ime, menjëherë pas martesës është përdorur mbiemri Muçaj, i konceptuar si mbiemri zyrtar, sipas shpjegimeve të dhëna me sipër. Për shkak të një reference nga gjendja civile, që e gjeni bashkëlidhur, lëshuar në datën 22.9.2003, ku mbiemri pasqyrohet Muça, në vijim është përdorur kjo formë e mbiemrit në aktivitetin në gjykatë. Në dokumentacionin formal, mbiemri i familjes është Muço. Nuk ka asnjë lloj pasurie apo interes që të ekzistojë i regjistruar nga familjarët, përveç mbiemrit formal Muço. Situata e mësipërme reflekton pakujdesi nga ana ime dhe e bashkëshortit, por edhe parregullsitë që kanë ekzistuar në regjistrat e gjendjes civile. Do të kërkoja mirëkuptimin tuaj për ta vlerësuar këtë situatë në mënyrë objektive, si një pakujdesi e patolerueshme dhe e panevojshme, por që ka rezultuar si e tillë për shkak të mungesës së vëmendjes. Pavarësisht natyrës së shkëlqes, dua të ritheksoj se në asnjë rast kjo situatë e konstatuar nuk ka pasur qëllim fshehje veprimesh juridike apo akte të ndryshme lidhur me pasurinë apo element tjetër të paligjshëm. Është thjesht dhe vetëm një pakujdesi”.*

## Vlerësimi i Komisionit

**6.6** Komisioni nuk i konsideron bindëse shpjegimet e subjektit për përdorim e mbiemrit ndryshe nga mbiemri zyrtar i regjistruar në gjendjen civile, sidomos dhe kryesisht në vendimet gjyqësore të dhëna prej saj. Magjistrati duhet të tregojë përgjegjshmëri dhe shembull qytetarie si zbatues i ligjit dhe jo të kryejë veprime vetë me ndërgjegje në shkelje të ligjit, pasi kjo cenon besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Situata e krijuar nga përdorimi i mbiemrit në mënyrë të vazhdueshme me dijeni dhe ndërgjegje, e ndryshme nga ai zyrtar, është e paprecedentë në rastet e trajtuara në procesin e rivlerësimit kalimtar.

**6.7** Komisioni konstaton se subjekti, edhe pse jep shpjegime lidhur me këtë situatë absurde të përdorimit në dokumente zyrtare të mbiemrit Muça (i ndryshëm nga mbiemri zyrtar Muço), përsëri vazhdon me koshiencë përdorim e këtij mbiemri edhe në përgjigjet mbi rezultatet e hetimit.

**6.8** Komisioni konstaton se kjo sjellje e subjektit cenon etikën, rolin dhe figurën e një magjistrati. Ky vlerësim i Komisionit do të merret në konsideratë në qëndrimin përfundimtar, bazuar edhe në çështjet e tjera të evidentuara për subjektin e rivlerësimit.

## DENONCIME

**7.** Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur gjithsej 23 denoncime

**7.1 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2018, i shtetases A. K.** Denoncuesja është ankuar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit se gjyqtarja B. Muça nuk i ka dhënë vjetërsinë në punë që ka pasur në shoqëri, pasi është e kompromentuar në gjykimin e saj. Gjithashtu, sipas saj, gjyqtarja nuk është e kualifikuar dhe nuk kishte etikë komunikimi, si dhe zvarriste proceset gjyqësore. Denoncuesja ka cituar vendimin nr. \*\*\* (pa specifikuar vitin dhe pa paraqitur kopje në denoncimin e saj), pa cituar shkelje konkrete të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesja kërkon që të verifikohen edhe dosje të tjera e problematika të tjera që nuk kanë lidhje me zhvillimin e procesit gjyqësor ndaj saj. Në këto kushte, nuk mund të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit.

**7.2 Denoncim nr. \*\* prot., datë 25.5.2018, i shtetasit A.S.** Ky shtetas ka denoncuar gjyqtaren Blerina Muça për zvarritje në procesin gjyqësor dhe dhënie vendimi të padrejtë për shkak të shkeljeve procedurale dhe ato materiale. Janë zhvilluar 18 seanca gjyqësore dhe në asnjë prej tyre nuk është përmendur arsyeja që është zbardhur në vendim. Denoncuesi vazhdon duke thënë se gjyqtarja ka gjykuar me arrogancë e deri në ofendim ndaj tij. Ajo ka zhvilluar proces të parregullt ligjor, sepse deri në seancën e fundit, atë të shpalljes së vendimit, nuk ka bërë prezent një akt ligjor VKM, me të cilin palët duhej të ishin njohur më parë. Bashkëlidhur denoncimit gjendet vendimi nr. \*\*\*, datë 29.5.2017, ku denoncuesi është bashkëshorti i një prej paditësve, por për të sqaruar më mirë situatën rreth pretendimit të denoncuesit në lidhje me zhvillimin e 18 seancave gjyqësore, pa përmendur arsyet e shtyrjeve, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën<sup>40</sup> e vënies në dispozicion të procesverbaleve gjyqësore, si dhe informacion në lidhje me ecurinë e kësaj çështjeje në shkallët e tjera të gjyqësorit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kthyer përgjigje<sup>41</sup> duke dërguar kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 29.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtare B. Muça, me shënimet e Gjykatës së Apelit Tiranë, por duke qenë se dosja gjyqësore pas rekursit nga subjekti \*\*\* është dërguar në Gjykatën e Lartë, është në pamundësi objektive dërgimi i akteve të kërkuara nga dosja.

<sup>40</sup> Shihni kërkesën e Komisionit nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2023, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>41</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga shënimi i Gjykatës së Apelit evidentohet se vendimi i sipërcituar me gjyqtare Blerina Muça është prishur nga Gjykata e Apelit dhe është kthyer për rigjykim në të njëjtën gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

Sa më sipër, nisur nga fakti se vendimi i subjektit është prishur nga Gjykata e Apelit, Komisioni i kërkoj shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë denoncim, si dhe kthimin e çështjes së saj për rigjykim nga Gjykata e Apelit me një tjetër trup gjykues.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“Sa i përket pretendimit për zvarritje të gjykimit, në aktet e dosjes dhe në të dhënat e nxjerra nga sistemi elektronik i gjykatës, pasqyrohen të gjitha seancat e zhvilluara për këtë çështje, si dhe shkaqet e shtyrjes për secilën prej tyre. Gjithsej janë zhvilluar 27 seanca. Asnjë prej tyre nuk është shtyrë për mungesën apo neglizhencën e gjyqtarit. Gjenerali të pasqyruar në këto të dhëna të gjitha shkaqet procedurale, në mungesë të respektimit të të cilave do të ndodheshim përpara një gjykimi jo të rregullt ligjor. Në një pjesë të madhe të vendimeve për shtyrjen e seancave shkak kanë qenë kërkesat e palës paditëse për saktësim të objektit, pagimi i tarifës gjyqësore, mungesa e përfaqësuesit të kësaj pale apo refuzimi për të paguar shpërblimin për ekspertin. Për hetimin sa më të plotë të kësaj çështjeje, ka qenë e nevojshme kryerja e dy ekspertimeve, si provë në mbështetje të pretendimeve të palës paditëse. Marrja e kësaj prove në një proces civil kërkon detyrimisht kohën e nevojshme procedurale.*

*Pretendimet e denoncuesit për mungesë etike në zhvillimin e procesit janë tërësisht të pabazuara, sikurse do të konstatojë edhe nga të dhënat që po paraqes.*

*Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.11.2018, ka prishur vendimin, duke e kthyer çështjen për rigjykim, pasi ka bërë rivlerësimin e provave dhe fakteve të dala gjatë gjykimit në shkallë të parë, duke arritur në konkluzione të ndryshme, të cilat nuk mund të interpretohen nga ana ime, sa kohë që çështja aktualisht është për gjykim në Gjykatën e Lartë”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni vlerëson se për këtë çështje ka pasur zvarritje në procesin gjyqësor dhe vendimi është dhënë nga subjekti në shkeljeve të dispozitave procedurale dhe ato materiale. Nga vendimi i Gjykatës së Apelit evidentohet se vendimi i subjektit Blerina Muça është prishur nga Gjykata e Apelit (kthyer për rigjykim në të njëjtën gjykatë, por me tjetër trup gjykues), duke konstatuar shkelje të rënda në procesin gjyqësor<sup>42</sup>.

Për këtë çështje janë zhvilluar 27 seanca gjithsej dhe çështja gjyqësore duket se ka zgjatur 1 vit e 6 muaj. Nga prapësimet e subjektit nuk konstatohet kur është regjistruar kjo çështje civile në gjykatë. Seanca përgatitore rezultoi se është caktuar në datën 3.12.2015. Seanca e datës 9.2.2016 nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së palës së paditur dhe seanca e radhës është caktuar në datën 2.3.2016. Caktimi i seancave (shtyrjet nga njëra seancë në tjetrën) ka qenë mbi 2 javë dhe disa raste edhe mbi 1 muaj, pa ndonjë shkak të arsyeshëm. Caktimi i afateve nga njëra seancë në tjetrën, në disa raste edhe mbi 1 muaj, është bërë shkak për zgjatjen e gjykimit tej afatit të arsyeshëm.

**7.3 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 2.7.2019, i shtetas H.K.** Denoncuesja ankohet për shumë subjekte të tjera, ndër to edhe subjekti i rivlerësimit, duke denoncuar një “odise dhjetëvjeçare korrupsioni të drejtësisë”. Shtetasja H.K rendit disa procese civile dhe penale të zhvilluara në gjykatat shqiptare, ku sipas saj është shmangur marrja e masave ndëshkuese ndaj shkelësve të

<sup>42</sup> Shihni vendimin nr. \*\*\*, datë 26.11. 2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në dosjen e Komisionit.

ligjit. Sipas saj janë kryer akte të parregullta ligjore dhe janë përdorur dokumente të falsifikuara nga ana e autoriteteve gjyqësore shqiptare.

Shtetasja H. K., krahas shumë dokumenteve dhe vendimeve gjyqësore, ka sjellë edhe vendimin nr. \*\*\*, datë 9.12.2008, ku anëtare e trupit gjykues është edhe gjyqtare Blerina Muça. Në këtë vendim denoncuesja është në cilësinë e palës së paditur nga nipi i saj T. K. Në këtë proces civil, me objekt “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të testamentit dhe deklarimin e pavlefshëm të 24 kontratave të dhurimit”, hartuar nga i ndjeri Xh.K. (babai i denoncueses) në favor të së paditurës H. K. dhe fshirjen e tyre nga ZVRPP-ja Durrës, trupa gjykuese ka pranuar kërkesëpadinë e palës paditëse dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.2.2010, ka lënë në fuqi këtë vendim. Nga studimi i këtij vendimi nuk konkretizohet ndonjë nga pretendimet e denoncueses në lidhje me ndonjë shkelje të mundshme nga ana e subjekteve të cilët kanë qenë gjyqtarë në këtë proces, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit Blerina Muça. Në këto kushte, nuk mund të hetohet më tej për këtë denoncim.

**7.4 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2017, i shtetasit L.A.Ll.** Ky shtetas ka denoncuar gjyqtaren Blerina Muça se ka zhvilluar procesin gjyqësor pa dijeninë e tyre dhe se nuk i ka thërritur ata asnjëherë që nga muaji shtator 2012 deri më 23.12.2013. Denoncuesi vazhdon duke thënë se gjyqtarja është e korruptuar, ka zhvilluar një proces në shkelje me ligjin.

Bashkëlidhur denoncimit gjendet vendimi nr. \*\*\*, datë 23.12.2013, ku denoncuesi është një prej të paditurve në proces dhe ku gjykata, me kryesuese subjektin e rivlerësimit, ka pranuar kërkesëpadinë e paraqitur nga shtetasi A. G. Duke parë arsyetimin e këtij vendimi, ky proces gjyqësor duket të ketë filluar që në vitin 1997 nga anëtarët e familjes G, të cilëve pasi u është njohur prona nga AKKP-ja i janë drejtuar Gjykatës me kërkesën me objekt “Lirim dhe dorëzim trualli dhe pushim cenimi të pronësisë për punimet mbi katin e parë nga familjet Ll dhe D”. Gjykata iu ka dhënë të drejtë duke përcaktuar detyrimet e të paditurve. Por, nga ankimet në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Lartë, si dhe pushimet e herëpashershme, ky proces gjyqësor ka rifilluar pas shumë viteve, dhe pikërisht në vitin 2004, vit kur pjesë e trupës gjykuese bëhet edhe gjyqtarja Blerina Muça, ku në seancën e datës 14.11.2012 vendoset vazhdimi i gjykimit me kryesuese subjektin e rivlerësimit.

Duke konsideruar pretendimin e denoncuesit në lidhje me mosthirrjen e palës së paditur dhe zhvillimin e procesit gjyqësor pa dijeninë e palës së paditur, nga arsyetimi i vendimit duket se gjykata ka vendosur njoftimin e palës së paditur me shpallje publike, për shkak të kërkesave të vazhdueshme për shtyrje dhe problematikave të hasura në njoftimin e të paditurve për çdo seancë.

Pavarësisht faktit të njoftimit me shpallje publike, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime lidhur me hapat procedurale të ndjekur për njoftimin e palëve, si dhe zhvillimin e këtij procesi gjyqësor në mungesë të palëve.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: “Vendimi nr. \*\*\* është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.12.2014. Mbi rekursin e paraqitur nga i padituri L.Ll, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.6.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit.

*Një nga problematikat kryesore të kësaj çështjeje ka qenë zvarritja e procesit gjyqësor nga të paditurit, një prej të cilëve edhe denoncuesi në fjalë, që e ka çuar gjykimin përtej afateve procedurale standarde. Për shkak të tejgjatjes së këtij gjykimi në shkallë të parë, kam vlerësuar që në pjesën arsyetuese të vendimit të pasqyroj kronologjikisht ecurinë e procesit, si dhe të gjitha veprimet procedurale që janë kryer nga gjyqtarët e tjerë, para se çështja të kalonte për shqyrtim pranë meje si gjyqtare kryesuese në vitin 2010, në gjendje të pezulluar. Në vendim analizohet gjithashtu situata që ka determinuar qëndrimin e trupit gjykues për realizimin e njoftimit të të*

*paditurve me shpallje publike, bazuar në parashikimet e neneve 128 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Gjatë gjykimit ka rezultuar se në adresën zyrtare të banimit të paditurit nuk merrnin njoftim, duke u bërë shkak i vazhdueshëm për zvarritjen e procesit, arsye kjo e nevojshme dhe e mjaftueshme për t'iu referuar nenit 131 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me njoftimin me shpallje publike të palës. Ky njoftim përbën njoftim të rregullt procedural për vijimin e gjykimit në mungesë të palës. Edhe ky veprim procedural i trupit gjykues, të kryesuar prej meje, është konfirmuar nga gjykatat më të larta si i mbështetur në përcaktimet specifike të Kodit të Procedurës Civile dhe në aktet e administruara në fashikullin gjyqësor”.*

## **Vlerësimi i Komisionit**

Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, lënë për këtë çështje nga Komisioni, përveç shpjegimeve ka paraqitur si provë vetëm 2 fletë, ku konstatohet se vendimi i subjektit është lënë në fuqi nga gjykatat më të larta. Nga ana e subjektit nuk është paraqitur dokumentacion tjetër plotësues, që do mundësonte Komisionin të vlerësonte qëndrimet e subjektit gjatë seancave gjyqësore për këtë çështje dhe ecurinë e gjatë të këtij procesi gjyqësor (filluar nga subjekti që në vitin 2004). Sa më sipër, subjekti nuk ka paraqitur prova për të kundërshtuar gjetjet e Komisionit për këtë çështje.

**7.5 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2019, i shtetasit B.K.** Ky shtetas ka denoncuar shumë subjekte të tjera, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, për shkelje të rënda ligjore në proces gjykimi, duke mos marrë për bazë faktet dhe duke cenuar të drejtën e tij. Denoncuesi vazhdon duke thënë se nëpërmjet korrupsionit i kanë marrë dy banesa pa firmën dhe pa dijeninë e tij. Bashkëlidhur denoncuesi ka sjellë një sërë dokumentesh të pronave-dy apartamenteve, objekt ankimi në gjykatë, ndër to edhe vendimin nr. \*\*\*, datë 6.7.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtarë R. P., M. Sh. dhe R. M. Këto tre gjyqtarë kanë rrëzuar kërkesëpadinë e denoncuesit në cilësinë e paditësit. Gjithashtu, bashkëlidhur gjendet edhe vendimi nr. \*\*\*, datë 22.9.2016, i Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e sipërcituar. Përveçse në formularin e denoncimit, ku denoncuesi krahas shumë emrave të subjekteve përmend edhe emrin e gjyqtarës Blerina Muça, në asnjë dokument apo vendim tjetër nuk përmendet emri i subjektit të rivlerësimit e, për këtë arsye, nuk mund të hetohet më tej.

**7.6 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 15.12.2019, i shtetasit H.A.** Ky shtetas ka denoncuar shumë subjekte të tjera, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, për korrupsion, siç edhe e citon në formularin e denoncimit të publikut, por nuk formulon një ankesë konkrete ndaj saj. Bashkëlidhur shtetasi H.A ka sjellë kopje të dokumentacionit ligjor, si vijon: dëshmi trashëgimie; kontratë dhurimi; vërtetim pronësie; testament dhe vendim nr. \*\*\*, datë 5.2.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në dispozitivin e këtij vendimi thuhet se Gjykata vendosi prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 3.11.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues. Në këtë proces gjyqësor denoncuesi duket se ka qenë në cilësinë e paditësit dhe i kundërpaditur, si dhe, sipas dispozitivit të këtij vendimi, gjykata ka pranuar kërkesëpadinë e ngritur prej tij. Pas kthimit për rigjykim pranë gjykatës së shkallës së parë, çështja është shortuar duke u caktuar subjekti i rivlerësimit si gjyqtar i kësaj çështjeje.

Lidhur me këtë denoncim, Komisioni iu drejtua ILD-së, e cila, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2023, ka kthyer përgjigje. Krahas vendimeve të tjera për ankesat ndaj subjektit të rivlerësimit, Komisioni analizoi edhe dy vendimet e ILD-së në lidhje me ankesat e përsëritura të shtetasit H.A.

Në lidhje me ankesën e parë të këtij shtetasi (datë 22.10.2015) është vendosur arkivimi i saj<sup>43</sup>, me argumentimin se fakti i pretenduar si shkelje nga gjyqtarja B. Muça (zvarritja e gjykimit civil nga regjistrimi i çështjes në gjykatë në datën 7.4.2010 dhe deri në përjashtimin e saj nga gjykimi datë

<sup>43</sup> Shihni vendimin e ILD-së nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2022.



22.4.2016) është jashtë afatit 5-vjeçar të parashkrimit, referuar nenit 117 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se shkeljet disiplinore parashkruhen brenda 5 vjetëve.

Ndërsa, për ankesën e datës 23.4.2022, ILD-ja ka vendosur<sup>44</sup> verifikimin e saj. Nga praktika e administruar rezulton se subjekti i rivlerësimit ka ndjekur çështjen civile nr. \*\*\* akti, datë 7.4.2010. Kjo çështje duket se është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit deri në datën 22.4.2016, pasi subjekti është përjashtuar nga gjykimi i kësaj çështjeje. Në vendimin për përjashtimin e subjektit, gjyqtari K. G. ka arsyetuar se: *“Gjykata, si shqyrtoi dosjen civile nr. \*\*\* regj. them., datë 7.4.2010, në vështrim të parashikimeve të bëra në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile ...kërkesa e përjashtimit duhet pranuar për të ruajtur objektivitetin e gjykimit, si dhe për të shmangur zvarritjen e këtij gjykimi në të ardhmen”*. Në dispozitivin e vendimit, ILD-ja ka vendosur verifikimin e ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi H.A ndaj magjistratit D.C. dhe marrjen e të dhënave shtesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke kërkuar informacion mbi ecurinë e gjykimit të çështjes civile nr. \*\*\*, datë 7.4.2010, me paditës të kundërpaditur shtetasin H.A e të paditur H.A, çështje e cila i është shortuar gjyqtarit D. C. në gusht të vitit 2016.

Pra, subjekti i rivlerësimit ka shkelur afatet ligjore për një proces të rregullt gjyqësor, duke gjykuar këtë çështje nga data 7.4.2010 deri më 22.4.2016 (çështja ka zgjatur mbi 6 vjet, duke mos respektuar standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së).

Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“Kjo çështje është gjykuar prej saj nga data 7.4.2010 deri në datën 22.4.2016, pasi ishte kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.2.2010, duke pasur si pjesë të gjykimit padi dhe kundërpadi.*

*Në seancën e datës 14.2.2011 është vendosur pezullimi i gjykimit, deri në përfundim të gjykimit të çështjes civile të themelit, nga e cila varej zgjidhja e mosmarrëveshjes. Në seancën e verifikimit të shkakut të pezullimit, datë 28.6.2013, zhvilluar vetëm në prani të paditësit, është konstatuar se çështja e themelit kishte përfunduar në Gjykatën e Apelit Tiranë, sipas vendimit të paraqitur nga paditësi dhe mbi këtë bazë, është rifilluar procesi në fazën ku kishte mbetur. Pas problematikave vijuese në drejtim të njoftimit të palës së paditur kundërpaditëse, në seancën gjyqësore të datës 22.11.2013 është vendosur të pushohet kundërpadia dhe të vijohet me shqyrtimin e padisë së paditësit H.A , duke u thirrur dhe ekspert. Vetëm në seancën e datës 28.1.2014 është paraqitur përfaqësuesi i një prej të paditurve, i cili ka kërkuar ripezullimin e gjykimit, pasi ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit, mbi të cilin u vendos shpezullimi i çështjes në seancën e datës 28.6.2013, ishte ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, duke paraqitur edhe provën mbështetëse për këtë fakt. Ndodhur përpara së njëjtës situatë me atë të vendimit të pezullimit të mëparshëm (seanca e datës 14.2.2011), si dhe në kushtet kur çështja e themelit provohej se nuk kishte përfunduar së gjykuari në të tria shkallët e gjykimit, në bazë të nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile është vendosur ripezullimi i gjykimit. Me përfundimin e shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, u rifillua gjykimi. Përfaqësuesi i një prej të paditurve ka vijuar me paraqitjen e disa kërkesave procedurale, të cilat janë rrëzuar me vendim të ndërmjetëm të arsyetuar. Në seancën e datës 10.2.2016, nga kjo palë u paraqit kërkesë për përjashtimin tim nga gjykimi, kërkesë e cila është pranuar nga gjyqtari K. G., me arsyetimin: “Gjykata, si shqyrtoi dosjen civile me nr. \*\*\* akti, datë 7.4.2010, në vështrim*

<sup>44</sup> Shihni vendimin e ILD-së nr. \*\*\* prot., datë 9.5.2022.

*të parashikimeve të bëra në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, konstaton se gjyqtari nuk ka treguar njëanshmëri, por meqenëse pala kërkuese ka humbur besimin, duke shfaqur dyshime në lidhje me gjykimin e çështjes (për më tepër kur kërkuesi insiston me një kërkesë të tillë), çmon se kërkesa e përjashtimit duhet pranuar për të ruajtur objektivitetin e gjykimin, si dhe për të shmangur zvarritjen e këtij gjykimi në të ardhmen.*

*Nga të dhënat e nxjerra nga sistemi elektronik i gjykatës rezulton që çështja është përfunduar me vendimin nr. \*\*\*/2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (gjyqtari D.C.) dhe aktualisht rezulton me status ankimuar.*

*Sikurse do të konstatooni në të dhënat e nxjerra nga sistemi, asnjë seancë nuk është shtyrë për shkak të gjyqtarit. Një pjesë e tyre është shtyrë për shkaqe procedurale dhe një pjesë me kërkesë të palëve. Çështja, për më shumë se 36 muaj, ka qenë e pezulluar dhe kjo periudhë nuk mund të konsiderohet si zgjatje e afatit të gjykimin. Gjatë periudhës që çështja ka qenë në gjykim pranë meje, është mundësuar edhe marrja e provës me ekspert, e cila, për vetë natyrën e saj, kërkon kohën e nevojshme procedurale. Nga ana ime për këtë çështje, sikurse edhe çdo çështje tjetër, janë bërë përpjekjet maksimale për realizimin e një procesi të rregullt ligjor, në përputhje me përcaktimet procedurale civile”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka shkelur afatet ligjore për një proces të rregullt gjyqësor, duke gjykuar këtë çështje nga data 7.4.2010 deri më 22.4.2016. Çështja ka zgjatur mbi 6 vjet, duke mos respektuar standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Çështja është regjistruar në datën 7.4.2010. Seanca përgatitore është caktuar në datën 27.9.2010, pas 5 muajve, pa u dhënë arsye se përse është shtyrë kjo seancë për 5 muaj.

Seanca e radhës është shtyrë pas 4 muajve, në datën 4.2.2011, me kërkesë të përfaqësuesit të palës së paditur. Më tej, në datën 14.2.2011, çështja është pezulluar deri në përfundim të çështjes civile të themelit nr. \*\*\*, datë 14.12.2009, e cila varej nga gjykimi i mëtejshëm i kësaj çështjeje (sipas të dhënave në procesverbal).

Vërehet se edhe pse vendimi gjyqësor i çështjes së themelit, e cila u bë shkak për pezullimin e këtij procesi, kishte përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.10.2012, gjykata është vënë në lëvizje pas 8 muajve, për të revokuar vendimin e pezullimit, dhe konkretisht në datën 28.6.2013 (sipas të dhënave në procesverbalin e depozituar nga subjekti).

Vërehet se për të arritur në zhvillimin e seancës përgatitore, subjekti rezulton në tri seanca me shtyrje/afate kohore tepër të gjata, të cilat në raport me arsyen e shtyrjes për njoftim palësh apo depozitim të vendimit gjyqësor, për të cilën çështja ishte pezulluar, mbeten tërësisht të pajustificuara. Në të tilla kushte, Komisioni konstaton se minimalisht në zhvillimin e këtij procesi gjyqësor për 5 vite nga subjekti i rivlerësimit, 17 muaj mbeten të pajustificuar, çka përbën fakt se subjekti ka shkelur afatet, duke mos respektuar standardin për një proces të rregullt ligjor.

### **7.7 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2019, i shtetasit V.Xh**

Ky shtetas është ankuar për subjektin e rivlerësimit në lidhje me padinë e paraqitur nga ana e tij në cilësinë e paditësit, të regjistruar në datën 3.4.2019, me gjyqtare Blerina Muça. Padia e tij kishte për objekt “Pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. \*\*\*, datë 9.10.1995 të ish-KKKP-së, Bashkia Tiranë. Fshirjen e këtij vendimi nga regjistri hipotekor nr. \*\*\*, datë 24.10.1995”. Gjyqtarja ka zhvilluar 4 seanca paraprake në dhomë këshillimi. Gjatë këtyre seancave ka paraqitur “Deklaratë mbrojtjeje” njëri prej të paditurve, konkretisht \*\*\*-ja, ndërsa për të paditurin e tjerë gjykata ka

konstatuar se adresat nuk ishin të sakta dhe për këtë mori vendim “Për plotësimin e të metave”. Ankuesi i ka plotësuar brenda afatit këto të meta.

Në pritje të caktimit të seancës të radhës, paditësi merr dijeni se gjykata kishte vendosur “Kthimin e padisë së paditësit V. Xh si padi me të meta”. Shkresa e protokolluar për shkak të “ngatërresës” së bërë në sekretarinë e gjykatës i kishte shkuar një gjyqtareje tjetër, znj. R. P. dhe jo gjyqtares së adresuar, Blerina Muça. Duke e konsideruar këtë gabim njerëzor, pala paditëse ka ridepozituar përsëri padinë me provat bashkëngjitur dhe në datën 30.5.2019 është reregjistruar kjo padi. Por në datën 19.7.2019 gjyqtarja ka caktuar seancë dhe është thirrur vetëm pala paditëse, me arsyetimin se: *“Gjykata, pasi e vlerëson këtë moment procedural tepër të rëndësishëm për fillimin e gjithë fazës së shqyrtimit të një padie, konstaton se kërkesat e bëra nga pala paditëse në vijimësi, deri në momentin e sotëm, janë kërkesa që tregojnë qartazi të metat e padisë fillestare të datës 29.5.2019. Ndërkohë, këto të meta janë të një natyre, të cilat nuk mund të rregullohen në veprime paraprake, nisur nga përcaktimet e neneve 158, 158/a të Kodit të Procedurës Civile...etj”*. Në këto kushte, gjykata, duke u bazuar në nenin 154 të Kodit të Procedurës Civile, i ka kthyer padinë paditësit V.Xh.

Sa më sipër, ankuesi/paditësi pretendon se është penguar nga gjykata, duke i mohuar të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e drejtë dhe e paanshme.

Bashkëlidhur, ankuesi ka sjellë detaje të çështjes civile nr. \*\*\*, ku paditës është V. Xh., por ka sjellë edhe detaje të çështjes civile nr. \*\*\*, ku ankuesi V. Xh. është në cilësinë e të paditurit dhe për të cilin nga ana e ankuesit ishte bërë kërkesë për pezullim të procesit. Pra, ankuesi dyshon se kjo situatë e krijuar nga gjykata është bërë për të penguar kërkesën e tij për pezullim procesi.

Gjykata, në arsyetimin e saj, në referim të nenit 158/b, ka thirrur vetëm palën paditëse në seancë, ku dhe ka vendosur kthimin e padisë si padi me të meta, në ndryshim me vendimin e datës 21.5.2019 (ku ka kthyer padinë si padi me të meta pa praninë e palës paditëse).

Për këtë situatë të krijuar nga Gjykata duket se subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar një proces gjyqësor në shkëlqje të standardeve procedurale formale, si dhe mohime të të drejtave të palëve në proces.

Sa më sipër, iu kërkua subjektit të rivlerësimit të jepte shpjegime në rezultatet e hetimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Në datën 3.4.2019 është regjistruar në gjykatë çështja me nr. \*\*\* regjistri themeltar, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.5.2019 “Kthim padie me të meta”. Sikurse konstatohet edhe në pjesën arsyetuese, ky vendim është marrë konform përcaktimeve të neneve 154 dhe 158 të Kodit të Procedurës Civile, çka nënkupton se gjykimi ende nuk kishte filluar dhe çështja ka qenë në fazën e veprimeve paraprake të gjyqtarit. Në momentin e njohjes me padinë, pas konstatimit të të metave formale të vlerësuar të riparueshme me vendimin përkatës, palës paditëse i është caktuar afat për plotësimin dhe rregullimin e tyre, me qëllim vijimin e veprimeve të mëtejshme paraprake. Në kushtet kur brenda këtij afati pala paditëse nuk i plotësoi të metat e konstatuara, u vijua me vendimmarrjen e kthimit të padisë pa veprime, si padi me të meta, konform përcaktimeve respektive procedurale (nenet 154, 154/a dhe 158 të Kodit të Procedurës Civile).*

*Pala paditëse nuk ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi, sikurse konstatohet edhe në të dhënat e nxjerra nga sistemi elektronik i gjykatës, të cilin po e depozitoj për vlerësim nga ana juaj.*

*Në datën 30.5.2019, z. V. Xh ka paraqitur në gjykatë një kërkesëpadi të re, të njëjtë me atë të datës 3.4.2019, me ndryshimin e vetëm në ndërgjyqësi: trashëgimtarët e O.B, nga të paditur në padinë e parë, janë thirrur në cilësinë e personave të tretë në padinë e dytë. Nga ana ime për këtë padi është konkluduar në kthimin e saj me të meta, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.7.2019. Edhe në këtë*

*rast, sikurse cilësohet në pjesën hyrëse të vendimit, padia është vlerësuar me të meta thelbësore në fazën e veprimeve paraprake, pa u kaluar në seancë përgatitore.*

*Të dyja vendimet objekt denoncimi janë të ankimueshme në Gjykatën e Apelit, të drejtë të cilën pala paditëse nuk e ka ushtruar, sikurse provohet nga të dhënat e nxjerra nga sistemi elektronik i gjykatës”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Ky shtetas është ankuar për subjektin e rivlerësimit në lidhje me padinë e paraqitur nga ana e tij, në cilësinë e paditësit, të regjistruar në datën 3.4.2019.

Për këtë çështje nuk u konstatuan problematika.

### **7.8 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2022, i shtetasit A.H**

Denoncuesi është ankuar pranë Komisionit për gjyqtaren Blerina Muça, e cila ka trajtuar çështjen e largimit të tij nga puna në Policinë Bashkiake. Gjyqtarja, sipas tij, ka zgjatur tri vite gjykimin e padisë dhe vendimi i është dorëzuar dy muaj pasi është dhënë.

Gjyqtarja në vendimin përkatës ka krijuar motiv të ri të largimit nga puna, atë të ndryshimit të dokumentit administrativ, fletës së bllokut të gjobave të kolegut të tij, i cili, sipas denoncuesit, ndonëse ishte ai shkelësi, u pyet si dëshmitar.

Bashkëlidhur denoncuesi A. H ka sjellë: kontratë pune; shkresë kthim përgjigjeje nga Policia Bashkiake, certifikatë familjare; kontratë kredie bankare; vërtetim të Policisë Bashkiake se nuk ka masë disiplinore në fuqi; procesverbale konstatime shkeljeje; dokumentacion të Policisë Bashkiake për largimin nga puna të denoncuesit; vendim nr. \*\*\*, datë 28.3.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtare Blerina Muça.

Në këtë vendim, denoncuesi ka kërkuar konstatimin gjyqësisht të zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi pa shkaqe të justifikuara dhe në mënyrë të menjëhershme referuar dispozitave të Kodit të Punës. Gjykata ka arsyetuar se moskryerja e rregullt e detyrave të ngarkuara dhe shkelja e detyrimeve kontraktore nga punëmarrësi A. H. ka çuar në cenimin e parimit të mirëbesimit, që duhet të ekzistojë mes palëve në një kontratë pune, duke kushtëzuar në këtë mënyrë punëdhënësin në marrjen e masës disiplinore të largimit nga puna të paditësit.

Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit duket ta ketë arsyetuar vendimin duke iu referuar fakteve e rrethanave me vërtetësi, duke marrë në pyetje edhe dëshmitarët e mundshëm në proces.

Por, duke parë kohëzgjatjen nga dita e regjistrimit të çështjes deri në përfundimin e saj (rreth 2 vite e gjysmë), si dhe pretendimin e ankuesit në lidhje me kohëzgjatjen për arsyetimin e vendimit (2 muaj), subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Çështja civile me nr.\*\*\* regj., datë 17.10.2019, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.3.2022 - nuk është ushtruar ankim nga palët. Konstatimi i Komisionit për kohëzgjatjen e gjykimit është i drejtë. Një nga shkaqet kryesore të gjykimeve tej afateve standarde është numri i lartë i çështjeve. Ky fakt e bën objektivisht të pamundur marrjen në shqyrtim të kërkesëpadisë që në momentin e depozitimit të saj. Për më tepër, si pasojë e ndryshimeve që Kodi i Procedurës Civile pësoi me ligjin nr. 38/2017, gjyqtari është i detyruar që në momentin e njohjes me kërkesëpadinë të urdhërojë kryerjen e veprimeve paraprake për çështjen, në afatet e përcaktuara në nenin 158 të këtij Kodi, periudhë e cila nuk përlllogaritet në kohëzgjatjen e gjykimit. Në lidhje me çështjen në fjalë, nga të dhënat e nxjerra nga sistemi, rezulton që seanca e parë përgatitore është zhvilluar në datën 10.2.2020, ku është urdhëruar dhe kalimi i çështjes në seancë gjyqësore, në datën 25.3.2020. Seanca e kësaj date, së bashku me seancën e datës 6.11.2020, nuk janë zhvilluar, për shkak të*

efekteve të aktit normativ nr. 9, datë 25.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”. Seancat e datave 10.9.2020, 15.2.2021 dhe 23.11.2021 nuk janë zhvilluar për arsye objektive të gjyqtarës (raport, leje vjetore, leje nga kryetari i gjykatës), shoqëruar me provën përkatëse në mbështetje të shkaktuar. Seanca e datës 21.3.2022 nuk është zhvilluar për shkak të VKM-së, datë 18.3.2022, për caktimin e datës 21.3.2022 ditë pushimi. Ndërkohë, 5 seancat e tjera janë zhvilluar dhe janë shtyrë për shkaqe procedurale të pasqyruara në të dhënat e nxjerra nga sistemi i gjykatës, në kuadër të realizimit të një procesi të rregullt ligjor dhe kryerjes së një hetimi sa më të plotë.

Saktësoj se pas verifikimit të të dhënave të librit të dorëzimit të dosjeve nga sekretarja gjyqësore në kryesekretarinë e gjykatës, rezulton se arsyetimi i vendimit ka zgjatur nga data 28.3.2022 – 9.5.2022 (data e dorëzimit të dosjes në kryesekretari), pra 43 ditë, nga afati procedural 20 ditë nga dita e shpalljes. Në këtë periudhë përfshihet edhe koha që i nevojitet sekretares gjyqësore për përgatitjen e dosjes për dorëzim. Nga momenti i dorëzimit të dosjes, kryesekretaria brenda kompetencave ka kryer edhe komunikimin e vendimit të arsyetuar palës denoncuese. Volumi i madh i çështjeve në gjykim, kryesisht për periudhën 2019 e në vijim, ka ndikuar në shtyrjen e afateve të gjykimeve dhe të arsyetimit në kohë të vendimeve”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Subjekti i rivlerësimit pranon vonesën në gjykim, duke shpjeguar se ka pasur numër të lartë të çështjeve. Për Komisionin, afati prej 2 vitesh e gjysmë është tej çdo standardi të arsyeshëm, duke sjellë pasoja dhe dëm për palën. Konstatohet se afati i shtyrjes së seancave në vetvete është i pashpjegueshëm dhe i pambështetur në prova apo shkaqe të arsyeshme. Më konkretisht, subjekti ka shtyrë seancën nga data 10.9.2020, pas 5 muajve, në datën 15.2.2021 dhe, po ashtu, nga 15.2.2021, pas 9 muajve, deri më 23.11.2021.

Gjithashtu, Komisioni konstatoi vonesa të paarsyeshme të subjektit në arsyetimin e vendimit (43 ditë, nga afati procedural 20 ditë nga dita e shpalljes). Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shkelur afatet, duke mos respektuar standardin për një proces të rregullt ligjor.

### **7.9 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2018, i shtetasit Q.T**

Denoncuesi është ankuar pranë Komisionit për gjyqtaren Blerina Muça, sepse ajo është shprehur në mënyrë të gabuar, në kundërshtim me urdhrin e ekzekutimit, duke qenë se ajo (gjyqtarja) nuk ka të drejtë të caktojë ekspert, për shkak se denoncuesi pretendon se i kishte përfunduar procedurat e ekspertimit me vendim të formës së prerë. Bashkëlidhur, denoncuesi ka sjellë edhe vendime të tjera gjyqësore, ku ankohet edhe për subjekte të tjera, por në vështrim të vendimit nr. \*\*\*, datë 6.12.2013, ku gjyqtare është subjekti i rivlerësimit, vihet re se denoncuesi Q. T është në cilësinë e paditësit dhe palë e paditur është Zyra Përmbartimore dhe shoqëria e sigurimit, me objekt “Kundërshtimin e veprimeve përmbartimore”, ku gjyqtarja Blerina Muça i ka pranuar kërkesën e palës paditëse shtetasit Q. T, duke e arsyetuar në përputhje me të drejtën legjitime të kërkuarit.

Vendimi nr. \*\*\* i Gjykatës së Apelit Vlorë është sqaruar dhe interpretuar po nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. \*\*\* të datës 13.11.2012, duke vendosur: “Në pamundësi të riparimit të mjetit në servis, pala e paditur detyrohet t’i paguajë paditësit Q. T. vlerën monetare korresponduese sipas aktit të ekspertimit të administruar gjatë gjykimin në shkallë të parë.”

Ky vendim i subjektit të rivlerësimit duket se shfaq të meta lidhur me palën e paditur, Zyra e Përmbartimit Tiranë, pasi nuk identifikohet cila zyrë përmbartimore është palë në proces, si dhe njoftimet e bëra kësaj zyre për seancat gjyqësore. Gjithashtu, në këtë vendim përmendet dhe fakti se nga përmbartuesja gjyqësore, me vendimin e datës 19.4.2013, është vendosur pushimi i

ekzekutimit për shkak të përmbushjes së plotë të detyrimit nga pala debitore (konform urdhrimit të ekzekutimit si titull ekzekutiv).

Duket se subjekti i rivlerësimit në këtë vendim ka vendosur në kundërshtim me vendimin e formës së prerë nr. \*\*\*, datë 12.9.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, duke urdhëruar Zyrën e Përmbarimit që të caktojë ekspert autoteknik për verifikimin e mundësisë së riparimit të mjetit të dëmtuar, për më tepër kur vendimi gjyqësor i formës së prerë dhe titulli ekzekutiv ishte përmbushur nga palët.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Për vendimin nr. \*\*\*, datë 6.12.2013, nuk është ushtruar ankim nga palët. Lidhur me konstatimin se “Ky vendim i subjektit të rivlerësimit duket se shfaq të meta lidhur me palën e paditur Z.P Tiranë, pasi nuk identifikohet se cila zyrë përmbarimore është palë në proces”, sqaroj se ky konstatim nuk qëndron, për arsye se në atë gjykim palë e paditur, sikurse bëhet prezent në vendim, ka qenë Z.P Tiranë, ose, siç njihet ndryshe, P.Sh.*

*Në përmbajtje të vendimit janë parashtruar rrethanat e çështjes, të cilat në mënyrë të përmbledhur konsistojnë në faktin se përmbaruesja gjyqësore, duke mos iu përmbajtur vendimit nr. \*\*\*, datë 12.9.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, sqaruar dhe interpretuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.11.2012, të po asaj gjykate, nuk kishte verifikuar mundësinë e riparimit të mjetit të dëmtuar të paditësit në servis, por kishte kërkuar që në fillim të ekzekutimit pagimin nga shoqëria e sigurimit/debitori, në favor të paditësit/kreditori, të shumës së dalë nga akti i ekspertimit, marrë si provë gjatë gjykimit. Pas kryerjes së pagesës nga pala debitore, përmbaruesja kishte vendosur pushimin e ekzekutimit. Paditësi Q.T, në cilësinë e kreditorit në ekzekutim, duke mos qenë dakord me procedurën e ndjekur nga përmbaruesja, konform nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, ka kërkuar në gjykatë anulimin e vendimit të pushimit të ekzekutimit dhe kryerjen e veprimeve sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë/titullit ekzekutiv.*

*Pas analizimit të situatës faktike dhe ligjore të çështjes, nga ana ime është vlerësuar veprimi përmbarimor “Vendim pushim ekzekutimi”, si një veprim i kryer në kundërshtim me ligjin, pasi përmbaruesja gjyqësore nuk kishte respektuar urdhërimin e gjykatës në vendimin e kthyer në titull ekzekutiv, sipas përcaktimeve në dispozitivin e tij. Për këto natyra gjykimi, gjykata, së bashku me anulimin e veprimit përmbarimor, të cilin e gjen në kundërshtim me ligjin, duhet të urdhërojë përmbaruesin edhe për mënyrën e vijimit të ekzekutimit. Në rastin konkret, përmbaruesja është urdhëruar që, sipas urdhërimit të vendimit nr. \*\*\*, datë 13.11.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, të verifikojë paraprakisht me ekspert autoteknik mundësinë e riparimit të pjesëve të dëmtuara të mjetit të kreditorit. Ky urdhërim nuk përbën vendim për riekspertim, sikurse është vlerësuar në raport, por vetëm orientim i veprimeve të përmbaruesit sipas titullit ekzekutiv. Vetëm në rast se nga ekspertimi autoteknik do të konkludohej në pamundësinë e riparimit të pjesëve të dëmtuara të mjetit, përmbaruesja do të mund të vijonte me urdhërimin e shoqërisë siguroese për të paguar në favor të paditësit shumën e caktuar nga vendimi i formës së prerë”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Pas shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë çështje.

### **7.10 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2021, i shtetasit D.M**

Denoncuesi është ankuar pranë Komisionit për gjyqtaren Blerina Muça, për shkak se ajo ka dhënë vendim të padrejtë dhe zhgënjyes, si për vonesën, ashtu edhe për shkak të arsytimit të vendimit. Bashkëlidhur denoncimit, denoncuesi ka sjellë vendimin e datës 3.2.2021, me gjyqtare subjektin

e rivlerësimit, deklaratën noteriale të datës 27.1.2020, si dhe kërkesën për lëshim urdhri ekzekutimi dhe ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjyqtarja në vendimin e saj nuk ka pranuar kërkesën e shtetasit D. M për lëshim urdhri ekzekutimi, duke arsyetuar se deklarata noteriale objekt gjykimi nuk është e plotë në kuptim të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile e, në këto kushte, kjo deklaratë nuk përbën titull ekzekutiv dhe për të nuk mund të lëshohet urdhri i ekzekutimit. Denoncuesi ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi.

Vendimmarrja e subjektit i është nënshtruar procesit të ankimit nga pala denoncuese. Në referim të pikës 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, Komisioni, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nuk mund të gjykojë themelin e çështjes apo të ndërhyjë në logjikën e vlerësuar nga gjyqtarja e çështjes.

Lidhur me procedurën e ndjekur, duket se kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit është depozituar në gjykatë, në datën 2.2.2021 dhe subjekti i rivlerësimit është shprehur me vendim në datën 30.3.2021. Duket se ky vendim i është vënë në dispozicion palës në datën 27.4.2021.

Për sa më sipër duket se nga ana e subjektit në këtë gjykim nuk janë respektuar afatet procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile.

Lidhur me gjetjet e konstatuara, si dhe për ecurinë e kësaj çështjeje në shkallët e tjera të gjyqësorit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Çështja në fjalë është kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, e cila shqyrtohet nga gjyqtari në dhomë këshillimi pa praninë e palës kërkuese, mbi bazën e akteve të depozituara. Konstatimi i Komisionit për kohëzgjatjen e gjykimit është i drejtë. Një nga shkaqet kryesore të gjykimeve tej afateve standarde të çështjeve civile në përgjithësi dhe, në veçanti të kërkesave për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, është numri i tyre shumë i lartë. Ky fakt e bën objektivisht të pamundur marrjen në shqyrtim të kërkesave për lëshim të urdhrit të ekzekutimit brenda afatit 5-ditor nga dita e depozitimit të kërkesës, përcaktuar në nenin 511, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Civile.*

*Po kështu, i drejtë është edhe konstatimi në raport në lidhje me kohëzgjatjen për arsyetimin e vendimit, por, pas verifikimit të të dhënave të librit të dorëzimit të dosjeve nga sekretarja gjyqësore në kryesekretarinë e gjykatës, saktësoj se vendimi është shpallur në datën 30.3.2021 dhe dosja është dorëzuar në datën 22.4.2021, periudhë në të cilën përfshihet edhe koha që i nevojitet sekretarisë për zbardhjen e vendimit dhe përgatitjen e dosjes për dorëzim. Nga ky moment, kryesekretaria brenda kompetencave ka kryer dhe komunikimin e vendimit të arsyetuar palës denoncuese”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni konstatoi vonesa të paarsyeshme të subjektit në shqyrtimin dhe arsyetimin e vendimit për këtë çështje. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shkelur afatet, duke mos respektuar standardin për një proces të rregullt ligjor.

### **7.11 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2022, i shtetasit E.R**

Denoncuesi është ankuar pranë Komisionit për parregullsitë në procesin civil midis tij si paditës dhe Zyrës së përfaqësimit të shoqërisë “\*\*\*”, dalë me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.7.2021, me gjyqtare Blerina Muça.

Denoncuesi pretendon se deri në datën 11.10.2021, ditë kur ka depozituar këtë denoncim, gjyqtarja nuk ka publikuar vendimin sipas Kodit të Procedurës Civile. Denoncuesi në cilësinë e paditësit i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë me objekt “Detyrimin e të paditurit t’i paguajë 9000 euro si rezultat i dëmit të shkaktuar nga mosrespektimi i kontratës së qirasë të datës 15.12.2016 për sa

i përket zgjidhjes së saj në mënyrë të njëanshme dhe pa paralajmërim; detyrimin e të paditurit të paguajë vlerën 690,000 lekë si rezultat i mosrespektimit të kontratës së qirasë datë 15.12.2016 për kthimin e ambienteve të qirasë në gjendjen e mëparshme (riparim, lysterje, pastrim)”.

Duke qenë pronar i një ambienti-vilë, paditësi E. R, referuar kontratës noteriale të datës 13.3.2009 e të rinovuar në datën 15.12.2016, i ka dhënë me qira shoqërisë këtë ambient privat, ku kjo e fundit ka shkelur kontratën, duke u larguar para kohe, duke mos bërë dorëzimet sipas kushteve të kontratës e duke mos dorëzuar çelësat e ambientit e bllokuar kështu pronën.

Denoncuesi e akuzon gjyqtaren për njëanshmëri totale përgjatë gjithë procesit gjyqësor, si në etapën e hetimit gjyqësor, po ashtu edhe në pranimin e provave, pyetjen e dëshmitarëve dhe deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Gjithashtu, ajo ka zvarritur me qëllim procesin gjyqësor, duke i lënë seancat gjyqësore me një afat 3 muaj nga njëra-tjetra, ku kohëzgjatja e procesit ka shkuar deri në 760 ditë, në ndryshim me një mesatare 450 ditë, referuar kjo statistikave të Gjykatës.

Për të vijuar me verifikimin e pretendimeve të denoncuesit, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën<sup>45</sup> për vënie në dispozicion të praktikës gjyqësore për çështjen nr. \*\*\*, datë 1.7.2019, që i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 29.7.2021, duke kërkuar aktet e njoftimit të vendimit për palët ndërgjyqëse. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kthyer përgjigje<sup>46</sup>, duke dërguar kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 29.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me gjyqtare Blerina Muça, por duke qenë se aktualisht ky vendim është me statusin ankimuar e dosja gjyqësore ndodhet në Gjykatën e Apelit Tiranë, ishte i pamundur objektivisht dërgimi i informacionit mbi njoftimin e palëve mbi këtë vendim.

Në referim të vendimit të sipërcituar, vihet re se gjyqtarja në fund të shqyrtimit gjyqësor ka vendosur pranimin e pjeshëm të padisë së paditësit E. R, duke detyruar palën e paditur t’i paguajë paditësit E. R shumën 689,918 lekë për vlerën e punimeve të riparimit të ambientit objekt i kontratës së qirasë dhe të zëvendësimit të pajisjeve elektrike; ndërsa ka rrëzuar padinë për pjesën tjetër të kërimit, për shkak se gjatë shqyrtimit gjyqësor, nëpërmjet provave e pyetjes së dëshmitarëve, është provuar se i padituri ka respektuar afatin 6-mujor të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së qirasë para afatit të saj.

Lidhur me këtë çështje Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit duket se është në shkelje të afateve të gjykimit për një proces të rregullt ligjor (nga data 15.7.2019 deri në datën 29.7.2021) dhe afateve procedurale për njoftimin e palëve për seancat gjyqësore dhe zbardhjen e vënien në dispozicion të vendimit palëve në proces.

Lidhur me gjetjet e konstatuara, si dhe për ecurinë e kësaj çështjeje në shkallët e tjera të gjyqësorit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të japë shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Mbi dy ankesat e paraqitura nga paditësi në këtë gjykim, shtetasi E.R, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë të gjitha të dhënat e nevojshme pranë gjykatës, me qëllim verifikimin nëse kishte fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për shkaqet e pretenduara në ankesë. Me vendimin nr. \*\*\* \*\*\*, datë 16.6.2022, ILD-ja ka vendosur “Arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara...”, të paraqitura nga shtetasi E.R, ndaj veprimtarisë gjyqësore të magistrates Blerina Muça.*

*Në këtë vendim do të gjeni të pasqyruar gjithë veprimtarinë gjyqësore të ndjekur për shqyrtimin e çështjes, duke filluar me fazën e veprimeve paraprake e, më tej, me seancat përgatitore dhe ato gjyqësore, deri në shpalljen e vendimit përfundimtar, shoqëruar dhe me arsyet ligjore që kanë*

---

<sup>45</sup> Shihni kërkesën nr. \*\*\* prot, datë 10.2.2023, të Komisionit, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>46</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



*shërbyer në çdo rast për shtyrjen e secilës seancë. Në vendim ILD shprehet se: "... rezulton se nuk ka pasur mungesa në detyrë të gjyqtarës së çështjes. Rezulton se gjykata ka qenë produktive në veprimet e veta, në funksion të marrjes së masave për të bërë të mundur zhvillimin e gjykimit në pajtim me normat procedurale".*

*Konstatimi i Komisionit për shkelje të afateve dhe zbardhjen e vënien në dispozicion të vendimit palëve në proces është i drejtë. Vendimi është shpallur në datën 29.7.2021 dhe dosja është dorëzuar në kryesekretari në datën 9.9.2021, pasi është përgatitur nga sekretarja gjyqësore. Nga data 2.8.2021 deri në datën 19.8.2021, unë kam kryer një pjesë të lejes vjetore. Duke zbritur këtë periudhë, rezulton që dosja të jetë dorëzuar në Kryesekretari 23 ditë pas shpalljes së vendimit, pra vetëm 3 ditë tej afatit ligjor 20-ditor. Kjo shkelje e afatit ligjor me 3 ditë argumentohet me volumin e madh të çështjeve në gjykim, si dhe kohën e nevojshme gjatë së cilës sekretarja gjyqësore përgatit dosjen për t'u dorëzuar në kryesekretari.*

*Lidhur me kërkesën tuaj për dhënien e shpjegimeve për ecurinë e kësaj çështjeje në shkallët e tjera të gjyqësorit, nga të dhënat e nxjerra nga sistemi elektronik i gjykatës, rezulton se kjo çështje është me status "ankimuar", që do të thotë se ende nuk është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Apelit Tiranë".*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Çështja në fjalë i është caktuar subjektit në datën 2.7.2019, duke vendosur seancën paraprake në datën 11.7.2019. Për këtë çështje janë zhvilluar gjithsej 13 seanca gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit në prapësime nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me shtyrjen e seancës paraprake nga data 11.7.2019 deri në datën 23.10.2019, si dhe pretendimin për ushtrimin e lejes vjetore nga data 2.8.2021 deri në datën 19.8.2021. Caktimi i disa seancave gjyqësore ka qenë në afate mbi 1 muaj dhe të pajustificuara (nga data 23.10.2019 – 5.12.2019 – 2.3.2020 – 27.4.2020, nga data 6.10.2020 – 9.12.2020 – 10.2.2021 – 10.5.2021 – 1.7.2021 etj.).

Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar standardin për një proces të rregullt ligjor, e cila ka ardhur si rezultat i vonesave të pajustificuara në caktimin e seancave gjyqësore nga njëra te tjetra, pa ndonjë shkak të arsyeshëm. Gjithashtu u evidentuan shkelje të afateve në zbardhjen e vendimit dhe vënien në dispozicion të vendimit palëve në proces.

### **7.12 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2019, i shtetasit V.B**

Denoncuesi është ish-punonjës i \*\*\*. Ai i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të rivendosur të drejtën e tij në lidhje me marrëdhënien e tij të punës me \*\*\*.

Për këtë fakt është regjistruar çështja e tij me gjyqtar z. N. Rr. dhe, pas pranimit të kërkesës për përjashtimin e tij, çështja i ka kaluar për gjykim gjyqtarës znj. Blerina Muça, e cila i është drejtuar palës së paditur \*\*\*, në mënyrë që ta pajisnin me certifikatë sigurie për të këqyrur provat e pretenduara nga pala e paditur, se ishin sekret, jashtë procedurës normale ligjore të parashikuara nga neni 224 i Kodit të Procedurës Civile. Sipas denoncuesit, me këto veprime Gjykata ka shkelur haptazi të drejtën e paditësit për t'u njohur me provat në gjykim, si dhe në fund të gjykimit vendimi është i paplotë, kontradiktor dhe shumë i vonuar.

Për të verifikuar pretendimet e ankuesit sa më sipër, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, ku kërkoi kopje të vendimit nr. \*\*\* akti, datë 15.9.2017 dhe informacion për afatet e zbardhjes së vendimit dhe njoftimin e palëve mbi këtë vendim.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kthyer përgjigje<sup>47</sup>, duke dërguar kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 11.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtare Blerina Muça, me shënime e Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe kopje nga numërori i vendimeve të kësaj gjykate.

Ky vendim me palë paditëse shtetasin V.B, me palë të paditur \*\*\*-in, ka për objekt “Anulimin e urdhrimit për përjashtimin nga shërbimi, si dhe detyrimet e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin sipas Kodit të Punës”.

Pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, gjyqtarja Blerina Muça ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuarit V. B, duke mos e gjetur atë të bazuar në prova e fakte.

Nga shënimi i Gjykatës së Apelit evidentohet se kjo gjykatë ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 11.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për kompetencë gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ndërsa nga këqyrja e numërorit të vendimeve të gjykatës evidentohet se çështja është regjistruar në datën 15.9.2017 dhe vendimi është dorëzuar në sekretari, në datën 15.1.2019. Numri i seancave gjyqësore të zhvilluara është 16, një numër ky i madh për një proces gjyqësor të tillë.

Vendimi i subjektit të rivlerësimit është prishur nga Gjykata e Apelit, pasi janë evidentuar shkelje në vendimin e dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë. Gjithashtu, Komisioni konstatoi vonesa në shqyrtimin e kësaj çështjeje nga ana e subjektit dhe numër të shumtë të seancave gjyqësore të zhvilluara, në një interval kohor rreth 15 muaj gjykimi, në shkelje të afateve ligjore për një proces të rregullt gjyqësor.

Sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: “Gjykata Administrative në arsyetimin e këtij vendimi argumentonte kërkimet e palës paditëse në padi sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, si shkak determinant për shpalljen e moskompetencës së saj lëndore në shqyrtimin e mosmarrëveshjes. Në këtë situatë, kjo çështje ka kaluar për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, pas shortimit, ka kaluar për gjykim pranë gjyqtarit N. Rr., i cili, pas disa seancave të zhvilluara, është përjashtuar nga ky gjykim. Nëpërmjet shortit elektronik të datës 29.6.2018, kopje të të cilit po depozitohet si provë, kjo çështje ka kaluar për shqyrtim pranë meje dhe është përfunduar në datën 11.12.2018.

Në kushtet sa më sipër, në vlerësimin tim në atë kohë, është çmuar se kompetenca lëndore ka qenë e përcaktuar më parë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe, në këtë mënyrë, është vijuar me marrjen në shqyrtim të çështjes. Ndërkohë, Gjykata e Apelit Tiranë, si shkallë më e lartë gjykimi dhe brenda të drejtave që i njej ligji procedural civil, në vendimin nr. \*\*\*, datë 20.1.2020, ka përcaktuar në mënyrë përfundimtare, si gjykatë kompetente për shqyrtimin e çështjes, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke e rikthyer edhe një herë për gjykim pranë kësaj Gjykate.

Lidhur me gjetjen e Komisionit se “...konstatoi vonesa në shqyrtimin e kësaj çështjeje nga ana e subjektit dhe numër të shumtë të seancave gjyqësore të zhvilluara, në një interval kohor rreth 15 muaj gjykimi, në shkelje të afateve ligjore për një proces të rregullt gjyqësor”, subjekti ka sqaruar se nga të dhënat e nxjerra nga sistemi elektronik i gjykatës rezultoi që seanca e parë për këtë çështje është zhvilluar në datën 25.7.2018. Për gjykimin e saj janë zhvilluar në total 6 seanca dhe në datën 11.12.2018 është shpallur vendimi përfundimtar me nr. \*\*\*. Shkaqet e shtyrjes së secilës seancë janë të pasqyruara në dokumentin elektronik të kësaj çështjeje, dokument i depozituar së

<sup>47</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*bashku me materialin. Gjykimi ka zgjatur nga data 29.6.2018 deri në datën 11.12.2018, pra, për më pak se 6 muaj, duke u respektuar në këtë rast afati ligjor i gjykimit. Subjekti paraqiti për t'u marrë në vlerësim edhe dy vendime të ILD-së lidhur me ankesat e këtij shtetasi (V.B), për të cilat është vendosur arkivimi, duke u vlerësuar në këtë mënyrë pretendimet e tij të pambështetura.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Rezultoi se për vlerësimin e kësaj çështjeje subjekti i rivlerësimit nuk i është referuar dhe nuk ka përmendur vendimin unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave të zakonshme civile për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kësaj natyre. Pra, subjekti i rivlerësimit ka ndjekur një çështje administrative pa përcaktuar kompetencën lëndore në referencë edhe të vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili kishte dalë shumë kohë para vendimit të subjektit (ky si veprim i përsëritur nga ana e subjektit).

Për sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë barrën e provës lidhur me të gjitha gjetjet e bëra për këtë çështje nga ana e Komisionit.

### **7.13 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2021, i shtetasit A.C**

Denoncuesi ka paraqitur denoncim pranë Komisionit, ku denoncon për njëanshmëri dhe mungesë profesionalizmi në trajtimin e çështjes “\*\*\*”, me palë paditëse A. C, me objekt “Kundërshtimin e veprimeve përmbartimore”. Denoncuesi vijon denoncimin, duke thënë se: “Gjyqtarja ka kthyer aktet në mënyrë absurde dhe për më shumë se 2 muaj nuk ka vënë në dispozicion vendimin e arsyetuar, ku specifika e çështjes ishte delikate, sepse ka të bëjë me veprime përmbartimore të jashtëligjshme”.

Për të verifikuar këtë denoncim, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>48</sup>, ku i kërkoi kopje të vendimit/eve me palë denoncuesin, si dhe ecurinë e tyre në shkallë të tjera të gjyqësorit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kthyer përgjigje<sup>49</sup>, duke vënë në dispozicion vendimet nr. \*\*\*, datë 16.11.2021, me paditës z. A. C dhe të paditur shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. etj., ku është vendosur për kthimin pa veprime të padisë së paditësit A. C. si padi me të meta, dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 26.11.2021, me paditës A. C. e të paditur shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. etj., ku është vendosur për kthimin pa veprime të padisë së paditësit A. C. si padi me të meta.

Në lidhje me arsyetimin e vendimeve, shihet se vendimi nr. \*\*\*, datë 16.11.2021, ka marrë formë të prerë në datën 4.5.2022, pra rreth 5 muaj e gjysmë nga shpallja e tij.

Ndërsa vendimi nr. \*\*\*, datë 26.11.2021, ka marrë formë të prerë në datën 22.12.2021, pasi nuk është ankimuar.

Në përfundim të analizës së këtyre vendimeve, konstatohet se vendimi nr. \*\*\*, datë 16.11.2021, është arsyetuar nga subjekti i rivlerësimit jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile e, për pasojë, edhe njoftimi i palëve është bërë me vonesë.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: “Për të dyja këto vendime është vendosur kthimi i padisë me të meta në veprime paraprake, në dhomë këshillimi. Ndaj të dyja vendimeve denoncuesi nuk ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit, sikurse konfirmohet nga të dhënat e nxjerra nga sistemi elektronik i gjykatës. Ndërsa lidhur me

<sup>48</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2023.

<sup>49</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2023.

*konstatimin e Komisionit se vendimi nr. \*\*\*, datë 16.11.2021, është arsyetuar nga subjekti i rivlerësimit jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile e, për pasojë, edhe njoftimi i palëve është bërë me vonesë, ky konstatim nuk është i saktë, pasi nga të dhënat e librit të dorëzimit të dosjeve të sekretares në kryesekretarinë e gjykatës rezulton që dosja, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.11.2021, është dorëzuar nga sekretarja gjyqësore në datën 19.11.2021. Nga ky moment, komunikimi i vendimit për palët ndërgjyqëse është detyrë tërësisht e kryesekretarisë së gjykatës. Për rrjedhojë, është respektuar në këtë rast afati procedural për arsyetimin e vendimit, sipas përcaktimeve të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Pas shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk janë konstatuar problematika për këtë çështje gjyqësore.

### **7.14 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2018, i shtetasit G. B**

Denoncuesi ka denoncuar shumë subjekte rivlerësimi, noterë e ekspertë pranë Komisionit për shkelje ligjore, pasi nuk i kanë marrë në konsideratë kërkesën për rivendosje në afat të vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 16.4.2010. Ndërsa, sipas denoncuesit, gjyqtarja Blerina Muça i ka tjetërsuar kërkesën dhe ia ka rrëzuar padrejtësisht, pasi, siç pretendon ai, e ka provuar me fakte zyrtare që nuk ka marrë njoftim për këtë vendim gjyqësor, duke zhvilluar procesin gjyqësor në mungesë dhe pa e njoftuar.

Në vështrim të praktikës gjyqësore që denoncuesi ka sjellë, Komisioni studioi dy vendimet gjyqësore me gjyqtare subjektin e rivlerësimit - vendimin nr. \*\*\*, datë 16.4.2010 dhe vendimin e datës 4.10.2010, me objekt përkatësisht “Detyrimin e palës së paditur G. B për t’i kthyer paditësit shumat e marra hua sipas kontratave të huave të viteve (2003 dhe 2005), si dhe kërkesën për lëshim urdhri ekzekutimi për këtë detyrim”.

Kjo çështje ka të bëjë me kërkesëpadinë me të cilën vëllai i denoncuesit L. B. i është drejtuar gjykatës për kthimin e dy shumave financiare nga ana e denoncuesit G. B (i padituri), me kusht kthimin e tyre pas dy viteve, referuar dy kontratave të huadhënies së parave. Me kalimin e afatit të kthimit të huave (2 vite), L. B. i është drejtuar gjykatës me kërkesën e kthimit të shumave përkatëse, bashkë me interesat e caktuar monetarë. Gjykata i ka dhënë të drejtë paditësit L. B., duke detyruar G. B. (vëllain e paditësit, denoncuesin) të kthejë shumat e marra hua bashkë me interesat.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.7.2014, ka rrëzuar kërkesën për rivendosje në afat (pasi denoncuesi pretendon se nuk i është komunikuar vendimi nr. \*\*\*, datë 16.4.2010 dhe ai i lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, me gjyqtare Blerina Muça) dhe Gjykata e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.11.2015, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke arsyetuar se shkaqet e ankimit nuk qëndrojnë dhe nuk duhen të merren parasysh nga Kolegji i Gjykatës së Apelit. Denoncuesi ka vijuar me kundërshtim veprimesh përmbare deri në vitin 2017.

Duke parë arsyetimin e gjyqtares në vendimin nr. \*\*\*, datë 16.4.2010, i cili ka marrë formë të prerë më 1.5.2010 për paditësin dhe në datën 16.5.2010 për të paditurin (në mungesë, me shpallje njëmuore), nuk vihen re shkelje procedurale të kryera nga ana e subjektit, nisur edhe nga fakti se ky vendim ka marrë formë të prerë. Kjo referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 27.5.2004, i cili në thelb ka arsyetuar se, për sa kohë vendimet nuk janë ndryshuar apo prishur nga një gjykatë më e lartë, ato nuk mund të jenë objekt vlerësimi ligjshmërie nga asnjë institucion tjetër, përfshirë edhe Komisionin.

Por, lidhur me afatin e njoftimit të palëve për vendimin nr. \*\*\*, datë 16.4.2010 dhe vendimin e datës 4.10.2010, Komisioni i kërkon shpjegime subjektit të rivlerësimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Me dorëzimin e dosjes gjyqësore në kryesekretari, përfundojnë edhe detyrimet ligjore dhe procedurale të gjyqtarit të çështjes. Njoftimi i vendimeve përfundimtare, sipas përcaktimeve në nenet 128 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, është detyrë e kryesekretarisë së gjykatës dhe jo e gjyqtarit. Subjekti ka sqaruar se në rastin në fjalë rregullshmëria e veprimeve të kryesekretarisë për komunikimin e vendimit palëve ndërgjyqëse është kontrolluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykata e Apelit Durrës, të cilat kanë rrëzuar pretendimet e denoncuesit/të paditurit G.B në këtë drejtim”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse për rastin në fjalë dhe nuk shoqërohen me prova shkresore për të vërtetuar depozitimin e këtyre dy vendimeve pranë sekretarisë gjyqësore.

Për sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë barrën e provës lidhur me të gjitha gjetjet e bëra për këtë çështje nga ana e Komisionit.

### **7.15 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2018, i shtetasit H.Z**

Denoncuesi ka paraqitur ankesë për shumë subjekte rivlerësimi, ndër to edhe për gjyqtaren Blerina Muça. Në informacionin që sjell, ai citon edhe vendimin nr. \*\*\*, datë 29.3.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtare Blerina Muça, vendim i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.11.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Denoncimin e tij ai e mbyll duke kërkuar *“të analizohet vendimmarrja e një vendimi të Gjykatës së Lartë (për dy gjyqtarët A. B. dhe M. B., duke qenë se gjyqtari i tretë Sh. S. nuk është bërë palë në këtë vendim), me nr. \*\*\*, datë 13.6.2018, ku kanë vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. \*\*\*, datë 7.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.4.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë”.*

Sa më sipër, referuar objektit të denoncimit nga ana e denoncuesit (vendimi i vitit 2018 dhe gjyqtarët që kanë dhënë këtë vendim), si dhe faktit se për vendimin e vitit 2010, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, nuk pretendohen shkelje procedurale konkrete nga denoncuesi, Komisioni nuk hetoi më tej.

### **7.16 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2019, i shtetasit H.R**

Denoncuesi ka paraqitur ankesë ndaj subjektit të rivlerësimit, gjyqtares Blerina Muça, duke cituar si shkaqe denoncimi shkeljen e ligjit dhe etikës profesionale nga ana e saj. Sipas denoncuesit, ai dhe familja e tij janë të përfshirë që prej vitit 1997 në një kalvar të gjatë gjyqesh në lidhje me një banesë të ndodhur në rrugën “M. U.”, Tiranë, tek e cila kanë jetuar që prej vitit 1989 e deri në vitin 2011, sipas një marrëdhënieje qiraje të asaj kohe. Me vendimin nr. \*\*\* të vitit 1994 të KKKP-së është vendosur kthimi i banesës objekt gjykimi trashëgimtarëve K pa kundërshtpërblim, duke vlerësuar investimin e bërë në këtë ndërtesë nën vlerën 20%, të parashikuar nga ligji. Por me vendimin e vitit 1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me vendimin e Gjykatës së Apelit të po atij viti, është vendosur *“Ndryshimi i vendimit nr. \*\*\* të KKKP-së lidhur me vlerën e shpenzimeve të kryera nga paditësi S. R, duke njohur 37%, baras me vlerën 286,890 lekë kontribut të tij në pjesën që përdor në raport me ndërtesën e ish-pronarit”.* Vite më vonë, palët i janë drejtuar përsëri gjykatës për rishikim të vendimit të gjykatës së vitit 1997 e të tjera çështje relevante, e në vitin 2011 është ekzekutuar vendimi i gjykatës, ku familja R ka liruar banesën e poseduar prej vitesh.

Në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtare Blerina Muça, me objekt “Rivendosje në posedim”, është vendosur rrezimi i kësaj padie të S. R. dhe H.R. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Për sa i përket pretendimeve, ankesave e akuzave të denoncuesit ndaj gjyqtares Blerina Muça në dhënien e këtij vendimi, Komisioni vlerësoi se këto pretendime të denoncuesit nuk gjenden të mbështetura.

#### **7.17 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2017, i shtetasit V.Ç**

Denoncuesi është ankuar pranë Komisionit se i është marrë prona e shitur nga shteti me një vendim të KKKP-së të falsifikuar. Në vitin 1999, denoncuesi thotë se ka blerë një magazinë dhe truall. Pas 6 vitesh e gjysmë e padisin në gjykatë individë si ish-pronarë për kontratat e tij me shtetin. Në vitin 2009, denoncuesi ka paraqitur një kundërpadi në gjykatë, e cila nuk i është pranuar, duke i mohuar të drejtën e mbrojtjes.

Sipas prokurorisë, vendimi i KKKP-së ishte i falsifikuar, për të cilin është shprehur gjykata, duke dënuar falsifikatorët; është pushuar nga Gjykata e Apelit dhe nuk është pranuar rekursi në Gjykatën e Lartë dhe përsëri është përdorur ky vendim i KKKP-së, i falsifikuar. Në vitin 2016, nga Gjykata Kushtetuese kthehet për rishqyrtim në Gjykatë të Lartë. Në vitin 2017, gjyqtarë që kishin gjykuar çështjen e tij më parë, vendosën mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi.

Në referim të ankesave të mësipërme nga ana e denoncuesit, për sa kohë nuk referohet një proces konkret gjyqësor, veçanërisht për subjektin e rivlerësimit, Komisioni nuk mund të hetonte më tej.

#### **7.18 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021, i shtetasit Xh.M**

Shtetasi Xh. M është ankuar pranë Komisionit se gjyqtarja Blerina Muça e ka mashtruar, duke mos i bërë gjyqin 2 herë që ka shkuar në gjykatë dhe duke mos i marrë parasysh dosjet që i kishte dërguar për verifikim në lidhje me shqetësimin e tij prej vitesh për keqfaturimin që i bëhej nga \*\*\*-ja, për shkak të vjedhjes që i bënte komshiu duke çarë murin e futur telin e dritave.

Denoncuesi i ka kërkuar Komisionit të shkojë afër banesës së tij, që të mund ta verifikojnë situatën dhe të bëjnë fajtorë përgjegjës. Bashkëlidhur, denoncuesi ka sjellë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\*, datë 22.4.2022, me gjyqtare Blerina Muça, kopje të procesverbaleve të \*\*\*-së, kopje të kallëzimit penal, datë 2.6.2021 dhe kopje të procesverbalit mbi kallëzimin penal me foto shoqëruese.

Referuar vendimit të sipërcituar të gjykatës, vihet re se denoncuesi i është drejtuar Gjykatës, ku ka paditur \*\*\*-në me kërkesën “Detyrim të palës së paditur t’i paguajë paditësit dëmin e shkaktuar në shumën 900,000 lekë...”.

Në seancën e datës 22.4.2022, pala paditëse ka kërkuar pushimin e gjykimit, pasi për shkak të ndryshimit të shkakut ligjor dhe objektit të padisë është e nevojshme paraqitja e një padie të re, në përputhje me faktin dhe kërkimin e palës paditëse. Në këto kushte, për sa kohë disponimi i padisë është e drejtë e palës paditëse, gjykata me të drejtë ka vendosur pushimin e gjykimit. Duket se gjyqtarja e çështjes nuk ka shkelur ndonjë të drejtë apo privuar palën në gjetjen e të drejtës së tij. Përkundrazi, është e drejta dhe mundësia e palëve që në çdo kohë t’i drejtohen gjykatës në kërkim të së drejtës së tyre.

#### **7.19 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2019, i shtetasit F.M**

Denoncuesja është ankuar pranë Komisionit ndaj ish-prefektit të Qarkut Tiranë, z. S. V., i cili ka bërë padi të rreme për qëllime fitimi, si dhe gjyqtarët e gjykatës administrative, që kanë dhënë vendime me falsifikime e ryshfete për pronën e saj, e cila thotë se ka jetuar që në vitin 1987 në L, Kamëz, e fisi D e ka falsifikuar, duke e paditur në gjykatë për lirim e dorëzim të sipërfaqes së tokës

prej 5000 m<sup>2</sup>. Denoncuesja referon vendimin nr. \*\*\*, datë 25.4.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtare znj. Blerina Muça, vendimin e datës 2.5.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë, si dhe rekursin e paraqitur në Gjykatë të Lartë.

Për sa kohë denoncuesja adreson ankimin e saj kryesisht ndaj institucionit të prefektit të Qarkut Tiranë, si dhe nuk adreson pretendime e shkelje konkrete të kryera nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk mund të hetonte më tej në lidhje me këtë denoncim.

## **7.20 Denoncim i përsëritur i avokatit J.V nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2018**

Denoncuesi ka paraqitur ankim para Komisionit për shumë subjekte rivlerësimi, ndër to edhe për gjyqtaren Blerina Muça në lidhje me një “skandal”, siç e quan ai procesin gjyqësor 8-vjeçar në lidhje me një padi trashëgimie të A. V. N, e cila kërkonte një dëshmi trashëgimie të babait të saj (F.V.V), përfaqësuar nga avokati J. V. Denoncuesi ka pretenduar se gjyqtarët gjatë gjykimit në shkallë të parë kanë shkelur në mënyrë flagrante rregullat dhe procedurat për një proces të rregullt ligjor, të zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm. Ashtu si edhe për shumë subjekte të tjera, denoncuesi ankohet edhe për subjektin e rivlerësimit, ku në cilësinë e një prej tre gjyqtareve të çështjes ka zvarritur gjykimin e çështjes për arsye korruptive dhe në mënyrë të qëllimshme.

Denoncuesi është ankuar pranë shumë instancave e personaliteteve të larta shtetërore e gjithashtu edhe pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku nga ankimi i denoncuesit duket se ish-KLD-ja nuk ka marrë masa ndaj këtyre gjyqtarëve që kanë gjykuar çështjen. Gjithashtu, ai shton se, pas zvarritjeve të paprecedente, pala ankuese i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.7.2013, ka vendosur: “Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, në shkelje të nenit 42, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNJ-së”. Ndër të tjera, kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykimi i kësaj çështjeje është tejzgjatur për shkak të mosmarrjes së masave të nevojshme dhe të domosdoshme për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe veprimet e të paditurit, i cili gjithashtu ka ndikuar në zvarritje të procesit gjyqësor.

Komisioni, pas informacionit se Gjykata Kushtetuese ka konstatuar mosgjykimin brenda një afati të arsyeshëm të çështjes në fjalë, në lidhje me këtë zvarritje gjykimi, i kërkon shpjegime subjektivit të rivlerësimit si një prej gjyqtareve të kësaj çështjeje.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit pranë trupit gjykues, kjo çështje është regjistruar në gjykatë, në datën 19.1.2011 dhe ka kaluar për shqyrtim pranë saj në datën 25.4.2012, pas përjashtimit të dy gjyqtarëve të mëparshëm. Seanca e parë përgatitore është zhvilluar në datën 22.5.2012, duke u vendosur gjithashtu kalimi i çështjes në seancë gjyqësore dhe gjykimi i saj me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Në total janë zhvilluar 11 seanca, dy prej të cilave janë shtyrë për mosformim të trupit gjykues, për shkaqe objektive të anëtarëve. Në seancën e datës 11.9.2012 është pezulluar gjykimi dhe është vendosur dërgimi i dosjes në Gjykatën e Lartë, në kushtet kur pala e paditur paraqiti ankim ndaj vendimit të gjykatës për rrëzimin e kërkesës, për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe kompetencës tokësore të gjykatave civile shqiptare.*

*Ky vendim u la në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.10.2012, të Gjykatës së Lartë dhe, pas mbërritjes së dosjes në gjykatë, është caktuar seanca e radhës për vijimin e gjykimit në datën 22.1.2013. Në të dhënat e nxjerra nga sistemi elektronik i gjykatës gjejnë pasqyrim shkaqet ligjore dhe procedurale, që janë vlerësuar nga trupi gjykues si të zbatueshme për shtyrjen e çdo seance. Asnjë prej seancave nuk është shtyrë për mungesën time në punë apo për mosmenaxhim të procesit.*

*Duke përlllogaritur me përfaqësi periudhën e zgjatjes së gjykimit pranë trupit gjykues të kryesuar prej meje, rezultoi që kjo çështje është gjykuar për rreth 10 muaj, duke u zbatuar me përpikëri normat procedurale të detyrueshme për një proces të rregullt ligjor, në respektim të të drejtave procedurale të palëve pjesëmarrëse. Në këtë hark kohor, periudha e pezullimit të gjykimit, periudha e lejes vjetore në muajin gusht 2012 dhe periudha e mbartjeve të dosjeve nga data 1 deri në datën 15 janar 2013, nuk mund të përlllogariten në afatin e zgjatjes së gjykimit. Vlen të theksoj se afati i shtyrjes së seancave kushtëzohej nga gjykimi i çështjes me trup gjykues, fakt i cili në çdo rast kërkon rakordimin mes kalendarëve të tre gjyqtarëve”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Në përfundim të vlerësimit për këtë çështje, Komisioni shprehet se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të përmbysë barrën e provës së lënë në rezultatet e hetimit.

Shkelja kryesore është e kryer nga subjekti i rivlerësimit është në momentin e pezullimit ku kjo çështje është mbajtur nga subjekti 4 muaj dhe më pas është nxjerrë vendimi për pezullim.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese përcaktoi qartë se shkeljet për këtë proces gjyqësor kanë ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtare e çështjes.

### **7.21 Denoncim i subjektit politik P.D e Shqipërisë, K.R, nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2022**

K.R, me përfaqësues z. F.N, i është drejtuar Komisionit me një kërkesë-ankesë, për ta shqyrtuar në kuadër të procesit të rivlerësimit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Blerina Muça.

Kjo ankesë ka lidhje me vendimin e datës 22.4.2022, me të cilin është vendosur pranimi i ankimit të palës ankuese, P.D.Sh, përfaqësuar nga nënkryetari i saj, z. E.A, ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 25.3.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Denoncuesi bën me dije se është i vetmi organ drejtues i P.D, bazuar në Kuvendin e kësaj partie në datën 11 dhjetor 2021 dhe pranuar nga gjykata me vendimin nr. \*\*\*\*, datë 25 mars 2022. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim deputeti i PDSH-së, E.A, duke mbajtur arbitrarisht postin e ish-nënkryetarit të kësaj partie, post nga i cili ishte shkarkuar nga delegatët e Kuvendit të datës 11 dhjetor 2021.

Në datën 22.4.2022, gjyqtare Blerina Muça (çuditërisht kjo gjyqtare nuk është përjashtuar nga shorti elektronik, ashtu siç ka ndodhur me gjyqtarin A. Zh.) ka marrë në shqyrtim këtë ankim, duke vendosur pranimin e këtij ankimi nga PDSH, përfaqësuar nga nënkryetari i saj E. A.

Denoncuesi pretendon edhe se kërkuesi E. A nuk mund të legjitimohej si ankimues, pasi nuk kishte tagra përfaqësimi dhe nuk ishte palë në proces, kjo referuar nenit 422/a të Kodit të Procedurës Civile.

Ankuesi nuk është përfaqësues legjitim i ndonjë pale në procesin e shqyrtimit të kërkesës. Kontrolli mbi legjitimitetin që bën gjykata në këtë rast, nuk është substancial, po vetëm formal dhe procedural, duke verifikuar nëse ankuesi është një palë që ka qenë në proces apo jo (duke cituar një vendim të Gjykatës së Lartë nr. \*\*\*, me palë paditëse B. V dhe të paditur L. Gj etj).

Në çështjen gjyqësore lidhur me kërkesën e PDSH-së për të regjistruar statusin dhe vendimmarrjet e Kuvendit Kombëtar të korrikut 2021, i është referuar kërkesës së paraqitur nga K.R me objekt “Pushimin e gjykimit”, duke mos e marrë në shqyrtim atë, me arsyetimin e “mungesës së cilësisë procedurale të palës në proces.

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është e konsoliduar praktika e mospranimit të ankimit nga palët të cilat nuk legjitimohen”.



Ankuesi rendit edhe një sërë arsyesh të mospranimit të ankimit për shkak të mungesës së tagrave të z. E. A si kryetar i komanduar apo edhe si nënkryetar i PDSH-së.

Gjithashtu, sipas kësaj kërkesë-ankese, pretendohet se: *“Është evident shpërdorimi i detyrës nga gjyqtare Blerina Muça, e cila me këtë vendim ka krijuar një precedent të rrezikshëm në vendimmarrjet në sistemin gjyqësor lidhur me legjitimitimin e palëve, të cilat nuk janë pjesë e procesit”*.

Komisioni, në rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, në referim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

Por, në analizë të aspektit procedural të këtij vendimi, Komisioni i kërkon subjektit të rivlerësimit të sqarojë në lidhje me:

- procedurën e caktimit të saj si gjyqtare përgjegjëse për disponim ankimi;
- bazën ligjore të përdorur nga ankuesit në vendim, nenin 450 dhe në arsyetimin e këtij vendimi, 450/ç të Kodit të Procedurës Civile (nen i cili përcakton rastet e mospranimit të ankimit dhe jo të pranimit të ankimit) me nenin e bazuar nga gjykata në dispozitivin e këtij vendimi (neni 450/a);
- arsyetimin e bërë në vendim se: *“Kryesekretaria e Gjykatës së Rrethit Tiranë ka kaluar për disponim ankimin e PDSH-së pranë kësaj Gjykate, pasi ka vlerësuar se janë në kushtet e nenit 450, shkronja ç e Kodit të Procedurës Civile. Në ankim, subjekti PDSH përfaqësohet nga përfaqësues të ndryshëm nga përfaqësuesit e legjitimuar në kërkesën për të cilën gjykata ka dalë me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.3.2023”*;
- faktin e mbajtjes së *“standardit të dyfishtë”* nga ana e gjyqtarës Blerina Muça, të pretenduar nga ankuesi, ku në vendime të mëparshme subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarës ka mbajtur qëndrim, duke u shprehur në lidhje me kërkesa të ngjashme për *“mungesë të cilësisë procedurale në proces”* të subjekteve ankuese.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit lidhur me këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Deri në momentin kur Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë disponoi me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.5.2022, të gjitha ankimet e paraqitura vlerësoheshin paraprakisht nga kryesekretaria nëse pranoheshin ose jo. Praktika e standardizuar kërkonte që ankimet e depozituara të vlerësoheshin nga kryesekretaria, nëse plotësonin kushtet ligjore për t’u pranuar dhe për transferimin e dosjes në Gjykatën e Apelit, në rastet kur ankimi bazohej në ligj.*

*Në rastet kur konstatoheshin ankime me probleme, sikurse përcaktohen nga neni 450 i Kodit të Procedurës Civile, ankimi, me shënimin përkatës, duhej të merrej në shqyrtim nga gjyqtari. Për përcaktimin e gjyqtarit ndiqej procedura e shortit elektronik. Në këtë mënyrë, këto kategori ankimesh vlerësoheshin nga gjyqtari i përzgjedhur me short nëse do të pranoheshin ose jo.*

*Për rastin në fjalë, sipas procedurës së përshkruar më sipër, me shortin elektronik të datës 7.4.2022, jam caktuar si gjyqtar përgjegjës për t’u shprehur në lidhje me ankimin e paraqitur nga PDSH-ja, përfaqësuar nga nënkryetari i saj, ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 25.3.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

*Në datën 11.4.2022 është marrë në dorëzim dosja respektive nga sekretarja gjyqësore dhe në datën 12.4.2022 kam paraqitur përpara kryetarit të gjykatës kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes, duke parashtruar dhe shkaqet të cilat i vlerësova të arsyeshme dhe të bazuara në nenet 72/4, 73 dhe 74/1 të Kodit të Procedurës Civile për paraqitjen e kësaj kërkesë. Në kushtet kur me*

*vendimin e datës 12.4.2022 të kryetarit nuk u pranua kërkesa, nëpërmjet urdhrit të datës 13.4.2022 kam urdhëruar kalimin e çështjes për shqyrtim në dhomë këshillimi, në datën 22.4.2022, konform përcaktimeve të nenit 450 të Kodit të Procedurës Civile.*

*Neni 450 i Kodit të Procedurës Civile, që referohet në pjesën hyrëse të vendimit të datës 22.4.2022 si bazë ligjore, nuk i referohet bazës ligjore të ankimit të paraqitur nga ankuesi, por është dispozita procedurale mbi bazën e së cilës gjyqtari i vetëm në dhomë këshillimi merr në shqyrtim dhe vlerëson mbi pranimin ose jo të këtij ankimi. Pra, në bazë të kësaj dispozite, gjyqtari vlerëson nëse ankimi ka apo jo problematikat e përcaktuara në nenin 450 të Kodit të Procedurës Civile, të konstatuara nga kryesekretaria.*

*Sa i takon referencës në pjesën arsyetuese, shkronja “ç” e nenit 450, kjo është baza ligjore specifike që kryesekretaria kishte evidentuar si problematikë të këtij ankimi, është baza ligjore specifike për çështjen në fjalë. Pas kalimit të çështjes tek gjyqtari, ishte detyrë e tij të vlerësonte dhe të shprehej me vendim nëse ankimi duhej të pranohet apo jo. Pasi është shqyrtuar ankimi në fjalë, nga ana ime është konsideruar se nuk jemi në kushtet e përcaktuara nga shkronja “ç” e nenit 450 për mospranimin e ankimit kur ishte bërë: “ç. nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim...”. Ky qëndrim, sikurse sqarohet më gjerësisht në vijim, është konfirmuar nga Gjykata e Apelit Tiranë më lart. Çështja nëpërmjet shortit elektronik i kalonte gjyqtarit për veprime dhe ishte detyrë e tij të vlerësonte dhe të shprehej me vendim nëse ankimi duhej të pranohet apo jo. Në rastin konkret është ndjekur në mënyrë rigorozë kjo procedurë.*

*Përcjellja në Gjykatën e Apelit e ankimit të pranuar me vendim realizohet nëpërmjet kësaj dispozite. Mbi bazën e vendimit të pranimin të ankimit, të dyja dosjet (disponimi i ankimit dhe dosja e vendimit të ankimit) i kanë kaluar për shqyrtim Gjykatës së Apelit Tiranë.*

*Sqarohet se neni 450/3 i Kodit të Procedurës Civile përcakton: “Mospranimi i ankimit mund të deklarohet në çdo shkallë gjykimi”. Për rrjedhojë, Gjykata e Apelit verifikon në çdo rast ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e ankimit të pranuar nga shkalla e parë e gjykimit. Në rastin në fjalë, Gjykata e Apelit ka rivlerësuar në mënyrë të pavarur vendimin nr. \*\*\* akti, datë 22.4.2022, dhënë prej meje dhe ka konkluduar se ankimi ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 25.3.2022, përmbush kriteret ligjore, mes të cilave dhe atë të legjitimitetit të ankuesit dhe duhet të pranohet. Më tej, Gjykata e Apelit ka marrë në shqyrtim në themel ankimin, duke konfirmuar në këtë mënyrë plotësisht bazueshmërinë e vendimit nr. \*\*\* akti, datë 22.4.2022 dhe rrëzimin e pretendimeve të ankuesit/denoncuesit.*

*Në përgjigje të denoncimit, standardet nuk vendosen prej meje, por nga vendimmarrja e gjykatave dhe, në këtë rast, gjykata më e lartë ka vlerësuar si standardin e duhur atë që është aplikuar në këtë vendimmarrje”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni arrin në përfundimin se shpjegimet e subjektit mbi kalimin e barrës së provës për këtë çështje nuk duken të arsyetuara dhe bindëse. Gjithashtu, në përfundim të vlerësimit konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka legjitimuar një palë në kundërshtim me Kodin e Procedurës Civile (450/ç), pasi, nga të dhënat e rezultuara nga vendimi gjyqësor, pala ankuese nuk kishte kërkuar pranë gjykatës më parë ndërhyrjen si palë ndërhyrëse sipas nenit 194 të Kodit të Procedurës Civile, me qëllim të ushtrimit më tej të së drejtës ankimore.

### **7.22 Denoncim anonim nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2023**

Denoncimi i paraqitur pranë Komisionit nuk përmban emër, por vetëm në zarfin bashkëlidhur shkruhet si dërguese znj. A.D, Ajo iu është drejtuar shumë strukturave dhe përfaqësive diplomatike në Shqipëri, ku denoncon subjektin e rivlerësimit, bashkëshortin e saj dhe shumë subjekte të tjera

për veprime korruptive. Ajo përmend edhe emra komisionerësh pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Denoncimin e saj e fillon duke nënvizuar disa mbiemra të subjektit të rivlerësimit (Muçi, Muçi, Muçaj, Muça, Muça), duke thënë se: “Një zot e di si firmos kjo mafioze”.

Bashkëlidhur kësaj letre, denoncuesja ka sjellë postime nga gazetatat dhe një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 16.3.2010, ku një prej tre gjyqtarëve ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit. Në këtë vendim, me palë paditëse shoqërinë “\*\*\*\*\*” me seli në Tiranë dhe palë të paditur shoqërinë “\*\*\*”, me seli në Gjermani, me objekt “Përrjashtimin e ortakut të shoqërisë, me seli në Gjermani nga shoqëria, me seli në Tiranë dhe detyrimin për t’i paguar kësaj të fundit dëmin e shkaktuar në vlerë monetare...”. Gjykata, me kryesuese gjyqtaren E. Ll., ka disponuar me pranim padie, duke vendosur përjashtimin e shoqërisë “\*\*\*\*\*”, me seli në Gjermani nga qenia ortak në shoqërinë përfaqësuar në gjykim në cilësinë e paditësit dhe detyrimin e saj për dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar palës paditëse në masën “\*\*\*” lekë. Por, për sa kohë akuzat e denoncueses nuk lidhen me shkelje procedurale apo evidentim konflikt interesi në zhvillimin e këtij procesi gjyqësor, Komisioni nuk mund të hetonte më tej.

### **7.23 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 19.6.2023, i shtetasve E. S etj.**

Këta shtetas i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtares Blerina Muça, me kërkesën për përjashtimin e gjyqtares E. B. si gjyqtare e çështjes së tyre.

Kërkesa e tyre i drejtohet për dijëni edhe Komisionit, e depozituar 2 ditë më pas, në datën 19.6.2023. Kjo kërkesë procedurale pritet të shqyrtohet nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtares së shortuar për këtë kërkesë dhe nuk mund të trajtohej nga Komisioni si denoncim i publikut.

## **ÇËSHTJE TË TJERA**

### **8. Në lidhje me konfliktin e interesit**

**8.1** Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit të subjektit të rivlerësimit, bazuar në kontaktet dhe marrëdhëniet kontraktuale që ajo dhe bashkëshorti kanë pasur ndër vite.

**8.2** Për këtë Komisioni i është drejtuar<sup>50</sup> Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën për informacion e dokumentacion, nëse subjekti i rivlerësimit, znj. Blerina Muça, ka ndjekur ndër vite çështjet gjyqësore me palët e listuara<sup>51</sup> në shkresë.

**8.3** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kthyer përgjigje<sup>52</sup>, duke bërë me dije se subjekti i rivlerësimit, gjyqtarja Blerina Muça, ka dhënë vendimet si vijon:

- vendimin nr. \*\*\*, datë 14.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë ndërgjyqëse paditës shoqërinë “\*\*\*\*\*” sh.p.k. dhe të paditur “\*\*\*\*\*” sh.p.k.;
- vendimin nr. \*\*\*, datë 23.12.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me palë paditëse D.Ll, të paditur shoqërinë “\*\*\*\*\*” (\*\*\*) sh.p.k.;
- vendimin nr. \*\*\*, datë 24.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse D.R.T.M, të paditur D.R.A.T, person të tretë shoqërinë “\*\*\*\*\*” sh.p.k.;
- vendimin nr. \*\*\*, datë 23.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse D.Ll, të paditur shoqërinë “\*\*\*\*\*” (\*\*\*) sh.p.k., çështje e cila aktualisht është me statusin ankimuar.

<sup>50</sup> Shihni kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2023.

<sup>51</sup> Shihni listimin e subjekteve në shkresën \*\*\*, datë 6.6.2023, për të cilat është kërkuar informacion dhe dokumentacion.

<sup>52</sup> Shihni përgjigjet nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2023.

#### 8.4 Gjithashtu janë në gjykim çështjet civile si vijon:

- Çështja civile nr. \*\*\* akti, datë regjistrimi 25.1.2018, me palë paditëse H.M, të paditur shoqërinë përmbarimore \*\*\* sh.a., me objekt “Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv - vendimi nr. \*\*\*, datë 29.3.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Pezullimin e ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit nr. \*\*\* etj”.

**8.5** Lidhur me këtë çështje, nga gjyqtarja A. B. është vendosur “Pezullimi i gjykimit të çështjes civile me nr. \*\*\* akti, datë regj. 25.1.2018, deri në përfundimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë, me objekt “Kundërshtimin e vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 29.3.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë...”. Aktualisht, kjo çështje vazhdon të jetë me statusin pezulluar dhe me shortin e datës 23.5.2022 i ka kaluar gjyqtares Blerina Muça.

- Çështja civile nr. \*\*\* akti, datë regj. 21.8.2020, me palë paditëse M.F.E, të paditur shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., palë të tretë N.I Nr. \*\*\*, me objekt “Detyrimin e palës së paditur për lirim dhe objektin ambiente në ish-Uzinën e pjesëve të ndërtimit të automjeteve”, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 15,000 m<sup>2</sup> (nga të cilat, nënobjekt 5,858 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe funksionale 9,142 m<sup>2</sup>)”.
- Çështja civile nr. \*\*\* akti, datë regj. 1.10.2021, me palë paditëse “\*\*\*\*” sh.a. dhe të paditur M.F.E, palë e tretë N.I Nr. \*\*\*, me objekt “Zgjidhjen e kontratës së qirasë, të datës 3.5.2013, për shkak të mospërbushjes së qiradhënësit (palës së paditur), pagimin e dëmshpërblimeve...”.

**8.6** Nga hetimi administrativ i subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, bashkëshortit të saj, z. M “Muço, Muçi, Muça”, rezultoi se ky i fundit ka pasur marrëdhënie punësimi me:

- shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.;
- shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a.;
- shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**8.7** Ndërsa motra e subjektit të rivlerësimit, znj. K.G , rezulton ortakë pranë “ \*\*\*\*” sh.p.k., sipas të dhënave nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

**8.8** Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga shërbime konsulence dhe nga paga e bashkëshortit të saj, përkatësisht në vitet 2005–2010 pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. (ish “\*\*\*\*” sh.p.k.); në vitin 2013 pranë “\*\*\*\*” sh.a. dhe në vitet 2015 – 2016 pranë “\*\*\*\*” sh.p.k. Këto të ardhura të përfituara subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar edhe në deklaratat periodike vjetore përkatëse.

**8.9** Nga informacioni më sipër evidentohet se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje me këto palë (shoqëritë e përmendura më lart) në vitet 2013, 2016 dhe 2017.

**8.10** Në referim të fakteve më sipër, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtares duhej të kishte dhënë dorëheqjen në gjykimin e këtyre çështjeve, pasi ekzistonte dyshimi i arsyeshëm për mosdhënien e garancive të nevojshme për një gjykim të paanshëm, si një prej elementeve më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

**8.11** Në lidhje me paanshmërinë, edhe Kolegji<sup>53</sup> ka mbajtur këtë qëndrim: *“Gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionet e tyre me paanshmëri të plotë, si dhe të garantojnë aparcencën e paanshmërisë”*.

**8.12** Parimi i paanshmërisë në aspektin subjektiv lidhet ngushtë me bindjen e brendshme të gjyqtarit për zgjidhjen e çështjes në gjykim. Për këtë arsye, dhënia e garancive të nevojshme për gjykimin e paanshëm të çështjeve dhe me qëllim mënjanimin prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim, do ta bënte të domosdoshme heqjen dorë prej subjektit nga gjykimi i këtyre çështjeve, ku palë në gjykim janë shoqëritë në të cilat bashkëshorti i saj ka punuar dhe ka ofruar shërbime juridike kundrejt shpërblimeve monetare të konsiderueshme dhe motra e saj është ortakë në një prej këtyre shoqërive.

**8.13** Në këto kushte, duke u nisur nga përcaktimet e nenit 3, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit është gjendur në situatën e konfliktit të interesit në dukje përgjatë gjykimit të këtyre çështjeve me palë shoqëritë e sipërpërmendura.

**8.14** Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, në gjykimin dhe vendimmarrjen e çështjeve të listuara më sipër.

**8.15** Për këtë subjektit iu kërkua të shpjegojë e dokumentojë vendimmarrjet në lidhje me të gjitha çështjet gjyqësore të zhvilluara prej saj.

**8.16** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të paraqitur prova dhe shpjegime, që provojnë të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit për këtë çështje**

**8.17** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Në përgjigje të rezultateve të hetimit, në lidhje me konfliktin e interesit për çështjet gjyqësore, të cilat janë konsideruar në kuadër të vlerësimit të konfliktit të mundshëm të interesit gjatë gjykimit, rezulton se ato janë regjistruar të gjitha pas datës 23.7.2013.*

*Për pjesën mbi të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti prej shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k./ “\*\*\* ” sh.p.k., marrëdhënia e palëve ka përfunduar sipas marrëveshjes në vitin 2008, ndërkohë shlyerja e pagesave të prapambetura prej shoqërisë ka përfunduar në vitin 2010. Në momentin e depozitimit të këtyre padive në gjykatë dhe shqyrtimit të tyre, as unë dhe as personat e lidhur nuk kanë pasur asnjë lloj raporti apo marrëdhënie interesi me këtë palë. Sikurse kam sqaruar në pjesën e konfliktit të interesit me shoqërinë shitëse të apartamentit, po përsëris se në asnjë prej këtyre çështjeve nuk ka ekzistuar shkak ligjor, që të më vendoste në pozitën e konfliktit të interesit në momentin e gjykimit, sipas përcaktimeve të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Në momentin e gjykimit të secilës prej tyre nuk kam pasur arsye ligjore për të paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi dhe aq më pak nuk kam pasur asnjë arsye serioze njëanshmërie.*

*Konflikti i interesit në lidhje me çështjet gjyqësore rregullohet nga neni 13, pika 2 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.*

*Vlerësimi i pajtueshmërisë në gjykimin e këtyre çështjeve nga ana ime është bërë duke konsideruar rigorozisht kërkesat e nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, qëndrim që ka gjetur mbështetje edhe në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Kolegji në shqyrtimin e rasteve të ngjashme ka bërë interpretimin e situatave të tilla, sikurse rezulton me vendimin nr. 16/2020 (JR), datë 10.7.2020.*

<sup>53</sup> Shihni vendimin nr. 9/2018 (JR) të Kolegjit.

Në këtë kontekst, Kolegji konstaton se norma e zbatueshme për rastin konkret është neni 72 i Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon rastet kur një gjyqtar është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje për të shmangur rastet e një konflikti interesi. Kolegji vëren se në rastin konkret rregulli ligjor mbi të cilin duhet bërë arsyetimi e vlerësimi i situatës është neni 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, sipas së cilës “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur [...] në çdo rast tjetër vërtetohen arsye serioze njëanshmërie”.

Në të gjitha çështjet kam realizuar gjykim të pavarur dhe vendimmarrje të drejtë dhe ligjore, gjë e cila provohet plotësisht me vendimet përkatëse të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë.

Dua të konfirmoj se kurrë në jetën time nuk kam pasur asnjë kontakt me asnjë prej ortakëve apo përfaqësuesve të shoqërisë, sikurse dhe asnjë interes, që mund të më vendoste në situatën e arsyeve serioze të njëanshmërisë, për të paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i këtyre çështjeve. Marrëdhënia juridike e dhënies së konsulencës ligjore mes bashkëshortit dhe shoqërisë ka përfunduar afatin e saj që në vitin 2008 dhe efektet financiare të detyrimeve të papaguara në vitin 2010, kohë kjo shumë para regjistrimit të çështjeve të gjykuara prej meje.

Ndërsa në lidhje me konstatimin e Komisionit për çështjet civile të cilat janë në gjykim, duke filluar nga çështja civile me të paditur shoqërinë përmbarimore \*\*\* - \*\*\* sh.a., nuk është kryer asnjë veprim nga ana ime dhe, në momentin e verifikimit të dosjeve të pezulluara, të ardhura nga gjyqtarë të tjerë, me kërkesën e datës 29.6.2023 kam paraqitur dorëheqjen përpara kryetarit, e cila është miratuar me vendimin e datës 29.6.2023.

Për çështjen civile nr. \*\*\* akti, datë regj. 21.8.2020, me palë paditëse M.F.E, të paditur shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., palë e tretë N. I nr. \*\*\*, me objekt “Detyrimin e palës së paditur për lirimin e objektit ambiente në ish-Uzinën e pjesëve të ndërtimit të automjeteve, Tiranë”; si dhe për çështjen civile nr. \*\*\* akti, datë regj. 1.10.2021 me palë paditëse “\*\*\*\*” sh.a. dhe të paditur M.F.E, palë të tretë N.I nr. \*\*\*, me objekt “Zgjidhjen e kontratës së qirasë të datës 3.5.2013”, për shkak të mospërbushjes së qiradhënësit (palës së paditur)... etj., i vetmi veprim procedural që kam kryer, është kërkesa për heqje dorë nga shqyrtimi i tyre, miratuar me vendimet e datës 29.6.2023 të kryetarit”.

## **Vlerësimi i Komisionit**

### **8.18 Lidhur me konfliktin e interesit me shoqërinë “\*\*\*\*” ose “\*\*\*\*”**

Gjatë hetimit rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka pasur marrëdhënie kontraktuale (marrëveshje bashkëpunimi) me këtë shoqëri në vitet 2005 – 2008, por që në fakt këto marrëdhënie kanë vazhduar deri në vitin 2010.

Komisioni nuk bie dakord me shpjegimet e subjektit se nuk kanë pasur kontakte dhe marrëdhënie me këtë shoqëri pas vitit 2010. Bazuar në provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit rezultoi se edhe në vitin 2017 ka mbajtur korrespondence me shoqërinë, nga ku ka kërkuar dhe marrë edhe vërtetime e deklaratat përkatëse. Për më tepër, bazuar në deklaratën<sup>54</sup> nr. \*\*\*, datë 7.1.2017, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., deklarohet se: “Me anën e të së cilës deklarojmë se z. M.M, me profesion jurist, ka pasur marrëdhënie bashkëpunimi me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. (ish “\*\*\*\*” sh.p.k.), datë 15.8.2015 (bashkëngjitur), në bazë të së cilës z. M i ka ofruar shoqërisë shërbime konsulence ligjore”.

<sup>54</sup> Shihni deklaratën e shoqërisë në dosjen e ILDKPKI-së.

Komisioni ka konstatuar se bashkëshorti i subjektit ka pasur marrëdhënie favorizuese me këtë shoqëri, duke konkluduar të dyja palët në shmangie dhe përfitime financiare për mospagim detyrimesh tatimore (trajtuar kjo gjerësisht në këtë vendim në rubrikën e të ardhurave).

Komisioni konstaton se subjekti, gjendur në këto kushte dhe marrëdhënie interesi e favorizuese me shoqërinë në fjalë, duhet të shprehte minimumi sjellje që dëshmon paanësi e kjo çmohet në drejtim të integritetit të magjistratit, kjo parë në raport edhe me heqjet dorë që ka bërë me rastet e shoqërisë “\*\*\* ” sh.a. dhe shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit mes detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, i cili duhet të kryejë në mënyrë të drejtë dhe me përgjegjësi detyrat. Nisur nga rrethanat e çështjes dhe problematikat e hasura, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes gjyqësore, ku palë ndërgjyqëse ka qenë shoqëria “\*\*\* ”, duke u vetëpërfshirë paraprakisht nga procesi konkret vendimmarrës e duke mos marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes.

Komisioni në këtë rast u referohej parimeve të GJEDNJ-së dhe bazës ligjore në legjislacionin tonë të brendshëm, konkretisht ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, nenit 5, pika 1, për të përforcuar konkluzionet në vendimmarrjen e tij.

Në vlerësim, trupi gjykues mban në konsideratë edhe konceptin e paanësisë (sipas parimeve të Bangalorës) për sjelljen gjyqësore, të cilat zbatohen për magjistratët. Paanësia është esenciale për ushtrimin e detyrës. Ajo gjen zbatim jo vetëm në vendimmarrje, por edhe në procesin që e paraprin atë. Magjistrati duhet të japë dorëheqjen nga pjesëmarrja në një procedim, ku në dukje rezulton se ai e ka të pamundur të vendosë me paanësi. Perceptimi i mungesës së paanësisë cenon besimin e publikut të drejtësisë.

Në lidhje me situatën juridike të konfliktit të interesit, kjo është mbajtur edhe nga Kolegji në vendimin nr. 9 (JR), datë 24.10.2018, i cili ka mbajtur qëndrimin: *“Lidhur me parimin e paanësisë, “Rezoluta me 10 parimet bazë”, e miratuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, shprehet: “Gjyqtarët duhet që të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme duke garantuar dhe evidentuar paanshmërinë. Ata duhet të kujdesen që të shmangin në çdo rast konfliktin e interesit, por edhe përzierjen në të gjitha ato situata, të cilat perceptohet se përfshijnë apo krijojnë për gjyqtarët konflikt interesi. Lidhur me paanshmërinë, gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionet e tyre me paanshmëri të plotë, si dhe të garantojnë dukjen e paanshmërisë”. Në vendimin e Kolegjit nr. 10/2019 është mbajtur i njëjti standard në lidhje me konfliktin e interesit të gjyqtarit.”*

### **8.19 Lidhur me konfliktin e interesit me shoqërinë “\*\*\* ”**

Pas shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me çështjet e ndjekura si magjistrate me shoqërinë “\*\*\* ”, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit.

### **8.20 Lidhur me konfliktin e interesit me shoqërinë “\*\*\* ” sh.a.**

Subjekti i rivlerësimit në prapësime deklaroi se ka ndjekur 2 çështje civile (nr. \*\*\* akti, datë regj. 21.8.2020 dhe nr. \*\*\* akti, datë regj. 1.10.2021) me palë shoqërinë “\*\*\* ” sh.a. dhe i vetmi veprim procedural që ka kryer, është kërkesa për heqje dorë nga shqyrtimi i tyre.

Bazuar në të dhënat e këtyre dy praktikave gjyqësore, rezulton se çështja e parë është regjistruar në datën 21.8.2020 dhe çështja e dytë është regjistruar në datën 1.10.2021. Kërkesa për heqje dore dhe pranimit të tyre është bërë me vendimet e datës 29.6.2023 të Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në prapësimet e paraqitura, subjekti i rivlerësimit ka sjellë si provë vetëm dy vendimet e miratuara nga Kryetari i Gjykatës, por nuk ka paraqitur praktikën dhe informacionin mbi ecurinë e këtyre çështjeve. Sipas subjektit, këto çështje gjyqësore janë regjistruar në datat 21.8.2020 dhe 1.10.2021 në Gjykatë dhe veprimi i vetëm i saj është kërkesa për heqje dore nga çështjet në datën 29.6.2023. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegon si janë mbajtur këto dy çështje pa u zhvilluar asnjë seancë gjyqësore apo kryerjen e ndonjë veprimi tjetër procedural, deri në datën kur ka paraqitur dorëheqjen.

Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht pretendimeve se nuk ka kryer asnjë veprim procedural për këto 2 çështje (të cilat për Komisionin ngelen të paprovuara), konstaton vonesa të theksuara në fillimin e gjykimit të çështjeve dhe mbajtjen e tyre për një kohë të gjatë pa kryer veprime, me qëllim favorizimin e palës ndërgjyqëse, shoqërinë “\*\*\*” sh.a., duke u ndodhur kështu në situatën e konfliktit të interesit.

Analiza e bërë në këtë vendim për situatën e konfliktit të interesit me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. qëndron dhe për këtë rast.

## **VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, arrin në përfundimin se:

### **Për vlerësimin e pasurisë**

Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe mjaftueshëm pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre për arsyet e përmendura në këtë vendim në kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare lidhur me pasuritë, duke mos u gjendur në kushtet e përcaktuar nga shkronja “a” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për krijimin e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme dhe gjendur në kushtet e parashikimit të shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Blerina Muço, për kriterin e vlerësimit të pasurisë vërtetohen shkaqet që neni D i Aneksit të Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit Blerina Muço nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

### **Për vlerësimin e figurës**

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Blerina Muço, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.



## **Për vlerësimin e aftësive profesionale**

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, në tërësi, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:

- ka shfaqur mangësi të theksuara në mënyrë të përsëritur në lidhje me afatet e gjykimit të çështjeve;
- nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për të shmangur gjykimet e saj në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, të cilat në dukje kanë cenuar paanshmërinë e magjistratit;
- ka përdorur mbiemra të ndryshëm nga mbiemri zyrtar në praktika, akte të ndryshme dhe në të gjitha çështjet e gjykuara në gjykatë;
- ka kryer veprime duke shtrembëruar faktet dhe provat shkresore, si dhe veprimet e saj kanë pasur si qëllim shfaqjen e një situatë tjetër, joreale (lidhur me deklaratat periodike të bashkëshortit), fakte këto që cenojnë figurën e saj si magjistrate.

Në këtë aspekt, Komisioni e vlerësoi kriterin profesional duke analizuar të gjitha gjetjet e konstatuara për subjektin e rivlerësimit.

## **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Blerina Muço, ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Gjithashtu, nga vlerësimi tërësor i çështjes, Komisioni konkludoi se në procesin e rivlerësimit të këtij subjekti u evidentohen problematika të tilla, që mund të cenojnë kriteret e rivlerësimit, pasi u evidentuan elemente të arsyeshme, të konsiderueshme apo të perceptueshme që cenojnë besimin e publikut sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, referuar shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Blerina Muço, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 1.11.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela QIRKO**  
**Kryesuese**  
**(Kundër)**

**Roland ILIA**  
**Relator**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Amela Idrizi*